



STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT

2014 – 2020

Raporti i Parë i Monitorimit¹

Tetor 2018

¹ Ky raport monitorimi, i bazuar në kontributin e anëtarëve të Grupit Ndërinstitucional të Punës të ngritur për këtë qëllim, e i kordinuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është hartuar nga Znj. Jolanda Trebicka, eksperte lokale për monitorimin e politikave. Ekspertiza lokale është mundësuar me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim, që zbatohet nga *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e hartuesve të tij dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron mendimin zyrtar të GIZ.

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtesa	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
II. HYRJE.....	8
III. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI PROGRESIN E STRATEGJISË.....	10
Prioriteti I: Përmirësimin e sigurisë së konsumatorëve mbështetur në një infrastrukturë efektive të cilësisë sipas praktikave më të mira evropiane	12
Prioriteti II. Përmirësimi i transparencës së tregut dhe praktikave tregtare për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, duke përmirësuar dhe aksesin për dëmshpërblim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.....	34
Prioriteti III: Përmirësimi i edukimit të konsumatorëve për pjesëmarrje aktive në treg dhe përmirësimi i informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë për të drejtat e konsumatorëve.....	45
IV. SFIDAT KRYESORE NË ZBATIMIN E STRATEGJISË	49
Shtojca 1	51

Shkurtesa

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
BE	Bashkimi European
BIPM KCDB	Databaza e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave
CEN	Komiteti Evropian për Standardizimin
CENELEC	Komiteti Evropian për Standartizimin në fushën e Elektroteknikës
EA	Organizata Evropiane për Akreditim
ETSI	Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit
EJL	Strategjia e Evropës Juglindore
EURAMET	Organizata Evropiane e Instituteve Kombëtare të Metrologjisë
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
DPM	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit
DML	Drejtoria e Metrologjisë Ligjore
DIM	Drejtoria e Inspektimit Metrologjik
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (prej Shtator 2017 – pjesë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë)
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MSHIAP	Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike (prej Shtator 2017 – pjesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë)
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
WELMEC	Bashkëpunimi Evropian për Metrologjinë Ligjore
KE	Komisioni European
IMB	Instituti i Mbrojtjes së Bimëve
QKKB	Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave
KMK	Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve

ZPEA	Zona e Përbashkët e Aviacionit European
IMB	Instituti i Mbrojtjes së Bimëve
DSHP	Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik
PMB	Produktet e Mbrojtjes së bimëve
OIE	Organizata Botërore të Shëndetit të Kafshëve
IQ	Inspektoriati Qendror
IQT	Inspektorati Qendror Teknik
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardeve
IEC	Komisioni Ndërkombëtar për Standardet e Elektrotektikës
ILAC	Organizata Ndërkombëtare e Akreditimit të Laboratorëve Testues
IAF	Forumi Ndërkombëtar të Akreditimit
QF	Qendra Farmakovigjilencës
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë 4 viteve të fundit Shqipëria ka ndërmarrë një sërë iniciativash horizontale dhe sektoriale në fushën e politikës së mbrojtjes së konsumatorëve, në zbatim të Strategjisë. Këto iniciativa kanë konsistuar në hartimin e një sërë ligjesh dhe aktesh ligjore të rëndësishme, zhvillime institucionale dhe zhvillimin e teknologjive të reja që sigurojnë kontrollin më cilësor në drejtim të ofrimit e produkteve më të sigurta për konsumatorët. Gjithashtu njohja e institucioneve shqiptare dhe akreditimi i tyre në kuadër të institucioneve ndërkombëtare ka qenë një arritje tjetër në kuadër të zbatimit të Strategjisë në periudhën e saj të parë të zbatimit.

Në mënyrë më specifike arritjet në periudhën 2014-2018 janë si më poshtë:

1. Përmirësimi i legjislacionit dhe harmonizimi i tij me legjislacionin Europian:

- Ligji nr. 106/2016 për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre (përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007);
- Ligji nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”;
- Ligji nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, dhe Ligji nr. 80/2017 që amendon ligjin 64/2012 “Për peshkimin”;
- Ligji nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e Sigurisë së Pajisjeve, Impianteve dhe Instalimeve Elektrike”;
- ***Kuadri ligjor i nevojshëm për fushën e akreditimit është miratuar dhe është në përputhje të plotë me Rregulloren Europiane nr.765/2008 “Kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut”.*** I gjithë dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të DPA është rishikuar në përputhje me kërkesat e Rregullosës Evropiane nr. 765/2008 dhe të standardit S SH ISO/IEC 17011:2004;
- Ligji nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 100/2015 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008 "Për Metrologjinë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10480/2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore” i cili krijon mbrojtjen horizontale për sigurinë e produkteve që i adresohen konsumatorëve;
- Ligji i ri nr. 26/2017 “Për Kozmetikën” i cili është një hap i rëndësishëm për rregullimin e fushës së produkteve dhe shërbimeve kozmetike, pasi do të ndikojë në kontrollin e cilësisë së produkteve.

Ndryshimet ligjore të sipërpërmendura kanë pasur qëllim vendosjen e bazës legjislative për sistemin e mbikëqyrjes së tregut, si dhe ngritjen dhe funksionimin e inspektoratit të tregut.

Gjithashtu një hap përpara është bërë në drejtim të plotësisht të kuadrit ligjor lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit, duke transpozuar Direktivën 2013/11/BE "Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve”.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 48, datë 01.07.2015 miratoi rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare" e cila ka për qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare, duke përmirësuar kuadrin rregullator në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, rritjen e konkurrencës në sektorin bankar dhe rritjen e transparencës së produkteve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare.

2. Hapa janë marrë së fundi në drejtim të përmirësimit institucional nëpërmjet krijimit të institucioneve të reja, riorganizimeve apo përmirësimit të koordinimit institucional:

- Me synim rritjen e cilësisë së ushqimit për grupe të veçanta konsumatorësh në muajin gusht 2018 ndërmjet Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit u nënshkrua "Marrëveshja e Bashkëpunimit" me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e sigurisë ushqimore në ndihmë të kategorive të konsumatorëve me ndjeshmëri të veçanta shëndetësore dhe ushqyese si në çerdhe, kopshte, konvikte shkollore, spitale, azile, etj.
- Riorganizimi i shërbimit veterinar në nivel qendror dhe rajonal sipas standarteve mbetet një nga arritjet institucionale në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve institucionale në shërbimin veterinar dhe rritja e efektivitetit në nivel qendror e rajonal.
- Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve mjekësore në 2015. Regjistrimi i pajisjeve mjekësore do të mundësojë që për herë të parë pas 25 vitesh, pas liberalizimit të tregut mjekësor, pajisjet mjekësore që do të qarkullojnë në Shqipëri do të jenë më të sigurta, pasi do të jenë të çertifikuara me markë CE, ashtu sikurse e parashikojnë edhe ligjet e Bashkimit Europian. Kjo do të ndikojë në rritjen e sigurisë të qytetarëve shqiptarë të cilët i drejtohen sistemit spitalor dhe atij ambulator.
- Krijimi i Inspektoriatit Shtetëror të Mbyqyrjes së Tregut i cili do të ndikojë në forcimin më tej të zbatimit të standarteve dhe legjislacionit.

3. Arritje pozitive ka pasur në drejtim të njohjes së rezultateve në nivel kombëtar dhe europian/ndërkombëtar.

- Nga objektivi që deri në vitin 2020 të mund të njihen të paktën 20 lloje testimesh nga laboratorët e ISUV, deri në këtë periudhë Laboratori i ISUV është akredituar për 24 lloje provash analizash, duke e realizuar atë në masën 120%.
- Anëtarësimi në Organizatën Europiane të Akreditimit është një nga arritjet më të rëndësishme në drejtim të pjesëmarrjes së Shqipërisë më të drejta të plota në strukturat europiane.

Hapa të rëndësishëm janë marrë në drejtim të ngritjes së sistemeve online të inspektimit, por ende mbetet problematik monitorimi i plotë dhe në kohë reale i gjithë subjekteve farmaceutike .


Ndërgjegjësimi i konsumatorëve në lidhje me sigurinë e produkteve në treg si dhe i operatorëve ekonomikë për detyrimet që duhet të plotësojnë për ofrimin e produkteve të sigurta në treg në zbatim të kriterëve të përcaktuar në legjislacionin në fuqi ka qenë në fokusin e punës së institucioneve të cilës;isë.

II. HYRJE

Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2014-2020, është dokumenti politik i cili vendos në qendër të tij konsumatorët dhe synon fuqizimin e tyre për një rol aktiv në treg, duke ushtruar të drejtat dhe fuqinë e tyre të zgjedhjes së mirëinformuar për të blerë mallra dhe shërbime. Kjo Strategji është në vijim të masave të parashikuara në Strategjinë e mëparshme të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut (2007-2013), duke përcaktuar edhe fushat që do të kërkonin më shumë vëmendje në vitet e ardhshme 2014-2020.

Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut, është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo është në linjë me parimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) si dhe Planin Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) për çështje që lidhen me rregullat teknike, mbrojtjen e konsumatorëve, mbikëqyrjen e tregut, standartizimin, metrologjinë, akreditimin si dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit.

Fig 1: Vizioni dhe shtyllat kryesore të strategjisë



Fuqizimi i konsumatorëve nuk është vetëm një e drejtë, por ka të bëjë me krijimin e një mjedisi të përgjithshëm që i mundëson atyre të shfrytëzojnë këto të drejta dhe të përfitojnë prej tyre, që do të thotë krijimin e një sistemi në të cilin ata mund të mbështeten dhe që u garanton sigurinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe mbrojtjen efektive të interesave të tyre ekonomike kur këto vihen në rrezik. Garantimi i qarkullimit të lirë të produkteve të sigurta në treg me të njëjtat kërkesa teknike me ato evropiane është bazë për çdo politikë të konsumatorëve dhe një nga liritë themelore të përcaktuara në Traktatin e Funkcionimit të BE si dhe një nga masat e parashikuara në Strategjinë EJL 2020.

Strategjia përcakton si qëllim të politikave krijimin e një mjedisi të përgjithshëm ligjor dhe institucional që u garanton konsumatorëve mbrojtjen e shëndetit, të sigurisë dhe interesave ekonomike, përmirësimin e edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin, mbështetjen për një zbatim efektiv të të drejtave të tyre, me qëllim fuqizimin e konsumatorëve dhe rritjen e besimit të tyre për kryerjen e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në treg, duke e bërë tregun të punojë për ta.

Strategjia përmban 33 objektiva strategjike. Plani i veprimit të strategjisë parashikohet të kryhet në 2 faza: *Faza afatmesme 2014-2015 dhe Faza afat-gjatë 2016-2020.*

Duke qenë se ky raport monitorimi është dhe raporti i parë i monitorimit të strategjisë, për efekt të monitorimit, aktivitetet e planit të veprimit janë integruar në një plan të vetëm duke integruar aktivitetet e të njëjtës natyre në një të vetëm, me synim vlerësimin e zbatimit të strategjisë në nivel të përgjithshëm. Në total janë 45 aktivitete të integruara të cilat përbëjnë bazën kryesore që reflektojnë materializimin e objektivave të parashikuara në strategji.

Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2014-2020 parashikon dhe numrin më të madh të iniciativave legjislative. ***Plani i veprimit parashikon në total hartimin e rreth 260 akteve ligjore dhe nënligjore.*** Një intesitet kaq i madh i ndryshimeve ligjore është i kuptueshëm nëse kemi parasysh domosdoshmërinë e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian.

III. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI PROGRESIN E STRATEGJISË

Vlerësimi i progresit të bërë për arritjen e Objektivave të Strategjisë realizohet nëpërmjet vlerësimit të ecurisë së zbatimit të reformave të parashikuara në kuadër të strategjisë, reforma këto të parashikuara në Planin e Veprimit 2014 – 2020.

Plani i Veprimit i SMKMT siç përmendet edhe më lart, është i ndarë në dy faza:

Faza e parë shtrihet në vitet 2014 – 2015 dhe faza e dytë në periudhën 2016 -2020. Secila ka të përfshirë në total 88 dhe 89 aktivitete (ose 178 aktivitete në total). Disa nga aktivitetet ishin të së njëjtës natyrë dhe përfaqësonin vazhdimësinë e zbatimit të një aktiviteti të caktuar. Për efekte të monitorimit, të dyja planet janë integruar në një të vetëm. Si rezultat i këtij integrimi, janë përcaktuar në total 157 aktivitete të cilat edhe janë vlerësuar kundrejt zbatimit të tyre. Vlen të theksohet se nga 157 aktivitetet e planifikuara vetëm 49 ose 31% prej tyre ishin planifikuar të përfundonin në periudhën raportuese 2014-2017, ndërsa pjesa tjetër prej 108, ose 69% aktivitete planifikohet të realizohet pas vitit 2017.


Në total shkalla e realizimit të aktiviteteve është në masën 54% (84 aktivitete) ndërsa 27% e tyre (42 aktivitete) janë në proces zbatimi, ndërsa vetëm 19% e aktiviteteve ende nuk kanë filluar të zbatohen.

Grafiku 1: Statusi i Përgjithshëm i Zbatimit të Aktiviteteve




Nëse duhet të konsiderojmë që pjesa më e madhe e aktiviteteve parashikoheshin të fillonin pas vitit 2017, atëherë duhet thënë që ecuria e zbatimit të strategjisë në nivele të përgjithshme është e kënaqshme.

Grafiku 2: Shkalla e realizimit sipas shtyllave të politikës



Grafiku i mëposhtëm tregon arritjet kundrejt realizimit të treguesve të parashikuar në dokumentin e strategjisë. Sic shihet 43% e treguesve janë realizuar, ç'ka nënkupton se strategjia i ka arritur synimet e vendosura për një pjesë të objektivave të saj.

Grafiku 3: Shkalla e realizimit të treguesve



Duhet përmendur se ka qenë e pa mundur të gjykohej mbi treguesit e fushës së sigurisë ushqimore pasi nuk është paraqitur asnjë e dhënë nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për gjashtë nga shtatë treguesit që strategjia parashikon në këtë fushë.

Në mënyrë individuale të dhënat e treguesve jepen sipas secilës fushë prioritare më poshtë. Infrastruktura e cilësisë - Akreditimi ka arritjet më të mira në drejtim të arritjes së gjithë synimeve të parashikuara në strategji.

Prioriteti I: Përmirësimin e sigurisë së konsumatorëve mbështetur në një infrastrukturë efektive të cilësisë sipas praktikave më të mira evropiane


Krijimi i një qasje të koordinuar, strategjike dhe e mbështetur në prioritete, për procesin e përafrimit me BE-në në të gjitha fazat, duke filluar nga hartimi i planeve ligjore të përafrimit, hartimit të akteve të reja nënligjore dhe përgatitja e njëkohëshme e institucioneve për të zbatuar legjislacionin e ri në mënyrë efektive, zhvillimi i kapaciteteve institucionale në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural dhe në fushat e politikave të sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare duke futur një qasje më të integruar në punën për dy kapitujt, mbështetur në koordinimin e mirë brenda dhe ndërmjet ministrive, duke përfshirë të gjitha grupet përkatëse të interesit, mbetet një nga synimet e rëndësishme të politikave të qeverisë e reflektuar dhe në SMKMT.

Kjo do të arrihet nëpërmjet tre nën-prioriteteve kryesore në kuadër të këtij prioriteti:

- 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve dhe fuqizimi i sistemit të kontrollit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë.**
- 2. Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë e produkteve jo ushqimore dhe fuqizimi i sistemit eficient të mbikëqyrjes së tregut**
- 3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë e barnave dhe ofrimin e shërbimit farmaceutik bashkëkohor për përdoruesit e barnave.**

Ecuria e zbatimit të aktiviteteve dhe shkalla e zbatimit të tyre sipas 3 nën-prioriteteve jepet në grafikët e mëposhtëm:

Grafiku 4: Afatet kohore të realizimit të aktiviteteve



Grafiku 5: Shkalla e realizimit të aktiviteteve



i) Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve dhe fuqizimi i sistemit të kontrollit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë

Legjislacioni lidhur me kërkesat e sigurisë së produkteve jo-ushqimore përbën një pjesë të konsiderueshme të acquis dhe me gjithë progresin e mirë për transpozimin e tij duke filluar nga viti 2007, duhen vazhduar përpjekjet për transpozimin e plotë të legjislacionit teknik të produkteve dhe ndjekjen e zhvillimeve në nivel evropian për përditësimin e legjislacionit tonë duke u bazuar edhe në prioritetet apo problematikat e realitetit shqiptar.

Një sërë aktesh ligjore janë harmonizuar me kuadrin rregullator evropian, edhe pse nuk ka qenë e mundur të arrihej synimi i përcaktuar në plan. Ligjet më të rëndësishme që janë harmonizuar janë:

(i) Ligji nr. 106/2016 për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre (përafron pjesërisht Rregulloren e Këshillit European (KE) nr. 834/2007);

(ii) Ligji nr. 105/2016 “Per mbrojtjen e bimeve”;

(iii) Ligj nr. 103/2016 “Për Akuakulturën dhe (iv) ligji nr. 80/2017 që amendon ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”.

Të tjera akte ligjore që lidhen me: përcaktimin e parimeve të përgjithshme, kërkesat dhe përgjegjësitë që rregullojnë informacionin e ushqimit në përgjithësi, dhe etiketimin e ushqimit në veçanti, mjetet për të garantuar të drejtën e konsumatorëve në informim dhe procedurat për sigurimin e formacionit të ushqimit (VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Mbi etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” që përafron pjesësisht Rregulloren (BE) nr. 1169/2011 e parlamentit evropian dhe e këshillit, data 25 tetor 2011, "Për dhënien e informacionit ushqimor për konsumatorët"); përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të çertifikimit të farave të bimëve vajore dhe fibrore; për kriteret mikrobiologjike të produkteve ushqimore; për menaxhimin e burimeve të peshkimit dhe disa rregulla për funksionimin e regjistrit të peshkimit etj².

Duhet përmendur se për fazën e parë të strategjisë dhe për fazën e dytë, objektivi i vendosur në fushën e legjislacionit është tepër ambicioz. Parashikohet rishikimi i 40 akteve ligjore e nën ligjore vetëm në periudhën 2014 -2015 dhe 150 akte ligjore në periudhën 2015-2020.

Është punuar drejt arritjes së objektivt për garantimin e sigurisë se ushqimit, produkteve ujore, veçanërisht molusqeve bivalve, sipas parimit nga ferma në tavolinë, edhe pse ende mbetet shumë për t’u realizuar. AKU ka kryer vlerësimin e riskut mbi kategorizimin e FAO që prodhojnë, përpunojnë dhe shpërndajnë ushqime me origjinë shtazore dhe jo shtazore dhe klasifikimit të riskut të ndarë sipas grup produkteve (të lartë, të mesëm dhe të ulët).

² Për më shumë informacion të detajuar shih Planin e Veprimit aktivitetet 1.1 dhe 1.2

Janë realizuar kontrole bazuar në vlerësimin në bazë risku, dhe në përputhje me kriteret e kontrollit, dmth. numrin e FAO, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore, duke përcaktuar klasifikimin e riskut të ndarë sipas grup produkteve. Gjithashtu në bazë të këtij kategorizimi është hartuar metodologjia “frekuenca e kontroleve zyrtare të planifikuara me bazë risku të operatorëve të biznesit”. Nga trupat inspektuese të AKU janë kryer inspektime në zbatim të planeve vjetore.

Ende nuk është bërë e mundur marrja e vendimit nga Komisionit Europian për listimin e Shqipërisë lidhur me të drejtën e eksportimit në BE të molusqeve bivalve (për një zonë), ndërkohë që vazhdon monitorimi i molusqeve sipas planit kombëtar të monitorimit i cili përditësohet çdo vit (AKU në bashkëpunim me ISUV) duke regjistruar gjithë setin e rezultateve të analizave si një parakusht për marrjen e të drejtës së eksportit në BE. Gjithashtu ende nuk është arritur progresi i duhur në drejtim të shtrirjes së monitorimit, klasifikimit dhe miratimit nga Komisioni Europian (DG SANCO) i tetë zonave potenciale të prodhimit të molusqeve bivalve të gjallë sipas kriteve të BE-së si dhe rishikimi i vazhdueshëm i mbikëqyrjes sanitare.

Një sërë aktivitete janë ndërrmarë më synim realizimin e objektivit për ***fuqizimin e kapaciteteve profesionale të AKU dhe infrastrukturës operative të saj, në veçanti të laboratorëve rajonalë dhe pikave të inspektimit kufitar specialistëve të laboratorëve të mbrojtjes së bimëve të AKU-së për diagnostikimin e parazitëve karantinorë.***

Nëpërmjet programit TAIEX janë realizuar trajnime për monitorimin e qumështit lëndë e parë; harmonizimin e legjislacionit mbi ushqimet gjenetike të modifikuara; harmonizimin e legjislacionit mbi ushqimet gjenetike të modifikuara; legjislacioni i BE-së mbi informacionin ushqimor për konsumatorët; mbetjeve e pesticideve në produktet me origjinë bimë.

Një sërë trajnimesh janë realizuar edhe me mbështetjen e TIKA, IFC dhe TAIEX për inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së dhe specialistëve të drejtorive rajonale dhe pikave të Inspektimit Kufitar për tematika si; kontrollet me bazë risku në Pikat e Inspektimit Kufitar; funksionimin e sistemit TRACES; legjislacioni i BE-së mbi kontrollet në import në Pikat e Inspektimit Kufitar etj, si dhe një sërë trajnimesh të tjera.

Aktualisht AKU, MBZHRAU, dhe ISUV po punojnë me asistencën e Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”³. Objektivi i përgjithshëm i projektit është forcimi i kapaciteteve administrative kombëtare për të siguruar nivele të përmirësuara të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor.

Progres ka pasur në drejtim të unifikimit të metodave dhe metodologjive të analizimit të produkteve ushqimore. Është kryer unifikimi i disa metodologjive të miratuara në cilësi nga Qendra e Referencës ISUV në lidhje me vlerësimin e kriteve të sigurisë dhe cilësisë, si dhe shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve në varësi të laboratorit si dhe unifikimi i metodave laboratorike për diagnostikimin e parazitëve nga Qendra e Referencës Departamentit të Mbrojtjes Bimëve pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës. Vazhdon përdorimi i dokumentacionit të unifikuar të strukturave inspektuese, si dhe ai i aplikimit të tarifave të miratuara për inspektorët e Pikave të Inspektimit Kufitar.

³ Contract no. AL/IPA2013/04” filluar në korrik 2016 dhe zgjat 36 muaj.

Në 2016- 2017 nuk është kryer trajnim për stafin e laboratorit të AKU, bazuar në kërkesën e kryer mbi nevojat për unifikim të metodave laboratorike dhe trajnim të stafit të Laboratorëve Rajonale të AKU-së për vitin 2016-2017, por është bërë e mundur realizimi i trajnimeve në fillim të vitit 2018.

Në kuadër të asistencës së Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të Laboratorëve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Shqipëri”⁴ bazuar në gjendjen aktuale në të cilën ndodhen laboratorët rajonalë të AKU, parashikohet fillimi i procedurave për akreditimin e disa provave, mbi bazën edhe të parashikimeve në projekt buxhet 2019-2020.

Ka vijuar puna për realizimin e testeve ndërkrasimore. Nga ISUV janë realizuar 5 testime ndërlaboratorike dhe 9 testime ndërlaboratorike janë organizuar nga Departamenti i Mbrojtjes Bimëve pranë UBT.

Ngritja e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Në mars 2016 u krye vlerësimi i laboratorëve dhe vendosja e tyre në formatin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, dhe një vit më pas u krye vlerësimi i Laboratorëve Veterinar Shtetëror të AKU nga Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare ISUV. Vazhdon mirëmbajtja e procedurave dhe dokumentacionit që janë pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe aktualisht të gjithë Laboratorët Rajonalë të AKU zbatojnë procedurat dhe dokumentacionin e unifikuar⁵. Në rast të identifikimit të rasteve të moskonformitetit kryhet njoftim i menjëhershëm online i informacionit të shpejtë me institucionet e linjës që bën të mundur identifikimin dhe marrjen e masave për produktet që çënojnë sigurinë ushqimore, si dhe për diagnozën e kafshëve. Pavarësisht ecurisë në ngritjen e sistemit të menaxhimit të cilësisë problematike mbetet numri i ulët i stafit, trajnimi i stafit, zhvillimi i testeve ndërlaboratorike si dhe burimet buxhetore të kufizuara për të mbuluar shpenzimet operative.

Hapa janë marrë së fundi në drejtim të përmirësimit institucional me synim rritjen e cilësisë së ushqimit për grupe të veçanta konsumatorësh. Në muajin gusht 2018 ndërmjet Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit u nënshkrua “Marrëveshja e Bashkëpunimit” me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e sigurisë ushqimore në ndihmë të kategorive të konsumatorëve me ndjeshmëri të veçanta shëndetësore dhe ushqyese si në çerdhe, kopshte, konvikte shkollore, spitale, azile, etj. Kjo marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet palëve në funksion të rritjes së impaktit në garantimin e sigurisë ushqimore duke vendosur disa standarde me qëllim rritjen e cilësisë së ushqimit për grupe të veçanta të konsumatorëve që janë nën kujdesin dhe përgjegjësinë e këtyre autoriteteve kontraktore, por shërbejnë dhe si model referues edhe për subjekte të tjera që ushtrojnë këtë lloj aktiviteti.

Riorganizimi i shërbimit veterinar në nivel qendror dhe rajonal sipas standarteve mbetet një nga arritjet institucionale në drejtim të arritjes së objektivit “Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në shërbimin veterinar dhe rritja e efektivitetit në nivel qendror e rajonal”. Këshilli i Ministrave me

⁴ Qëllimi është ngritja e një rrjeti kosto-eficient laboratorik të aftë për të garantuar informacion të besueshëm dhe në kohë mbi sigurinë e ushqimeve të tregtuara dhe shendetin e kafshëve. - Rritja e kapaciteteve të rrjetit laboratorik për të kryer monitorime dhe analiza të produkteve ushqimore dhe ushqim për kafshë me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnozës mikrobiologjike në ushqim dhe ushqim për kafshë, standardeve të cilësisë, semundjeve të kafshëve, në përputhje me standarde të përmirësuar.

⁵ Bazuar në Urdhërin nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”.

Vendim nr. 146, datë 13.3.2018 Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, miratoi riorganizimin strukturor të këtij shërbimi dhe krijimin e Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve (ARSHVMB), si persona juridikë publikë, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, me seli në Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Elbasan. Mirëfeksionimi dhe efikasiteti e këtyre strukturave mbeten tashmë sfidat e ardhshme, paralelisht me forcimin e kapaciteteve teknike e humane të tyre.

Mbrojtja e shëndetit të kafshëve dhe ulja e riskut të kalimit të zoonozave te njerëzit.

Në vitin 2016 bashkëpunim me projektin PAZA filloi fushata e vaksinimit të brucelozës të remonitit në të imëta “Përmirësimi i shëndetit të njerëzve duke luftuar sëmundjet zoonotike” në masën 690.000 krerë të imëta (remont) nga të cilat gjatë vitit 2016 u vaksinuan 594.780 krerë⁶.

Treguesit : *Imunizimi 100 % i bagëtive të imta nga sëmundja e brucelozës- në vitin 2016 treguesi u realizua në masën 86%*

Në drejtim të kontrollit të tërbimit duke vaksinuar kafshët e egra të cilat përbëjnë rezervuarin kryesor të përhapjes së kësaj sëmundje në kafshët shtëpiake dhe njerëz, në muajin Maj 2017, për të shtatën herë rradhazi, u realizua vaksinimi dhe dhelprave kundër sëmundjes së tërbimit. Avionët e vegjël, nëpërmjet makinerive speciale dhe hartave të sakta shpërndajnë në mënyrë të automatizuar dhe kontrolluar 20 vaksina për kilometër katror, rreth 560,000 vaksina karrem⁷.

Treguesit : *Gjurmimi i sëmundjes së brucelozës në gjedhë (10% te krerëve në vit); - nuk ka të dhëna*

Arritje pozitive ka pasur në drejtim të njohjes së rezultateve në nivel kombëtar dhe europian/ndërkombëtar. Nga objektivi që deri në vitin 2020 të mund të njihen të paktën 20 lloje testimesh nga laboratorët e ISUV, deri në këtë periudhë Laboratori i ISUV është akredituar për 24 lloje provash analizash, duke e realizuar atë në masën 120%.

ii) Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë e produkteve jo ushqimore dhe fuqizimi i sistemit eficient të mbikëqyrjes së tregut

⁶ Nuk ka të dhëna mbi procesin e imunizimit për vitet 2015 dhe 2017.


⁷ Ky proces bëhet dy herë në vit, në pranverë dhe vjeshtë.

Rezultatet në kuadër të këtij nën-prioriteti tregojnë progres të mirë në drejtim të realizimit të aktiviteteve të planifikuara. Në përgjithësi zbatimi i aktiviteteve është brenda afateve kohore të përcaktuara në plan, me përjashtim të vetëm 2 aktiviteteve që lidhen me “Përgatitjen e rregullit teknik për fishekzjarret” dhe “Përgatitjes dhe miratimit të ligjit të ri për materialet e ndërtimit” që ishin parashikuar të fillonin përpara vitit 2015.


Shkalla e realizimit të aktiviteteve në total për tre fushat është në masën 63% (29 nga 46 aktivitete). Shkalla më e lartë e realizimit është në fushën e akreditimit dhe më e ulët në fushën e metrologjisë me 50% të aktiviteteve të realizuara. Duhet përmendur që një pjesë e mirë e aktiviteteve në këtë fushë kanë një shtrirje kohore të gjatë (shtrihen në periudhën 2016-2020).

Ecuria e aktiviteteve dhe shkalla e zbatimit të tyre jepen në grafikët e mëposhtëm:

Grafiku 6 Afatet kohore të realizimit të aktiviteteve



Grafiku 7: Shkalla e realizimit të aktiviteteve



Legjislacioni lidhur me kërkesat e sigurisë së produkteve jo-ushqimore përbën një pjesë të konsiderueshme të acquis dhe me gjithë progresin e mirë për transpozimin e tij duke filluar nga viti 2007, duhen vazhduar përpjekjet për transpozimin e plotë të legjislacionit teknik të produkteve dhe ndjekjen e zhvillimeve në nivel evropian për përditësimin e legjislacionit tonë duke u bazuar edhe në prioritetet apo problematikat e realitetit shqiptar.

Ndër aktet ligjore më të rëndësishme të cilat janë hartuar janë:

- Ligji nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së Pajisjeve, Impianteve dhe Instalimeve Elektrike”;
- Ligji nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së Pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.
- Rregulli teknik “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë në linjat elektrike ajrore e kabllorë mbi 1 kV”.

Ndërkohë janë në proces marrje mendimi nga institucionet relevante⁸:

⁸ Në proces realizuar 90 %.

- Rregulli teknik “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 kV”.
- Rregulli teknik “Për instalimet elektrike deri në 1 kV në ambiente atmosferë shpërthyesë”.

Nga ana tjetër, vetëm një mbikqyrje efektive dhe efiçente e tregut mund të garantojë që produktet në treg janë në përputhje me kërkesat teknike të sigurisë në lidhje me to. Ky do jetë një nga prioritetet me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së produkteve që ofrohen në treg dhe besimin e konsumatorëve. Përsa i përket objektivave që kanë të bëjnë me uljen e moskonformiteteve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre ndaj kërkesave ligjore lidhur me treguesit cilesorë, janë realizuar plotësisht aktivitetet e përcaktuara për realizimin e tyre.

Me synim arritjen e objektivit për **“Uljen në 6% në vit e bombolave të gazit në përdorim, që janë të pakontrolluara”** janë forcuar masat e kordinimit institucional. Është organizuar një grup kontrolli i përbashkët me pjesëmarrjen e inspektoreve të Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) dhe specialistëve të Strukturës Administrative Përgjegjëse në Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Mbështetur në Urdhrin e Ministrit nr. 153, datë 09.05.2016 janë kryer 91 kontrolle si dhe vazhdon të kryhen në subjektet kryesore që përdorin pajisje impiante dhe instalime nën presion. Është rritur numri i kontrolleve të ushtruara nga ana e ISHTI në subjektet e tregtimit me shumicë dhe pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Janë marrë masa dhe po procedohet për evidentimin, regjistrimin dhe gjurmimin nga ISHTI për të gjitha pajisjet nën presion, bombolat e gazit që janë për përdorim familjar e të ngjashëm. Gjithashtu me anë të kontrolleve të subjekteve të tregtimit bombolave të rimbushjes me gaz është realizuar edhe po vazhdon puna për ndërgjegjësimin kundrejt subjekteve lidhur me rritjen e sigurisë së këtyre pajisjeve dhe ndërmarrjen e sanksioneve përkatëse.

Ka filluar zbatimin e VKM nr. 245, datë 30.3.2016 për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike” i cili synon **eliminimin e rasteve të aksidenteve nga goditjet e rrymës elektrike të tensionit të ulët.**

Ulja me 4% është një objektiv që do të jetë prioritet në vijimësi i ISHTI, në kuadër të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve si në aspektin e sigurisë dhe cilësisë ashtu edhe në atë ekonomik si dhe në mbrojtjen e ambientit për një cilësi më të lartë të pastërtisë së ajrit.

Funksionimi efektiv i Infrastrukturës së Cilësisë sipas praktikave më të mira europiane është një domosdoshmëri dhe mbështetje e rëndësishme për një treg të sigurtë për konsumatorët. Plotësimi i mëtejshëm i nevojave të fushave të ekonomisë me standarde europiane e ndërkombëtare do të kontribuojë në aftësitë inovative të vendit, rritjen e konkurrencës së biznesit vendas në tregun shqiptar dhe atë jashtë tij si dhe rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara në tregun vendas në mbrojtje të jetës dhe shëndetit të njerëzve.

Politikat e zhvillimit të standardizimit janë fokusuar në përmirësimin e legjislacionit dhe procedurave të Drejtorisë së Standardizimit, zbatimin e parimeve të standardizimit. Miratimi i VKM

"Për Veprimtarinë e Standartizimit", transponon Rregulloren e BE 1025/2012 "Për Standartizimin European". Gjithashtu, janë rishikuar dhe miratuar nga Bordi Drejtues i DPS 9 Rregullore të Brendshme të DPS, të cilat janë në përputhje të plotë me rregulloret e CEN&CENELEC dhe ndryshimet e tyre.

Aplikimi për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC. Baza ligjore, rregulloret e brendshme dhe gjithë procedurat e punës për organizimin dhe funksionimin e sistemit të standardizimit në Shqipëri janë në përputhje të plotë me kriteret dhe rregulloret e CEN&CENELEC. Në Prill 2017 u firmos Marrëveshja midis DPS dhe CEN e CENELEC, për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet DPS dhe dy organizmave europianë të standardizimit, si dhe vazhdimi i plotësisimit të të drejtave dhe detyrimeve të DPS si anetare e atashuar në keto organizma. Miratimi VKM "Për Veprimtarinë e Standartizimit" është një akt ligjor shumë i rëndësishëm që i shërben plotësisimit të kriterëve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC.

Adaptimi i standarteve europiane si standarte shqiptare dhe përkthimi i teksteve të atyre standarteve me interes për ekonominë e vendit, rritjen e numrit të shitjes së standarteve, rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për rolin e standardeve jepen si më poshtë⁹:

Treguesit : Numri i standardeve evropiane e ndërkombëtare të adoptuara si standarde shqiptare. (totali mbi 11,000 standarde deri në fund të 2020); Ne total janë adoptuar si st.Shqiptare **8,192** st.Europiane dhe janë adoptuar si st.Shqiptare **2,312** st.nderkombetare; ose **122%** krahasuar me numrin e standarteve pwr periudhwn 2014-mesi i vitit 2018, duke arritur nivelin prej **95.4%** kundrejt totalit të synuar deri në vitin 2020.

Treguesit : Rritja çdo vit me 2 % e numrit të standardeve të shitura dhe përdorura nga operatorët ; Ne total janë shitur **5,135** standarde ose **48%** e standarteve të parashikuara

Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për operatorët ekonomike dhe konsumatorët për rëndësinë e standardeve në produktet dhe shërbimet e ofruara në treg. Të gjitha standardet puro shqiptare në fuqi, ato të adaptuara si dhe standardet e shfuqizuara gjenden në Katalogun e Standardeve Shqiptare, që publikohet çdo vit. Katalogu gjendet online në faqen e internetit të DPS, www.dps.gov.al, në format letër dhe elektronik me CD. Gjatë periudhës 2015-Gusht 2017 janë shpërndarë mbi 700 Katalogë (në format letër dhe me CD); janë publikuar 13 Buletine Informativë të Standardeve (4 Buletine cdo vit), të cilët i janë shpërndarë, kryesisht elektronikisht, kompanive të biznesit, dhomave dhe shoqatave të tregtisë, universiteve, ministrive, institucioneve të infrastrukturës së cilësisë.

⁹ *Shitja e standardeve është në rënie nga viti 2015 e 2016, sepse nuk furnizojmë me Kosovën me st. Shqiptare, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së re (Maj 2017) DPS-CEN&CENELEC.

Janë dhënë 7 trajnime mbi standardet dhe rolin e tyre tek kompanitë private dhe tek Fakultetet e inxhinierisë informatike, bujqësore, mekanike, etj. janë organizuar aktivitete promovuese dhe sensibilizuese çdo vit në ditën botërore të standardeve, ku pjesëmarrja ka qenë e konsiderueshme; janë publikuar rreth 90 artikuj promovues dhe mbi 200 ekstrakte të fushave për standarde me interes për biznesin dhe ekonominë; komunikimet nëpërmjet faqes së internetit dhe mediave sociale DPS kanë qenë aktive dhe janë publikuar online në www.dps.gov.al të gjitha eventet e standardizimit përfshirë këtu edhe takimet dhe dokumentet e miratuara nga Bordi Drejtues, rregulloret, buletinet.

Katalogu i Standardeve Shqiptare, njoftime në Sekretariatit e ISO / IEC dhe CEFTA, artikuj të ndryshëm promovues, takimet me student dhe palë të interesuara, standardi më i ri i publikuar nga DPS, dialog me palët e interesuara. Si rezultat, numri i klikimeve për publikimet në mediat sociale: DPS facebook DPS Google + dhe DPS LinkedIn është rritur ndjeshëm krahasuar me vitet e kaluara numri i kërkesave për të marrë pjesë në punën teknike për adaptimin e standardeve nëpërmjet Komiteteve Teknike të DPS.



Politikat në fushën e akreditimit do mbështesin përmirësimet e legjislacionit përkatës për të reflektuar zhvillimet në nivel evropian, forcimin e kapaciteteve institucionale me qëllim afatmesëm njohjen e raporteve të testimi të laboratorëve testues të akredituar shqiptar në BE dhe në terma afat-gjatë njohjen e raporteve të çertifikimit dhe inspektimit.

Kuadri ligjor i nevojshëm për fushën e akreditimit është miratuar dhe është në përputhje të plotë me Rregulloren Europiane nr.765/2008 “Kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut”.

I gjithë dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të DPA është rishikuar në përputhje me kërkesat e Rregullores Europiane nr. 765/2008 dhe të standardit S SH ISO/IEC 17011:2004.

Në datën 11 Shtator 2014 është miratuar ligji “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Masat ligjore dhe nënligjore të ndërmarra kanë synuar fuqizimin institucional të strukturave drejtuese të sistemit të akreditimit.

Në datën 29.07.2015 është miratuar VKM nr. 667 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”. Në datën 9.9.2015 u miratuan Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 737 “Për tarifatat e akreditimit dhe të trajnimeve që zhvillohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit:” dhe VKM nr. 738 “Për mënyrën e pagesës së anëtarëve të Bordit të Akreditimit dhe të Grupeve Teknike të Punës”.



Në datën 27.07.2015, Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes ka miratuar: (i) Urdhërin nr. 3643/1 "Rregullorja e bordit të akreditimit"; (ii) Urdhërin nr. 3643/2 "Rregullorja e grupeve teknike të punës" dhe Urdhërin nr. 3643/3 "Procedura e trajtimit të ankesave dhe apelimeve".

Në datën 18.07.2017 me urdhërin 5199/1, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes ka miratuar disa ndryshime në Urdhërin nr. 3643/1, datë 27.07.2015: Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit".

Anëtarësimi në Organizatën Evropianë të Akreditimit është një nga arritjet më të rëndësishme në drejtim të pjesëmarrjes së Shqipërisë më të drejta të plota në strukturat europiane. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Europiane për Akreditim – EA, të zhvilluar në Budapest Hungari, në datë 25-26 Nëntor 2015, u zhvillua dhe ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes të Njohjes Reciproke¹⁰, ndërsa në Maj të vitit 2015 DPA u pranua anëtare me të drejta të plota në Organizatën Evropiane për Akreditim. Anëtarësimi me drejta të plota në EA, është jo vetëm plotësim i kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në fushën e akreditimit, por edhe dhënia e së drejtës së DPA për të marrë pjesë në vendimet e Organizatës Europiane për Akreditim duke shprehur dhe mbrojtur interesat e Qeverisë dhe biznesit shqiptar.

Treguesit : Nënshkrimi i Marrëveshjes me EA Organizatën Evropianë për Akreditim – (EA) dhe Anëtarësimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit anëtare me të drejta të plota janë dy nga treguesit e matjes së suksësit të Strategjisë janë realizuar plotësisht.

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit gëzon statusin e anëtarit me të drejta të plota në Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF) dhe anëtarit shok në Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve (ILAC). Gjithashtu në Korrik 2015 është aplikuar për firmosjen e EA-MLA në fushën e çertifikimit të sistemeve të menaxhimit, pranim i cili është pranuar dhe EA ka kryer vlerësimin e këtij aplikimi në datën 10-14 Prill 2017. Skemat e akreditimit që DPA ofron janë në përputhje me kërkesat e Rregullores Europiane 765/2008 dhe standardit S SH ISO/IEC 17011. Këto skema u vlerësuan edhe nga EA në vlerësimin e fundit të realizuar në Prill 2017.

Njohja e çertifikatave të lëshuara nga DPA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit u realizua në Maj 2018. Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit bëhet Anëtare nënshkruese e EA MLA¹¹ në fushën e çertifikimit të sistemeve të menaxhimit dhe inspektimit. **Kjo është një arritje e madhe pasi tashmë gjithë çertifikatat e lëshuara nga këta laboratorë të akredituar, do të jenë ekuivalente dhe të pranuar në nivel Evropian.**

Gjatë takimit të mbajtur më 25-26 Prill 2018 në Beograd, Këshilli i MLA mori në shqyrtim rezultatin e rivlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Bazuar në raportin e vlerësimit dhe në

¹⁰ Vendimi për pranimin e DPA si nënshkruese e marrëveshjeve të njohjes reciproke, në fushën e laboratorëve testues u morr në datë 2 Tetor 2015 në mbledhjen e Komitetit të Njohjeve Reciproke të Organizatës Evropiane për Akreditim, EA - MAC.

¹¹ Multilateral Recognition Arrangement;

raportin shtesë të ofruar nga Grupi i Task Forcës e krijuar për të shqyrtuar raportin e vlerësimit, anëtarët MAC¹² kanë konfirmuar se DPA përputhet plotësisht me kërkesat e EA-se dhe se ka fituar besimin e mjaftueshëm lidhur me performancën operationale dhe teknike të aktiviteteve të akreditimit të mbuluara nga Organizata Europiane e Akreditimit. OEA konfirmoi se DPA mbetet nënshkruese e EA-MLA në fushën e testimit dhe bëhet anëtare nënshkruese në fushën e Çertifikimit të Sistemit të Menaxhimit dhe Inspektimit. Vizita e ardhshme e rivlerësimit do të bëhet në 4 vjet pas datës fillestare të planifikuar të vlerësimit fillestar, prill 2021.

Progresi i arritur në drejtim të akreditimit të organeve të konformitetit ka qënë në nivel jo të lartë.

Deri në fund të 6 mujorit të dytë të vitit 2018 janë regjistruar 71 OVK të akredituara dhe përkatësisht, 46 laboratorë, 9 organizma çertifikues dhe 16 organizma inspektues. Gjatë 2017 janë regjistruar 25 aplikime të reja ndërsa në 6 mujorin e parë të 2018 janë regjistruar 21 aplikime të reja. Në total numërohen 71 vizita mbikqyrëse (përkatësisht 51 për vitin 2017 dhe 20 për vitin 2018).

Treguesi: Numri i organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituar 185 deri në fund të vitit 2017 është realizuar në masën **46%** , 71 OVK.

Ka pasur gjithashtu 2 pezullime në vitin 2017. Gjatë kësaj periudhe ka pasur rreth 143 aktivite për akreditimin.

DPA i kushtuar një vëmendje të veçante ngritjes së kapaciteteve të stafit të saj dhe grupeve të interesit. Një sërë trajnimesh dhe seminaresh janë organizuar siç shihet në kutinë 1.

Treguesi: Numri i trajnimeve për stafin dhe vlerësuesit e DPA-së është realizuar në masën **146%** për vitin 2017 me një total prej 146 kundrejt 138 personave të trajnuar

Në 9 Qershor 2018 festohet në mbarë botën Dita Ndërkombëtare e Akreditimit dhe në këtë kuadër janë shpërndarë materiale dhe video promovuese në mediat kryesore (mediat online dhe TV, website të Dhomës së Tregtisë) si dhe është promovuar roli i Akreditimit gjerësisht në mediat sociale(Facebook; Twitter etj).

Gjithashtu në muajin Shkurt 2017 u organizua aktiviteti promovues me temë “Akreditimi – përfitim për biznesin, garanci për konsumatorin” ku morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës.

¹² EA Multilateral Agreement Council / Këshilli i Marrëveshjes Shumëpalëshe

Kutia 1: Trajnime të organizuara nga DPA ne 2017

14-15 Nëntor **trajnim për standardin 17020**: Njohje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17020:2012 dhe procedurat e Akreditimit të organizmave inspektues (25 persona të trajnuar).

21-22 Nëntor **trajnim për standardin 17025:2005** – Pjesëmarrje nga stafi, OVK, Akademike etj (25 persona të trajnuar). Njohje me kërkesat e standardit ISO / IEC 17025: 2005 dhe procedurat e akreditimit për laboratorët testues dhe kalibrues - 25 perona të trajnuar.

23-24 Nëntor **Trajnim për standardin 17025:2005** - Pjesëmarrje nga stafi, OVK, Akademike etj. 25 perona të trajnuar. Njohje me kërkesat e standardit ISO / IEC 17025: 2005 dhe procedurat e akreditimit për laboratorët testues dhe kalibrues.

21 Shkurt - **Trajnim për standardin e rishikuar ISO 17025:2017** - Njohja me kërkesat e reja të standardit 17025 (2017) – Hotel Opera organizatore DPA & PTB (mbështetje për infrastrukturën e cilësisë për Shqipërinë) – përfaqësues të stafit të laboratorëve të akredituar dhe atyre që kanë aplikuar për akreditim 28 persona.

22-23 Shkurt – **Trajnim për standardin e rishikuar ISO 17025:2017** - Njohja me kërkesat e reja të standardit 17025 (2017) – 26 persona, vlerësues të jashtëm të DPA, stafi i DPA dhe përfaqësues nga institucionet e interesuara.

12 -13 Prill **trajnim për standardin ISO /IEC 17025**: Opinione dhe Interpretime; si dhe Promovim i rolit të akreditimit – organizatore Misioni TAIEX në bashkëpunim me DPA. (40 persona)

26 -27 **Maj trajnim i organizuar nga TAIEX** në bashkëpunim me DPA mbi “Akreditimin e trupave certifikues për sistemet e menaxhimit të sigurisë rrugore” (30 pjesëmarrës).

Në fushën e metrologjisë vazhduan përpjekjet për përmirësimin e legjislacionit duke e harmonizuar atë me dokumentat dhe praktikat e mira europiane. Më datë 23.09.2015 Parlamenti miratoi ndryshimet në ligjin për metrologjinë. Ndryshimet në ligjin “Për Metrologjinë” parashikojnë lehtësimin e procedurave për biznesin, konkretisht për prodhuesit dhe importuesit, duke i sjellë praktikat shqiptare më pranë atyre europiane, si dhe rrit bashkëpunimin midis Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë me Qendrën Kombëtare të Biznesit apo edhe drejtorinë e Doganave, lidhur me shkëmbimin e informacionit. Zhvillimi i sistemit kombëtar të metrologjisë parashikon, ndër të tjera, mbrojtjen e shtetit dhe konsumatorëve nga matjet e pasakta.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë miratuar edhe akte të tjera ligjore, përkatësisht:

1. Ligji nr. 9/2018 “Për një ndryshim” në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008 “Për Metrologjinë”, të ndryshuar
2. Udhëzimi nr. 3078, datë 18.04.2016 “Për miratimin e tarifave tavan që do të perdorin Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga DPM, si dhe laboratorët e etaloneve kombëtare, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”
3. Udhëzimi nr. 1897/3, datë 3.08.2016 për miratimin e rregullores “Për kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti”
4. Udhëzimi nr. 20, datë 4.12.2017 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 1897/3, datë 3.08.2016 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat dhe procedurat e miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenjë konformiteti”

5. Urdhëri i Ministrit të MZHETTS, nr. 7025, datë 24.08.2017 “Për miratimin e rregullores për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në Metrologjinë Ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumentave matës”

Ka vijuar punë për kontrollin e instrumenteve matës. Lidhur me kontrollin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar janë realizuar rreth 214 737 verifikime të instrumentave matës.¹³

Treguesi: *Numri i verifikimeve të instrumenteve matës në përdorim: Në total, për periudhën 2014 deri Gusht 2018, janë kryer 214 737 verifikime të instrumentave matës. 6 here me shume se parashikimi deri në vitin 2020 (30777)*

Në total, për vitin 2014, nga Drejtoria e Inspektimit Metrologjik (DIM) pranë DPM-së u morën 43 masa administrative (vendime me gjobë) nga të cilat 2 masa administrative për parapaketimet dhe 41 masa administrative për instrumentat matës. Në vitin 2015 u morën 14 masa administrative (vendime me gjobe) për instrumentat matës.

Në vitin 2014 në DPM ***ka filluar regjistrimi i prodhuesve dhe importuesve të parapaketimeve dhe shisheve enë matëse***, referuar Urdhërit të Ministrit me nr.193, datë 09.03.2009 “Për Regjistrimin e prodhuesve dhe importuesve të produkteve të parapaketuara dhe shisheve enë matëse”.

Në total, në database e DPM, për periudhën 2014 deri Gusht 2018, janë të regjistruara 290 subjekte të prodhuesve dhe importuesve të produkteve të parapaketuara dhe shisheve enë matëse.¹⁴

Zgjerimi i bazës etalonuese të laboratorëve të strukturave përkatëse të DPM-së, ka krijuar mundësinë e sigurimit të disa instrumentave matës, përkatësisht:

<p><u>Për vitin 2014:</u> Instrumenta matës për kompletimin e laboratorit të volumeve -Autolaborator për DML dhe DIM -Regjistruues force në tërheqje</p>	<p><u>Për vitin 2015:</u> -Kontaliter - Lazer skaner - Instrumenta matës për laboratorine matjeve të pH dhe konduktivitetit - Instrument matës ultrasonik për laboratorin e volumeve - Pajisje elektrike për laboratorine madhësive elektrike - Etalone për laboratorin e masës</p>
<p><u>Për vitin 2016:</u> - Autolaborator për parapaketimet - Pajisje për laboratorin e masës, laboratorin elektrik dhe lagështirës</p>	<p><u>Për vitin 2017:</u> - Kalibrator për rikalibrim të aparatit matës DMP-40</p>

Në fund të vitit 2016, Sektori i Produkteve të Paketuar ka zgjeruar kapacitetet teknike me një autolaborator të parapaketimeve të pajisur me instrumente matëse, që shërbejnë për kryerjen e

¹³ Për vitin 2014 janë realizuar 45 174 verifikime të instrumentave matës; Për vitin 2015 janë realizuar 45 745 verifikime të instrumentave matës; Për vitin 2016 janë realizuar 45 071 verifikime të instrumentave matës; Për vitin 2017 janë realizuar 46 147 verifikime të instrumentave matës dhe Për periudhën Janar-Gusht 2018 janë realizuar 32 600 verifikime të instrumentave matës;

¹⁴ Gjatë vitit 2014 u regjistruan 94 subjekte; Gjatë vitit 2015 u regjistruan 49 subjekte; Gjatë vitit 2016 u regjistruan 48 subjekte; Gjatë vitit 2017 u regjistruan 87 subjekte; Gjatë periudhës Janar-Gusht 2018 u regjistruan 12 subjekte

kontrollit statistikor të parapaketimeve, për të ofruar shërbimin e miratimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve shqiptarë, sipas kërkesës së tyre. Autolaboratori është pajisur me udhëzues pune dhe procedura teknike, sipas manualit të cilësisë të DPM dhe rekomandimeve të OIML dhe guidave të EELMEC. *Duke qene se miratimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve është vullnetar, deri më tani, asnjë subjekt nuk ka kërkuar miratim sistemi.*

DPM i kushtuar një vemendje të veçante ngritjes së kapaciteteve të stafit të saj dhe grupeve të interesit. Një sërë trajnimesh dhe seminaresh janë organizuar siç shihet me poshte.

Kutia 2: Trajnime të organizuara nga DPM

- ***Përgatitje për deklarimin e aftësive matëse kalibruese (CMC) në databasen e BIPM*** për 3 laboratorë të DPM. Është në proces implementimi, i sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas standartit ISO 7025: 2017.
- ***Trajnim i organizuar me fokus fushën e analizuesve të frymës, në kuadër të aktiviteteve të EURAMET-it*** me pjesëmarrje të përfaqësuesve të vendeve të Ballkanit dhe policisë së shtetit. Ky aktivitet u realizua në datë 16-17.06.2016.
- ***Trajnime në kuadër të projektit Rajonal për Mbështetje të Infrastrukturës së Cilësisë për Europën Juglindore***, ku janë zhvilluar keto aktivitete: (i) Zbatimi i standartit 17025:2017 dhe (ii) Rregulli i vendimarrjes për specialistët e DMSHI në mars 2018.
- ***Trajnim për kërkesat e ISO 17025:2017*** për përfaqësuesit e laboratorëve të DPM që janë vlerësues të DPA në shkurt 2018.
- ***Trajnim “Hyrje në Mbikqyrjen e Tregut të Instrumenteve Matës dhe Kontrolli i produkteve të parapaketuara”*** në Janar 2018.
- Në datat 14 dhe 15 Qershor 2017 sektori i parapaketimeve ka trajnuar metrologët e DPM të Sektorit të Shërbimeve Nr.1 Tiranë dhe Sektorit të Shërbimeve Nr.2 Fier, ***mbi instrumentat matëse që përdoren në kontrollin e produkteve të parapaketuara.***
- ***Trajnime në kuadër të projektit Quality Infrastructure in the Western Ballcans*** ku janë përfshirë: (i) Konferenca e Metrologjisë Ligjore (NE 17) mbi implementimin e NAWI, MID; Maj 2018 (ii) Zbatimi i MID për instrumentat peshues automatik dhe Implementimi i NAWI për instrumentet peshues jo-automatik Shtator 2018

Ngritja e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut në vitin 2016 ishte një nga objektivat e strategjisë në kuadër të zhvillimit institucional.

Nëpërmjet vrojtimeve dheurvejimit të tregut janë ndërmarrë masa për rritjen e efikasitetit në kontrollin e produkteve të parapaketuara, duke synuar realizimin e objektivit: *Rritja e shkallës së mbrojtjes së konsumatorëve nga matjet e pasakta nëpërmjet rritjes me 2% për çdo vit të numrit të verifikimeve dhe inspektimeve të instrumenteve matës në treg dhe në përdorim.* Nga Inspektoriati Shtetëror për Mbikqyrjen e Tregut (ISHMT) janë kryer *inspektime për parapaketimet dhe inspektime për instrumentat matëse.* Gjatë vitit 2017¹⁵ në zbatim të Ligjit nr. 9875 “Për Metrologjinë”, i

¹⁵ Inspektimet nga ISHMT, kanë filluar në korrik 2017 për shkak të kalimit të inspektimit në sistemin “e-inspection” në zbatim të Urdhërit nr. 284, datë 03.05.2017 “për kryerjen e inspektimeve on-line” të Inspektorit të Përgjithshëm të IQ. Kalimi në këtë sistem

ndryshuar dhe VKM nr. 1352, datë 03/10/2008 “Rregullore për Parapaketimet” janë inspektuar me metodën e vrojtimit 35 subjekte, të cilat tregtonin me pakicë produkte të parapaketuara. Në këto subjekte janë kryer testime në trajtë sondazhi për 409 produkte, nga të cilat 131 rezultuan me gabime të matjeve jashtë tolerancave të lejuara. Për 3 subjekte janë vendosur masa administrative për korrigjimin e parregullsive, tërheqjen nga tregu i produkteve që nuk janë në konformitet dhe në kundërshtim me kërkesat metrologjike, dërgimin e tyre te prodhuesit/importuesit me qëllim ripaketimin dhe korrigjimin e mospërputhjeve. Gjithashtu janë kryer inspektime në 13 subjekte me metodën e kontrollit statistikor në ambientet e prodhuesve/importuesve të parapaketimeve, ku janë kryer kontrole për 37 produkte me anë të marrjes së mostrave, të cilat rezultuan me gabime të matjeve brenda tolerancave ligjore të lejuara.

Në periudhën Janar – Qershor 2018 janë kryer 98 inspektime të subjekteve që tregëtojnë me pakicë produkte të paketuara, ku nga kontrolli për 958 produkte të paketuara, 212 produkte rezultuan me gabime të matjeve jashtë tolerancave të lejuara. Ndaj 3 subjekteve janë marrë dënime administrative për korrigjimin e parregullsive, tërheqjen nga tregu i këtyre produkteve që janë në jokonformitet, dërgimin e tyre te prodhuesit/importuesit me qëllim ripaketimin dhe korrigjimin e mospërputhjeve.

Treguesi: *Ulja çdo vit me 8% e mospërputhshmërisë së produkteve të para paketuara në treg*

Janë kryer 326 inspektime të subjekteve prodhues dhe importues të parapaketimeve. Në këto subjekte janë kryer kontrole me metodën e marrjes së mostrave për 758 produkte të paketuara, nga të cilat rezultuan se 40 produkte janë me gabime të matjeve jashtë tolerancave ligjore të lejuara. Ndaj këtyre subjekteve janë marrë në total 18 masa administrative nga të cilat 14 masa administrative me vendime gjobë dhe 4 masa administrative për ndalim të hedhjes në treg të produkteve, me qëllim korrigjimin e mospërputhjeve. Gjatë kësaj periudhe janë marrë masa administrative me ndalim për t'u hedhur në treg për 2910 (copë) produkte të paketuara.

Të dhënat e marra gjatë kontrolleve në pikat e shitjes me pakicë të produkteve të parapaketuara janë përdorur për të ngritur një hartë të riskut për gjurmimin e produktit tek importuesit dhe parapaketuesit të cilët kanë edhe përgjegjësitë kryesore për sa i përket konformitetit të parapaketimeve.

Janë kryer inspektime në 13 subjekte me metodën e kontrollit statistikor në ambientet e prodhuesve/importuesve të parapaketimeve, ku janë kryer kontrole për 37 produkte me anë të marrjes së mostrave. Nga këto kontrole u identifikuan gabime të matjeve brenda tolerancave ligjore të lejuara.

ISHMT duke patur një staf të ri, fusha të reja inspektimi të paeksploruar më parë nga institucione të tjera, i ka dhënë një rëndësi të veçantë edhe rritjes së shkallës së njohurive të inspektorëve nëpërmjet

kërkonte kohën e duhur për trajnimin e stafit dhe hedhjen në sistem të listë verifikimeve dhe dokumentave standard referuar procedurës së inspektimit në zbatim të Ligjit 10443, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

trajnimeve mbi procedurat standarde të inspektimit, legjislacionit të veçantë teknik sipas grup produkteve përkatëse, etj. Inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) kanë marrë pjesë në disa trajnime të organizuar nga GIZ, nga Project Quality Infrastructure in the Western Balkans, IQ, etj.

Në fokus të punës së ISHMT është edhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve në lidhje me sigurinë e produkteve në treg si dhe i operatorëve ekonomikë për detyrimet që duhet të plotësojnë për ofrimin e produkteve të sigurta në treg në zbatim të kriterëve të përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Në vitin 2017 dhe në vitin 2018, në bashkëpunim me MFE, mbështetur nga GIZ me rastin e festës së Fëmijëve në 1 Qershor ka organizuar fushatën e ndërgjegjësimit për “Sigurinë e lodrave”. Fushatat kanë konsistuar në shpërndarjen e fletëpalosjeve me një informacion të hollësishëm dhe të vlefshëm për prindërit lidhur me elementët kryesorë, që një produkt lodër duhet të përmbajë në mënyrë që të konsiderohet i sigurtë, të bluzave dhe çantave ku janë stampuar mesazhe informuese dhe sensibilizuese. Në vitin 2018 po në lidhje me sigurinë e lodrave u organizua një workshop me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të grupeve të interesit, institucioneve publike duke konsistuar në njohjen nga ana e operatorëve ekonomikë që importojnë/prodhojnë lodra, të detyrimeve që duhet të plotësojnë në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Me mbështetjen e GIZ në kuadrin e Projektit “Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar me Acquis e BE-së” janë realizuar 5 botime sensibilizuese për operatorët ekonomikë në lidhje me informimin e tyre mbi përgjegjësitë dhe detyrat e tyre për të garantuar zbatimin e kriterëve ligjore dhe ofrimin në treg të produkteve apo pajisjeve/instalimeve të sigurta për konsumatorin.



Është bërë funksional website i ISHMT¹⁶ ku është pasqyruar çdo informacion i nevojshëm për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë. Gjithashtu është përcaktuar edhe një rubrikë e veçantë për ankesat e konsumatorëve.

Me realizimin e objektivit për ***“Uljen me 10% e shkallës së mos konformiteteve të produkteve në treg çdo vit krahasuar me vitin paraardhës”*** ISHMT ka forcuar masat inspektuese dhe ndërmarrjen e masave administrative. Gjatë vitit 2017 nga DMP janë kryer inspektime për sigurinë e lodrave në zbatim të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” dhe VKM nr. 262/2013 për miratimin e rregullit teknik “Për sigurinë e lodrave”. Janë realizuar 14 inspektime online nga sektori Qelq/Këpucë/Detergjentë/Siguria e Produkteve në 13 subjekte të kategorizuar si importues kryesor të produkteve lodra. U kontrolluan 161 artikuj lodra nga të cilat 117 produkte rezultuan jo në konformitet, pa markim apo pa deklaratë konformiteti. U vendosën 4 masa urgjente “Ndalim i Përhershëm i tregtimit” dhe më tej “Shkatërrim” për 16 artikuj

¹⁶ www.ishmt.gov.al

lodra (569 copë produkte lodra në total)¹⁷. 2 artikuj rezultuan produkte të publikuara nga sistemi RAPEX i Komisionit Europian. Gjithashtu janë vendosur masa administrative gjobë ndaj 8 subjekteve.

Në periudhën Janar-Qershor 2018 nga Sektori Qelq/Këpucë/Detergjentë /Siguria e Produkteve janë kryer 14 inspektime për sigurinë e lodrave ku u kontrolluan 91 artikuj lodra nga të cilat 76 produkte rezultuan jo në konformitet, pa markim apo pa deklarata konformiteti. U vendosën 4 masa urgjente “Ndalim i përhershëm i tregtimit” dhe më tej “Shkatërrim” për 5 artikuj lodra (1372 copë produkte lodra në total) dhe u vendosën 12 masa administrative gjobë.

Gjithashtu në këtë periudhë janë kryer inspektime për detergjentët që bëhen të disponueshëm për konsumatorin, në zbatim të ligjit nr. 10 216, datë 21.1.2010 “Për Detergjentët” dhe VKM nr. 669 datë 28.09.2011 “Për Etiketimin dhe të dhënat e përbërësve të detergjentëve”. Janë realizuar 71 inspektime të subjekteve të konsideruar prodhues/importues kryesor të detergjentëve. Janë kontrolluar 328 artikuj

Tabela 1: Numri i inspektimeve

Viti	Të dhëna	Fusha e inspektimit	
		Siguria lodrave	Detergjentët
2017	Numër inspektimesh	13	
	Masa Urgjente	4	
	Dënime administrative	8	
	Produkte të kontrolluara	161	
	Produkte jo në konformitet	117	
2018	Numër inspektime	14	71
	Masa urgjente	4	1
	Dënime administrative	12	8
	Produkte të kontrolluara	91	328
	Produkte jo në konformitet	76	39

detergjentë nga të cilat 39 kanë rezultuar jo në konformitet. Është marrë 1 masë urgjente me vendim të ndërmjetëm për produkt pluhur larës matik në sasi rreth 4000 kg, si produkt jo në konformitet etiketimi pa dokumentacion dosje teknike dhe janë vendosur edhe 8 masa administrative. 17 procedura inspektimit janë ende në vijim, pasi subjekteve ju është lënë detyrë që të paraqesin dokumentacionin konform legjislacionit në fuqi, brenda afatit që parashikohet në ligjin nr. 10433 “Për inspektimin në RSH” .

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ka kryer *inspektime për parapaketimet dhe inspektime për instrumentët matëse deri në mars të 2016, periudha kur filloi të funksionojë* Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, i cili ishte një nga objektivat e strategjisë në kuadër të zhvillimit institucional.¹⁸

Treguesi: Në total, për periudhën numri i inspektimeve është 9456 inspektime

¹⁷ Lodrat ndaj të cilave janë marrë masa urgjente paraqesin rreziqe kimike (alergjene ftalate, metale të rënda, CMR të kategorizuara nga legjislacioni ndërkombëtar për kimikate) , rreziqe të gëlltitjes dhe mbytjes së fëmijës. Mungesa e markimit CE nënkupton mundësinë potenciale të këtyre rreziqeve në shkallë të lartë duke vënë në rrezik sigurinë dhe shëndetin e grupmohës për të cilën është e destinuar.

¹⁸ Referuar periudhës të përmendur janë realizuar: Për vitin 2014 janë realizuar 5000 inspektime Për vitin 2015 janë realizuar 4 101 inspektime Për periudhën Janar- Mars 2016 janë realizuar 329 ninspektime

Sigurimi i burimeve njerëzore të duhura për mirëfunksionimin e inspektoriatit ka qënë një nga sfidat më të cilat është përballur sektori i metrologjisë. Numri i kufizuar i fushave të inspektimit dhe numri i vogël i inspektimeve të kryera, lidhet me mungesën e stafit në këtë drejtori si dhe me kohën që kërkojnë procedurat e rekrutimit nga DAP. Deri në Qershor 2017 nga 4 (katër) sektorët që ka DMP, ka funksionuar vetëm sektori i metrologjisë, i cili ishte sektor që u transferua nga DPM në ISHMT dhe mbas Qershorit 2017 u arrit të krijohet edhe një grup inspektimi nga sektori Qelq/Këpucë/Detergjentë/Siguria e Produkteve. Për vitin 2017, DMP kishte të emëruar vetëm 34.3 % të stafit. Në dy sektorët e tjerë respektivisht për produktet elektrike dhe produktet mekanike nuk kishte të emëruar asnjë inspektor. Në maj 2018 përqindja e stafit arriti në 54% kundrejt totalit që është parashikuar në organigramën e miratuar. U emëruan inspektorëve të rinj në sektorin e produkteve elektrike dhe 2 në sektorin e Qelq/Këpucë/Detergjentë/Siguria e Produkteve. Sektori i produkteve mekanike vazhdon të jetë pa asnjë inspektor.

Mungesa e përvojës dhe fushat e reja të inspektimit që janë në fokusin e ISHMT-së shtrojnë domosdoshmërinë e rritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve si dhe aktiviteteve të tjera që konsistojnë në ofrimin e eksperiencave më të mira të vendeve të BE apo vendeve të Rajonit. Gjatë gjatë vitit 2017 dhe periudhës janar-qershor 2018 është siguruar pjesëmarrja e inspektorëve të ISHMT-se në një sërë trajnimesh në nivel kombëtar dhe rajonal. Në kuadrin e Projektit “Quality Infrastructure in Western Balkans” janë realizuar 4 trajnime (numri pjesëmarrësve 8) mbi: sistemet e shpejta shkëmbimit të informacionit për raportimin e produkteve joushqimore të rrezikshme RAPEX/ICSMS të KE; komunikimi dhe mekanizmat monitorues të Mbikëqyrjes së Tregut (MT); çështjet teknike të kontroleve të MT në sektorin e produkteve elektrike, etj. Në kuadrin e projektit të GIZ “Harmonization of Economic and Trade legislation with EU acquis” janë kryer një sërë trajnimesh me pjesëmarrjen e inspektorëve të sektorit të metrologjisë, sektorit të qelq/këpucë/detergjentë/siguria produkteve, sektorit të produkteve elektrike (15 pjesëmarrës/trajnim) ku janë trajtuar principet bazë dhe praktikat më të mira për rritjen e efikasitetit gjatë kontrollit për zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi, lidhur me grupe produktesh të caktuar si: lodra, detergjentë, produktet elektrike si dhe mbi parapaketimin, instrumentat matës, etj. Nga IQ janë kryer 3 trajnime për njohjen me sistemin e inspektimit online. Numri i pjesëmarrësve në total 40 persona. Në tetor 2018 fillon zbatimi i Projektit EuropeAid/137616/IH/SER/AL “Technical Assistance to carry out effective market surveillance in line with acquis” ku janë parashikuar edhe trajnime për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve njerëzore të ISHMT-së.

Hartimi i një kuadri ligjor të harmonizuar në shumë fusha e ka specifikuar kuptimin e tregut të brendshëm, duke modeluar, për rrjedhojë, parimin e lëvizjes së lirë të mallrave në terma konkretë për produkte specifike. Legjislacioni i harmonizuar në shumë fusha e ka specifikuar kuptimin e tregut të brendshëm, duke modeluar, për rrjedhojë, parimin e lëvizjes së lirë të mallrave në terma konkretë për produkte specifike. Shumë prej kufizimeve kryesore në lëvizjen e lirë të mallrave tashmë janë hequr.

Ligji “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore” krijon mbrojtjen horizontale për sigurinë e produkteve që i adresohen konsumatorëve, kur për këto produkte nuk ekziston akoma

legjislacion sektorial si edhe për risqet apo tipet e risqeve, që nuk mbulohen nga legjislacioni i veçantë. Nga ana tjetër, ligji horizontal për tregtimin e produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut përcakton detyrimet e operatorëve ekonomikë për të vendosur në treg produkte që janë në përputhje me kërkesat ligjore në lidhje me to. Kjo pakete ligjore transponon direktivën e sigurisë së përgjithshme dhe parimet e dispozitat përkatëse të paketës/kuadrit të ri ligjor europian të vitit 2008 në këtë fushë, por jo vetëm. Për herë të parë, në këtë ligj parashikohet kontrolli i produkteve që hyjnë në territorin shqiptar nga Autoritetet Doganore, të cilat mund të pezullojnë zhdoganimin e produkteve që paraqesin risk serioz për shëndetin, sigurinë apo interesat të tjerë publikesi dhe detyrimi i personave përgjegjës për garantimin e sigurisë së instalimeve që janë në përdorim, si ashensorë, shkallë lëvizëse, pajisje nën presion, etj.

Gjatë periudhës raportuese u plotësua me tej kuadri ligjor me miratimin e rreth 19 akte nënligjore që përcaktojnë rregulla të qarta për sigurinë lidhur me prodhimin dhe përdorimin e paisjeve të ndryshme, makinerive, pajisjeve elektrike etj. Miratimi i këtyre akteve nën ligjore e tejkalon planin e parashikuar fillimisht me hartimin e miratimin e vetëm 13 akteve nënligjore.

Ndërkohë janë hartuar dhe pritët të kalojnë për miratim brenda vitit 2018 të tjera akte nënligjore si vendimi “Mbi aprovimin e rregullit teknik mbi pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa limiteve të tensionit “dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara dhe shfuqizimin e VKM nr. 1061, datë 23.12.2015; VKM për miratimin e rregullit teknik për instrumentet e peshimit jo automatik dhe shfuqizimi i VKM Nr. 77, datë 30.1.2013 “Për miratimin e rregullit teknik për instrumentet e peshimit jo automatik” dhe VKM për miratimin e rregullit teknik mbi “Përputhshmërinë elektromagnetike”.

Risqet kryesore dhe masat zbutëse

- *Mungesa e stafit dhe vonesat në rekrutimin e inspektorëve të rinj sjell mosfunksionimin e ISHMT-së me kapacitet të plotë të burimeve njerëzore.*
- *Mungesa e përvojës dhe fushat e reja të inspektimit që janë në fokusin e ISHMT-së shtrojnë domosdoshmërinë e rritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve si dhe aktiviteteve të tjera që konsistojnë në ofrimin e eksperiencave më të mira të vendeve të BE apo vendeve të Rajonit.*
- *Mungesa e ambjenteve të ambienteve të punës dhe infrastrukturës së nevojshme për mbarëvajtjen e përditëshme të aktivitetit të ISHMT. Përvec një zyre që dispononte ISHMT brenda ambienteve të MFE i janë vënë në dispozicion edhe dy ambiente të tjera (rreth 70 m²), por që nuk mbulojnë nevojat e këtij institucioni për funksionimin normal të punës.*
- *Mungesa e mjeteve të transportit sjell pengesa në kryerjen e inspektimeve me shtrirje në të gjithë vendin. Si një institucion i ri ka mungesa edhe në instrumenta, pajisje, laboratorë portabël që janë të nevojshëm për kryerjen e inspektimeve sipas grupeve të produkteve të caktuar. Me buxhetin e limituar që disponon ky institucion është në proces blerja e 4 pajisjeve/instrumentave për sektorin e metrologjisë/DMP të nevojshëm për procesin e verifikimit dhe kontrollit dhe të 1 mjeteve transporti. ISHMT ka aplikuar edhe për projekte për të siguruar fonde në pasurimin e bazës materiale (instrumenta, laboratorë portativë, pajisje dhe materiale ndihmëse) të nevojshme për procesin e inspektimit, kontrollit dhe verifikimit.*

- *Mungesa e një sistemi të integruar të bazës së të dhënave.* Në mungesë të trashëgimit të një baze të dhënash nga strukturat e mëparëshme është punuar shumë për krijimin e bazës të të dhënave për subjektet që janë në fokusin e kontrollit të këtij institucioni. Kjo bazë të dhënash që sapo është krijuar dhe që kërkon përpunim të mëtejshëm dhe përditësim periodik do të shërbejë për të hartuar metodologjinë e riskut.
- *Mungesë në metodologji dhe akte procedurale mbi marrjen e mostrave, të përcaktimit të dënimeve administrative kur nuk janë të shprehura në mënyrë eksplcitë në ligjet specifike, në vlerësimin e rrishtit etj, për grupe produktesh të caktura që diktohen nga legjislacioni specifik, por që duhet të jenë edhe në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.10443 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.*
- *Mosrealizimi i procedurave të tenderit për kalibrimin e etaloneve kombëtare të metrologjisë në periudhën 2016-2017, ka qenë një pengesë e realizimit të disa aktiviteteve të DPM-së.*

iii) Përmirësimi i kuadrit ligjor për sigurinë e barnave dhe ofrimin e shërbimit farmaceutik bashkëkohor për përdoruesit e barnave.

Në kuadër të reformave të marra në sektorin e shëndetësisë, një prej ndryshimeve themelore të realizuara është ngritja e strukturës institucionale për regjistrimin e pajisjeve mjekësore duke rritur sigurinë e përdorimit të tyre. Me ndryshimet e bëra gjatë vitit 2015 Qendra Kombëtare e

Barnave u kthye në Agjenci Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM)¹⁹. Tashmë me ngritjen e Agjencisë është krijuar dhe një sektor i veçantë i cili ka në përgjegjësi të tij regjistrimin e pajisjeve mjekësore dhe krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore në Republikën e Shqipërisë.

Treguesi:

*Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve mjekësore në 2015 - **realizuar***

Regjistrimi i pajisjeve mjekësore do të mundësojë që për herë të parë pas 25 vitesh, pas liberalizimit të tregut mjekësor, pajisjet mjekësore që do të qarkullojnë në Shqipëri do të jenë më të sigurta, pasi do të jenë të certifikuara me markë CE, ashtu sikurse e parashikojnë edhe ligjet e Bashkimit Evropian. Kjo do të ndikojë në rritjen e sigurisë të qytetarëve shqiptarë të cilët i drejtohen sistemit spitalor dhe atij ambulator.

Hapa të rëndësishëm janë marrë në drejtim të ngritjes së sistemeve on-linë të inspektimit, por ende mbetet problematik monitorimi i plotë dhe në kohë reale i gjithë subjekteve farmaceutike.

Në Korrik 2017 është zbatuar sistemi "e-Inspektimi", dhe janë realizuar inspektimet online në veprimtarinë inspektuese të Agjencisë, në përputhje me Udhëzimet, Urdhrat dhe orientimet e

¹⁹ Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), vepron në zbatim të ligjit nr. 105/2014, datë 31.07.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, si dhe VKM nr. 24, datë 14.01.2015, “Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”.

Inspektoratit Qendror.²⁰ Gjatë gjatë vitit 2017, janë inspektuar dhe kontrolluar 424 subjekte inspektimi nga të cilat: 352 subjekte farmaceutike dhe agjenci farmaceutike; 48 raste depo importuese dhe/ose shpërndarës farmaceutikë; Për vitin 2017 janë marrë 25 masat administrative: dënime me gjobë dhe/ose sekuestrim i barnave dhe/ose të konfiskuara, të vendosura për subjektet farmaceutike si: depo importuese; farmaci; agjenci farmaceutike. Në veprimtarinë inspektuese të Agjencisë mbetet problematike monitorimi në kohë reale i subjekteve farmaceutike, pa qenë pjesë aktive e procesit të licencimit. Licencimi i subjekteve farmaceutike me vetëdeklarim, efektivisht ka sjellë problematika në shërbimin farmaceutik në drejtim të mungesës së ofrimit të shërbimit nga stafi i kualifikuar dhe profesional i detyrueshëm sipas ligjit për barnat apo mospërbushjes së praktikave të ruajtjes dhe tregtimit të mirë të barnave.

Hapa të rëndësishëm u morën në drejtim plotësimit të kuadrit ligjor në fushën e produkteve kozmetike dhe forcimit të kontrollit të tregut. Përbushja e kërkesave për tregtimin e produkteve kozmetike sipas standardeve europiane, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe garantimin e funksionimit të tregut të brendshëm, është qëllimi i një ligji “Për produktet kozmetike”²¹. Miratimi i ligjit përbën përpjekjen e parë në hartimin e një akti të tillë ligjor dhe si një nga angazhimet e

Treguesi:

Miratimi i legjislacionit për kozmetikën – realizuar plotësisht

Ministrisë së Shëndetësisë në kuadër të lëvizjes së lirë të mallrave dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë europian në fushën e produkteve kozmetike. Ligji i ri është një hap i rëndësishëm për rregullimin e fushës së produkteve dhe shërbimeve kozmetike, pasi do të ndikojë në kontrollin e cilësisë së produkteve. Ligji vendos rregulla për cilësinë e produktit dhe personat përgjegjës për vendosjen në treg të tij, duke përcaktuar ndërkohë rregulla të rregulla të të cilat lidhen me etiketimin e produkteve kozmetike, paraqitjen e jashtme dhe udhëzime të përdorimit, i cili do të ndihmojë konsumatorin e këtyre produkteve të jetë i sigurt në përdorimin e tyre. Ka vijuar puna për finalizimin

Treguesi: *Krijimi i një harte të plotë të rrjetit të farmacive, importuesve dhe distributorëve – nuk është realizuar ende*

e procesit të shqyrtimit dhe miratimit të fletëudhëzuesve të barnave në gjuhën shqipe. VKM nr. 299, datë 08.04.2015 "Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në RSH.

²⁰ Shih Inspektorati Qendror “Raporti i Përgjithshëm i Inspektimeve Për Vitin 2017”, Faqe 26 <http://www.insq.gov.al/wp-content/uploads/2018/05/RAPORTI-I-P%C3%8BRGJITHSH%C3%8BM-I-INSPEKTIMEVE-P%C3%8BR-VITIN-2017.pdf>

²¹ Ligji nr. 26/2017 “Për produktet kozmetike”

Gjithashtu nga Inspektoriati Shëndetësor janë realizuar 665 inspektime në klinikat mjekësore estetike, jopublike dhe qendrave kozmetike dhe estetike²²;

Nuk ka ende progres në ngritjen e një hartë të plotë të të rrjetit të farmacive, importuesve dhe distributorëve.

Akreditimi i laboratorit të barnave është në proces. Aktualisht po rikonstruksioni i shtesës së godinës të Agjencisë ku është përfshirë dhe ngritja e Laboratorit të Kontrollit të Barnave (në përputhje me standardet e kërkuara). Ngritja e laboratorit është një kërkesë që i paraprin procesit të akreditimit.

Treguesi: *Akreditimi i laboratorit të barnave – në proces*

Tashmë pranë Inspektoriatit Qendror është ngritur databaza e Sektorit të Inspektimit me të dhënat e detajuara të subjekteve farmaceutike, në respektim të udhëzimeve dhe rregullave të miratuara Inspektorati Qendror.

²² Raporti i Inspektoriatit Qendror


Prioriteti II. Përmirësimi i transparencës së tregut dhe praktikave tregtare për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve, duke përmirësuar dhe aksesin për dëmshpërblim dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Në kuadër të këtij prioriteti strategjia parashikon dy nënprioritete:


- *Përmirësimi dhe plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor që rregullon marrëdhëniet ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve për mbrojtjen e interesave ekonomike të tyre dhe fuqizimi i efektivitetit të strukturave shtetërore të kontrollit*
- *Plotësimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit*

Pjesa më e madhe e aktiviteteve po realizohet brenda afateve kohore të përcaktuar në planin e veprimit. Shkalla e realizimit mbetet në nivelin 50%. Ky nivel realizimi lidhet me faktin se gati gjysma e aktiviteteve të parashikuara në plan pritet të realizohen deri në vitin e fundit të zbatimit të strategjisë.

Grafiku 8: Afatet kohore të realizimit të aktiviteteve



Grafiku 9: Shkalla e realizimit të aktiviteteve



Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmblendhur progresi i arritur në kuadër të këtij qëllimi prioritar.

2.1 Përmirësimi dhe plotësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor që rregullon marrëdhëniet ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe konsumatorëve për mbrojtjen e interesave ekonomike të tyre dhe fuqizimi i efektivitetit të strukturave shtetërore të kontrollit.

Megjithëse kuadri ligjor i mbrojtjes së konsumatorit është i përafruar në një shkallë të lartë me atë evropian dhe ofron një bazë të qëndrueshme dhe të plotë për të mbrojtur konsumatorin shqiptar, ***procesi i përditësimit të tij është gjithmonë një domosdoshmëri që duhet të reflektojë zhvillimet në legjislacionin evropian, zhvillimet sociale dhe ekonomike përdorimin e praktikave tregtare të shitjes gjithnjë e më komplekse***, etj. Transpozimi i legjislacionit evropian është një mjet i fuqishëm për konsumatorët shqiptarë dhe i siguron atyre të njëjtin nivel mbrojtje me ata evropianë.

Treguesi: *Akte ligjore/nënligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve që nuk lidhen me çështjet e sigurisë – realizuar plotësisht*

Në kuadër të objektivit ***“Përditësim i legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve duke ndjekur zhvillimet në nivel evropian”***, janë të parashikuara deri në fund të vitit 2017, gjashtë (8) aktivitete, të cilat janë realizuar plotësisht, por me një ndryshim nga parashikimi.

Përafrimi i legjislacionit tonë me atë të BE-së, si një detyrim që buron direkt nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, përcakton nevojën e reflektimit të ndryshimeve legjislative evropiane. Për këtë arsye Ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” është subjekt i ndryshimeve, përmirësimeve dhe plotësimeve të vazhdueshme.

Këtu përfshihen amendimet e ligjeve të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurisë së përgjithshme, në lidhje me përcaktimin e dispozitave që përcaktojnë funksionimin e strukturës së mbikëqyrjes së tregut (2), përkatësisht: (i) Ligji nr. 15/2013, datë 14.2.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve ” ; (ii) Ligji nr. 16/2013, datë 14.2.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”. Ndryshimet ligjore të sipërpërmendura kanë pasur qëllim vendosjen e bazës legjislative për sistemin e mbikëqyrjes së tregut, si dhe ngritjen dhe funksionimin e inspektoratit të tregut.

Gjithashtu një hap përpara është bërë në drejtim të plotësisht të kuadrit ligjor lidhur zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit, duke transpozuar Direktivën 2013/11/BE “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve” që me një ndryshim të lehtë nga plani i aktiviteteve, u bë nëpërmjet ndryshimeve të ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe jo nga VKM e parashikuar, pasi përafrimi kërkonte ndryshime në nivel të aktit ligjor dhe jo nënligjor.

Treguesi: *Ulja çdo vit me 20% e praktikave të padrejta tregtare*

Aktet e reja nënligjore kanë synuar përmirësimin e legjislacionit dhe përafrimin me direktivat evropiane lidhur me përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat, të produktit të

pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit si dhe etiketimeve të produkteve elektrike²³, si dhe përcaktimin e metodave të vlerësimit të riskut të produkteve të konsumatorëve²⁴. Gjithashtu janë miratuar akte përcaktojnë procedurat e trajtimit të ankesave të adresuara pranë strukturës përgjegjëse shtetërore në MZHETS, duke plotësuar me tej kuadrin ligjor në mbrojtje të konsumatorëve si dhe duke lehtësuar aksesin për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Në kuadër të objektivit “*Organizimi i sondazheve tek operatorët, për vlerësimin e praktikave tregtare në fillim dhe pas masave nga KMK*”, është përzgjedhur treguesi “*Ulja çdo vit me 20% e praktikave të padrejta tregtare*”. Janë të parashikuara aktivitetet në lidhje me organizimin e sondazheve tek operatorët, për vlerësimin e praktikave tregtare në fillim dhe pas masave nga KMK.

Zbatimi i aktiviteteve u realizua nëpërmjet disa ndjekjes së disa masave:

- organizimi i sondazheve tek operatorët, respektivisht të bankave të nivelit të dytë dhe të operatorëve (agjencitë e udhëtimit) për konstatimin e shkeljeve të legjislacionit;
- hartimi i raporteve vlerësuese për gjendjen në këto fusha;
- nxjerrja e rekomandimeve përkatëse për operatorët dhe lënia e një afati kohor për zbatimin e tyre;
- ri monitorimi i operatorëve për zbatimin e rekomandimeve të lëna;
- përcaktimi i uljes së shkallës së mos-përputhshmërisë së praktikave me dispozitat përkatëse ligjore, nëpërmjet krahasimit të numrit të gjetur të shkeljeve të dispozitave ligjore përpara dhënies së rekomandimeve me numrin e gjetur të shkeljeve mbas zbatimit të rekomandimeve të dhëna, pra në fillim dhe pas masave nga KMK.

Në mënyrë me konkrete jepet përshkrimi i aktiviteteve për sa u takon fushave

- **Kredia konsumatore;**

Qëllimi i sondazhit synon përmirësimin e transparencës së tregut dhe praktikave tregtare për mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve në fushën e kredisë konsumatore, për rritjen e besimit të konsumatorëve në procesin e marrjes së kredisë konsumatore. Përpara se konsumatori të marrë një vendim lidhur me marrjen e një kredie konsumatore, atij i nevojitet kohe për të kuptuar dhe reflektuar mbi koston reale të kredisë, pagesat mujore për shlyerjen e kredisë, etj. Për këtë qëllim, legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorëve parashikon detyrime të veçanta për operatorët/bankat që ofrojnë këto lloj kredish. Këto detyrime konsistojnë kryesisht në dhënien një informacioni të plote që në fazën e publicitetit, në fazën parakontraktore, etj.

²³ VKM nr. 652, datë 8.10.2014 “Për përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit””, i përafuar me direktivën 2008/122/EC; VKM nr. 865, datë 21.10.2015 “Për etiketimin e energjisë për kondicionerët e ajrit”, i përafuar me direktivën 626/2011/EC; VKM nr. 942, datë 28.12.2016 “Për etiketimin e llambave dhe ndriçueseve elektrike””, i përafuar me direktivën 874/2012/EC.

²⁴ Udhëzimi Ministrit të Ekonomisë (2): “Për metodat/mënyrat e klasifikimit të risqeve dhe vlerësimit të riskut serioz, që transponon Udhëzimin për vlerësimin e riskut të produkteve të konsumatorëve, Shtojcën 5 të Vendimit të KE nr. 16 Nëntor 2009 “Mbi paraqitjen e udhëzueseve për menaxhimin e ‘RAPEX’, sipas nenit 12 të Direktivës 2001/95/EC “Mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve” dhe Udhëzimi nr. 11, datë 2/09/2013 “Për përcaktimin e procedurave të trajtimit të ankesave të konsumatorëve”.

Në lidhje me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këtë legjislacion nga bankat e nivelit të dytë, është realizuar një vlerësim i situatës në këto banka. Ky vlerësim konstatoi mangësi në dhënien e informacionit ndaj konsumatorëve, në fazën e publicitetit dhe në fazën parakontraktore, mosdhënien e një informacioni parakontraktor me shkrim, etj.

Në muajin dhjetor 2013, në bashkëpunim dhe me Bankën e Shqipërisë, u organizua një takim me bankat e nivelit të dytë, ku u paraqiten gjetjet e këtij vlerësimi dhe secilës bankë iu dhanë rekomandime përkatëse, duke u lënë një afat 3 muajor për marrjen e masave për përmirësimin situatës. Mbas përfundimit të këtij afati sektori i mbrojtjes së konsumatorëve me një shkresë zyrtare ju drejtua të gjitha bankave të nivelit të dytë, duke ju kërkuar informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të sipërpërmendura. Mbas marrjes së informacionit të kërkuar nga bankat, u krye vlerësimi i informacionit të marrë si dhe i informacionit që përmbajnë faqet e web-it të bankave.

Vlerësimi iu paraqit për shqyrtim Komisionit të Mbrojtëse së Konsumatorëve, i cili mori vendimin nr. 31, datë 29.07.2014, nëpërmjet të cilit bankat u urdhëruan të marrin të gjitha masat për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në ligjin e mbrojtjes së konsumatorëve për kreditë konsumatore. Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorëve, pas dërgimit të vendimit i monitoroi përsëri bankat e nivelit të dytë, duke ju kërkuar informacion zyrtarisht në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe monitoroi informacionin që përmbanin në faqet e internetit të tyre në lidhje me kredinë konsumatorë.

- Kontratat e paketave të udhëtimit

Në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit, është kryer një vlerësim i praktikave tregtare në fushën e paketave të udhëtimit, nëpërmjet: organizimit të sondazheve për 45 operatorë (agjencitë e udhëtimit) në Tiranë, si dhe hartimit të një raporti vlerësues për gjendjen në fushën e paketave të udhëtimit, në përputhje me gjetjet e sondazheve.

Drejtorja e Tregut të Brendshëm/Sektori i Mbrojtjes së konsumatorëve, në muajin mars të vitit 2015 zhvilloi një tryezë të rrumbullakët me operatorët turistikë, përfaqësuesit e shoqatave të turizmit, shoqatat e konsumatorëve dhe institucionet shtetërore, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve në fushën e paketave të udhëtimit. Aktiviteti u realizua me mbështetjen e projektit të GIZ “Mbështetje për Harmonizimin e Legjislacionit Ekonomik dhe Tregtar me Legjislacionin e BE-së”. Në aktivitet u paraqiten gjetjet e raportit të vlerësimit pasi u diskutua mbi situatën aktualen si dhe u dhanë rekomandime konkrete mbi masat që agjencitë e udhëtimit duhet të ndërmarrin për zbatimin e këtij legjislacioni. Pjesë e raportit ishte dhe propozimi i një draft kontrate standarde. Rekomandime iu përcollën zyrtarisht të gjithë operatoreve, të cilët ishin pjesë e procesit të vlerësimit, duke iu lënë edhe një afat 3 muajor për përmirësimin e gjendjes.

Në fund të kësaj periudhe 3 mujore, SMK monitoroi më tej faqet e internetit të 45 operatorëve të paketave të udhëtimit, nëse ishin korrigjuar. Ky monitorim u përqendrua kryesisht në informacionin para kontraktual dhe informacionin për kontratën standarde të dhënë për konsumatorët. Në përfundim të afatit 3 muajor (Shtator 2015), Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorëve, monitoroi faqet web të 44 operatoreve turistike për sa i përket informacionin parakontraktor që ata ofronin dhe për publikimin online të kontratës standarde për paketat e turistike. Gjatë kësaj procedure u morën masat

që, përveç kontrollit visual të faqeve online, të bëheshin edhe telefonata direkte me përfaqësuesit e këtyre operatoreve dhe të dërgoheshin në formë elektronike shpjeguesi për paketat e udhëtimit dhe baza ligjore.

Spektori i Mbrojtjes së Konsumatorëve, gjatë këtij monitorimi, konstatoi se nga 44 operatorë turistikë, vetëm 5 prej tyre jepnin informacionin parakontraktor për konsumatorët dhe publikonin kushtet e përgjithshme të kontratës në faqet e tyre web, në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

Në periudhën prill - maj 2016, Spektori i Mbrojtjes së Konsumatorëve, bëri një tjetër monitorim të situatës, ku rezultoi se 10 prej tyre jepnin informacionin parakontraktor për konsumatorët dhe publikonin kushtet e përgjithshme të kontratës në faqet e tyre web, në përputhje ose pjesërisht në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.

Komisioni në lidhje me mangësitë e konstatuara ka rekomanduar ndjekjen e mëtejshme të detyrimeve përkatëse të operatorëve të paketave të udhëtimit në bashkëpunim me inspektoratin për mbikëqyrjen e tregut, i ngarkuar dhe me çështjet e turizmit.

- Kontratat e shitjeve në largësi, përfshirë tregtinë online

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017, u krye monitorimi i faqeve të internetit (proces i quajtur 'sweeps'), të cilat shesin produkte apo ofrojnë shërbime për konsumatorë – nëpërmjet kontratave jashtë qendrave të tregtimit dhe në largësi, përfshirë dhe blerjet online. Ky proces mund të përshkruhet si shqyrtim i faqeve të internetit me qëllim për të identifikuar zbatimin e ligjit të konsumatorit nga ana e bizneseve. Ky proces shoqërohet me analizimin e rezultateve dhe mangësive të identifikuara, në bazë të të cilave përgatiten rekomandimet për bizneset, në mënyrë që të sigurohet respektimi i të drejtave të konsumatorëve.

Proçes, në kontekstin e mbrojtjes së konsumatorit, është kryer për here të pare në këtë fushe dhe pati mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Për forcimin e kapaciteteve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Sekretariatit Teknik të tij”.

Faqet e internetit u përzgjedhën në bazë të disa kriterëve si: popullariteti/njohja nga konsumatorët, fuqia e operatorit në treg, etj. U përzgjedhën 40 faqet e internetit të dedikuara për shitjen në largësi.

Monitorimi u shtri tek faqet e internetit të operatorëve shqiptarë, por pjesë u bënë edhe ato faqe interneti të cilat janë themeluar në vendet e tjera (2 nga BE dhe 3 jashtë BE), që ofrojnë mallra për tregun shqiptar, duke siguruar kështu një pasqyrë më të gjerë të situatës në këtë sektor.

Monitorimi u fokusua në informacionin parakontraktor, që këto faqe ofronin për konsumatorët, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe mënyrës se si ky informacion u ofrohet konsumatorëve.

Duke marrë parasysh mangësitë e identifikuara, nga sondazhet e kryera, u konstatua operatorët e kësaj fushe nuk janë në dijeni të kërkesave ligjore që ata duhet të përmbushin për kontratat në largësi. Për këtë arsye del e nevojshme që rritet ndërgjegjësimi brenda komunitetit të këtij biznesi. Për ti ndihmuar ata në përmbushjen e kërkesave ligjore, në këtë faze duhet tu jepen rekomandimet, në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria më e mirë me legjislacionin.

U ndërmorën hapa ligjore për të siguruar mirëfunksionimin e Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve²⁵ bazuar dhe në përfaqësimin nga të gjithë palët si institucionale, edhe nga shoqatat e konsumatorëve dhe atyre të biznesit, për çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjes së tregut.

Deri në fund të vitit 2018 do të vijojë puna për hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 11.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe projektvendimit të Këshillit të Ministrave në lidhje me paketat e udhëtimit, duke transpozuar direktivën përkatëse.

Risqet kryesore dhe masat zbutëse

1. *Ndryshimi i planit të aktiviteteve në lidhje me ndryshimin e parashikimit për hartimin e akteve ligjore të parashikuara, për arsye objektive pasi vetë direktiva ka lënë afatin e transpozimit për Shtetet Anëtare, vitin 2018, si dhe në drejtim të përcaktimit të kompetencës, për shkak të ndryshimeve strukturore në nivel qendror, se cila ministri do ta nxjerrë këtë akt. Do të merren masat e duhura, në mbledhjet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 28, për të siguruar marrjen përsipër të transpozimit direktivës së re të paketave të udhëtimit.*
2. *Plani i aktiviteteve prioritare të lidhura me legjislacionin mund të mos realizohet plotësisht, për arsyet se risku mund të lidhet në nivele të ndryshimeve strukturore qeveritare që mund të sjellë impakt në realizimin e këtyre aktiviteteve dhe rezultateve të dëshirueshme.*
3. *Numrit të pamjaftueshëm të stafit të lidhur me zbatimin e tyre, që rezulton i tillë, për shkak të përgjegjësiave institucionale të përcaktuara në legjislacion, në rregulloren e punës së Ministrisë dhe në përshkrimet e punës së strukturës. Do të kërkohet rritja e numrit të stafit si dhe do të kërkohet mbështetja e aktivitetit nga projekte si: Projekti GIZ, TAIEX, IPA, etj.*

Në kuadër të objektivit “**Fuqizim i efektivitetit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK)²⁶, nëpërmjet analizimit 100% të ankesave dhe shqyrtimit me iniciativën e tij të kontratave standarde**”, janë të parashikuara aktivitetet për trajtimi dhe shqyrtimi 100% i ankesave të konsumatorëve, si dhe shqyrtimi i kontratave standarde të operatorëve në fushën e energjisë, ujit, komunikimeve elektronike etj.

Problematikat e ankesave të konsumatorëve, të paraqitura pranë komisionit kanë pasur të bënin kryesisht me: mosrespektim të shërbimeve të ofruara me kushtet e kontratave të ofrimit të shërbimit

²⁵ Urdhër i Kryeministrit nr. 124, datë 20.3.2014 “Për Miratimin e Përbërjes së Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve”. Ky akt siguron funksionimin e strukturës bashkërenduese, me përfaqësim nga të gjithë palët si institucionale, edhe nga shoqatat e konsumatorëve dhe atyre të biznesit, për çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve dhe mbikëqyrjes së tregut; Urdhër i Kryeministrit nr. 169, datë 27.5.2014 “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve”. Ky akt ka siguruar funksionimin e strukturës kryesore zbatuese (KMK) të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve.

²⁶ Komisionit i Mbrojtjes së Konsumatorëve trajton ankesat e konsumatorëve, të cilat përkufizohen si: deklaratë pakënaqësie e konsumatorit ndaj një tregtari të veçantë, në lidhje me shitjen, furnizimin apo promovimin e një malli apo shërbimi, përdorimin e një malli apo shërbimi apo kryerjen e shërbimeve pas shitjes. Ankesat i paraqitet Komisionit apo sekretariatit teknik të tij, në rrugë elektronike apo me shkrim. Ankesa plotësohet në përputhje me formularin standard të ankesës, i cili është i publikuar në faqen zyrtare.

të telefonisë celulare, të shërbimit turistik dhe në ofrimin e kredisë konsumatore; praktikë tregtare të padrejtë në shërbimin e shkëmbimit valutor, përmbajtje të informacioneve të pavërteta në publicitete të ndryshme, publicitet krahasues të palejuar në ofrimin e disa materialeve të ndërtimit dhe shërbimin e instalimit të pajisjes së filtrimit të ujit të pijshëm, etj.

Treguesi i zgjedhur ka për qëllim të matë shkallën e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për të drejtuar ankesat e tyre pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve. Komisioni gjatë viteve 2013-2017 ka trajtuar rreth 130 ankesa. Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve do të sjellë edhe rritjen e numrit të ankesave.

Megjithëse Komisioni u jep zgjidhje ankesave individuale të konsumatorëve, roli i tij kryesor vendimarrës i takon çështjeve të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm të konsumatorëve. Për këtë qëllim komisioni ka shqyrtuar kontratat standard të konsumatorëve, me synim gjetjen dhe më pas

Treguesi: *Numri i ankesave të konsumatorëve të shqyrtuara nga KMK- Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve. Komisioni gjatë viteve 2014-2017 ka trajtuar rreth 130 ankesa.*

shfuqizimin e kushteve të padrejta në to. Kjo është një punë që komisioni në vijueshmëri ka kryer edhe në vitet 2014-2016, për kontrata të tjera standarde në lidhje me:

- furnizimin me energji elektrike për klientin e kategorisë familjarë (viti 2014 - Vendimi nr. 33, datë 17.10.2014);
- për shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve (viti 2015 - Vendimi nr. 35, datë 18.02.2015).
- për shërbimin e internetit ofruar nga operatorët (viti 2016- Vendimet 40-43, datë 7.10.2016)

Gjetjet kryesore të kushteve të padrejta në këto kontrata kane qenë kryesisht:

1. *Rasti kur operatori kërkon të mbajë të drejtën për të ndryshuar kushtet e kontratës, është në kundërshtim me LMK pasi duhet të përcaktojë në mënyrë transparente rastet e ndryshimit të kushteve, arsyet që çojnë në ndryshimin e këtyre kushteve, në mënyrë që konsumatori të jetë në gjendje të parashikojë këto ndryshime dhe të mund të njohë që në kohën e lidhjes së kontratës pasojat dhe ndikimin që do të sjellë kjo kontratë në situatën e tij ekonomike dhe financiare.*
2. *Mos parashikimi i detyrimit të operatorit për njoftimin me shkrim të konsumatorit për përfundimin e afatit të kontratës, përkundëjt detyrimit të konsumatorëve, për njoftimin me shkrim të operatorit, për mos vazhdimin e kontratës.*
3. *Parashikimi në kontratë i një afati të gjatë (12 mujor) për kthim të kontratës me afat të pacaktuar, pa njoftim paraprak nga operatori.*
4. *Aplikimi i rritjes së tarifës së një apo më shumë shërbimeve të zgjedhura nga pajtimtari në kontratë, duke mos parashikuar procesit të njoftimit individual me shkrim të pajtimtarit nga operatori.*
5. *Mos respektim i kërkesave të transparencës të parashikuara në nenin 28 të LMK, në lidhje me formulimin e qartë të kushteve të kontratës, si dhe madhësinë e karakterit të shkrimit.*


Mangësitë e sipërpërmendura në kontratat standarde, si kushte të padrejta, përbëjnë kufizim të të drejtave të konsumatorëve, në drejtim të marrjes së një informacioni të plotë, si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve të vetë operatorit.

Gjatë vitit 2017, u shqyrtuan kontratat standarde në fushën e arsimit të lartë privat me synim shfuqizimin e kushteve të padrejta në këto kontratat tip. Nga shqyrtimi që iu bë kontratave standarde të 18 subjekteve Institucione të Arsimit të Lartë (IAL), u vu re se përgjithësisht ato pajtohen me parimet e përgjithshme të paanësisë, drejtësisë e barazisë të kërkuara si nga Kodi Civil, ashtu dhe ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve". Duke qenë se subjektet licencohen nga Ministria përgjegjëse për arsimin ato janë objekt i kontrollit dhe nga agjencitë dhe strukturat e kësaj Ministrie, kontrata standard ndjek disa orientimet e dhëna nga këto struktura. Kjo është arsyeja që kushtet e padrejta të gjetura në këtë analizë, kanë qenë më pak në numër krahasuar me fusha të tjera ku është kryer monitorim nga Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

Gjetjet kryesore të kushteve të padrejta në këto kontrata lidhen kryesisht me parashikimin e penalteteve të larta dhe jo proporcionale, mos parashikimi i të drejtës për siguruar, të ankimit, etj., kushte të cilat në tërësinë e tyre devijojnë nga parimet e barazisë dhe paanësisë që duhet të karakterizojë një kontratë standarde, duke shkaktuar pabarazi të ndjeshme dhe të dallueshme në të drejtat e detyrimit e palëve.

Masat konkrete për secilin subjekt u dhanë nga KMK, nëpërmjet vendimeve nr. 49- 66 të datës 17.11.2017.

Më poshtë jepen në mënyrë skematike çështjet e trajtuara nga komisioni dhe kushtet e padrejta në kontrata në mbrojtje të interesit publik.



Risqet kryesore dhe masat zbutëse

1. *Ulja e numrit të aktiviteteve ndërgjegjësuere ndaj konsumatorëve*, përfshirë edhe vënien në dispozicion të tyre të materialeve informuese (broshura, fletëpalosje, etj.), bashkëpunim më i pakët me shoqatat e konsumatorëve, faqe zyrtare interneti të institucioneve me mungesë informacioni ndaj konsumatorëve, duke sjellë si pasojë mundësinë e uljes së numrit të

konsumatorëve që ankohen pranë KMK dhe strukturave të tjera të ngarkuara me mbrojtjen e konsumatorëve.

Përmirësim i bashkëpunimit me shoqatat e konsumatorëve dhe aktorë të tjerë, përfshirja e tyre në aktivitetet e sektorit, etj.

2. *Numrit të pamjaftueshëm të stafit rezikon uljen e shkallës së realizimit të aktiviteteve për shkak të përgjegjësive institucionale të përcaktuara në legjislacion, në rregulloren e punës së ministrisë dhe në përshkrimet e punës së strukturës.*

Do të kërkohet rritja e numrit të stafit si dhe do të kërkohet mbështetja e aktivitetit nga projekte si: Projekti GIZ, TAIEX, IPA, etj.

Masat e marra në drejtim të kredisë konsumatore kanë synuar mbrojtjen e konsumatorit, rritjen e konkurrencës në sektorin bankar dhe rritjen e transparencës së produkteve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 48, datë 01.07.2015 miratoi rregulloren "Për kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare". Kjo rregullore shfuqizon rregulloren "Për kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare për individual" (miratuar me vendimin nr. 5, datë 11.02.2009). Rregullorja e re ka për qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare, duke përmirësuar kuadrin rregullator në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, rritjen e konkurrencës në sektorin bankar dhe rritjen e transparencës së produkteve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare. Kjo rregullore e re harmonizon më tej kuadrin rregullator shqiptar në kuadër të BE-së për mbrojtjen e konsumatorit në sektorin bankar, veçanërisht për dispozitat e Direktivës 2008/48/EC "Për marrëveshjet e kredisë konsumatore" dhe Direktivës 2014/17/ EU "Për marrëveshjet e kredisë për konsumatorët kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme rezidenciale".

Treguesi: Numri i sondazheve me konsumatorët lidhur me perceptimin e tyre për produktet dhe shërbimet e ofruara në treg, si dhe perceptimin për nivelin e mbështetjes dhe shërbimit nga strukturat shtetërore – 4 sondazhe të realizuara nga 12 të parashikuara në total

Në kuadër të objektivit "Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve me 5% çdo vit", janë të parashikuara disa aktivitete, ndër to është edhe aktiviteti "Organizimi i të paktën 3 sondazheve me konsumatorë lidhur me perceptimin e tyre për produktet dhe shërbimet e ofruara në treg, legjislacionin, perceptimin për nivelin e mbështetjes dhe shërbimit nga strukturat e administratës shtetërore, etj.

Sondazhet kanë pasur si qëllim vlerësimin e sjelljes, eksperiencat, perceptimin e konsumatorëve përkundrejt tregut, duke shërbyer si barometër i tregut, si dhe për të vlerësuar sa konsumatorët njohin të drejtat e tyre dhe nëse i zbatojnë ato, sa i njohin institucionet që punojnë për mbrojtjen e konsumatorëve dhe si e perceptojnë shërbimin e strukturave të administratës shtetërore. Sondazhet


kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave të konsumatorëve, në përfshirjen e çështjeve që shqetësojnë konsumatorët, si dhe në hartimin e një legjislacioni efektiv.

Janë zhvilluar tre anketime në kuadër të fushatave ndergjegjesuese “Përdorni te drejtat tuaja” që Ministria e Ekonomisë ka zhvilluar në vijueshmëri çdo fund viti dhe në kuadër të 15 – Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Konsumatorëve:

1. Në shtator 2014, është kryer **një anketim me konsumatorë mbi njohjen e të drejtave të tyre, në bashkëpunim me shoqatat e konsumatorëve dhe me bashkitë e disa qyteteve të vendit.**



2. Në periudhën nëntor–dhjetor 2015, është kryer **një anketim me 800 nxënës të klasave të larta, të nëntë shkollave të mesme në Tiranë**, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbrojtjen e Konsumatorit, në Bashkinë e Tiranës. *Qëllimi i këtij studimi ishte për të vlerësuar njohuritë që nxënësit kishin fituar për të drejtat e konsumatorit dhe zbatimin e tyre.* Në fund të këtij procesi u përgatit një raport përmbledhës si dhe u hartuan disa rekomandime me qëllim të përmirësimit të njohurive për të drejtat e konsumatorëve. Rezultatet e studimit të kryer në shkollat e mesme u paraqiten në një aktivitet me pjesëmarrje nga të gjitha palët e interesuara: shoqatat e konsumatorëve, ministritë, Bashkia e Tiranës, studentë, etj.



3. Në periudhën shkurt - mars 2016, është kryer **nga projekti GIZ, një anketim me konsumatorë, në lidhje me njohjen e të drejtave të tyre**, rezultatet e të cilit u prezantuan në një takim të organizuar në kuadër të 15 marsit, me të gjithë palët e përfshira në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve: institucione shtetërore, shoqata të konsumatorëve dhe atyre të biznesit.
4. Në periudhën prill – korrik 2017 është kryer **studimi i tregut lidhur me monitorimin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit**, duke përfshirë anketimin me konsumatorët dhe me bizneset mbi performancën e tregut²⁷. Anketimet u kryen të kombinuara nëpërmjet

²⁷ Pyetësori për **anketimin e konsumatorëve** përbëhej nga 4 pjesë: eksperiencia e vetë konsumatorëve në lidhje me shkeljen të drejtave të tyre, përfshirë këtu vlerësimin e 17 lloj shërbimeve të zgjedhura në tregun shqiptar; ndërgjegjësimi për të drejtat e konsumatorit; aktiviteti i konsumatorëve dhe vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së konsumatorit nga konsumatorët. Pyetësori për **anketimin e bizneseve** përfshin vlerësimin nga biznesi të akteve ligjore, që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve; mendimi në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe konkurrencën e ndershme në treg, bashkëpunimin ndërmjet biznesit dhe institucionit

intervistimit të drejtpërdrejtë të personave dhe plotësimi të pyetësorëve online nga konsumatorë apo biznese. Studimi mbi performancën e tregut së bashku me të dhënat e pyetësorëve u paraqitën në Konferencën me temë “Për rritjen e sensibilizimit mbi të drejtat e konsumatorit: fuqizimi i konsumatorëve për marrjen e vendimeve të mirë informuara” (shtator 2017). Konferenca iu dedikua prezantimit të rezultateve të studimeve të konsumatorëve dhe bizneseve në lidhje me njohuritë dhe perceptimin e tyre për mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri, si dhe u diskutua rëndësia e edukimit të përshtatshëm të konsumatorëve dhe biznesit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, praktikat më të mira të BE-së dhe përvojën shqiptare në rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e konsumatorit.

Risqet kryesore dhe masat zbutëse

Ekziston risku i uljes së numrit të anketimeve të kryera me konsumatorë dhe biznese, për shkak të mungesës së aktivitetit të shoqatave ekzistuese të mbrojtjes së konsumatorëve, mungesa e informacionit në faqe zyrtare të interneti të institucioneve/konsumatorëve/bizneseve, apo mos funksionimi i tyre për shkak të problemeve teknike, do të sillte uljen e numrit të konsumatorëve apo bizneseve të aksesueshem për realizimin e anketimeve.

Përmirësim i bashkëpunimit me shoqatat e konsumatorëve dhe biznese, vendosja e lidhjeve me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Institutin e Statistikave.

shtetëror; përvojën në trajtimin e mosmarrëveshjeve me konsumatorët; identifikimin e barrierave për të vepruar në përputhje me aktet ligjore, që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve etj.

Prioriteti III: Përmirësimi i edukimit të konsumatorëve për pjesëmarrje aktive në treg dhe përmirësimi i informimit dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë për të drejtat e konsumatorëve.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve është një proces dhe kërkon një qasje të qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse. Përveç ditëve të informimit, stendave informuese, botimeve apo fletëpalosjeve do t'i vihet përparësi edukimit të konsumatorëve që mund të fillojë që në moshat e vogla, edhe me elementë dhe gjuhë të thjeshtë. Gjithashtu, kjo do të ndiqet edhe me vazhdimin e fuqizimit të institucioneve zbatuese, të cilat janë përcjellësi më i mirë i mesazheve pozitive të konsumatorët për zbatueshmërinë e ligjit.

Në kuadër të objektivit *“Rritja e shkallës së ndërgjegjësimin të konsumatorëve dhe operatorëve në lidhje me: kuadrin e ri rregullator të sigurisë së produkteve dhe të mbrojtjes së konsumatorëve, përfshirë fushën e të drejtave të udhëtarëve dhe fushën e produkteve kozmetike”*, janë të parashikuara zhvillimi i aktiviteteve si: organizimi i tryezave informuese; përgatitja e materialeve informuese (broshura & fletëpalosje); si dhe materialeve informuese në ëbsitin e institucioneve.

Organizimi i tryezave informuese për konsumatorët dhe për operatorët, do të kontribuojë në rritjen

Treguesi: *Numri i tryezave, aktiviteteve ndërgjegjësuere – **janë realizuar 18 aktivitete kundrejt 10 të parashikuara.***

e ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e njohurive të konsumatorëve, si dhe detyrimeve të operatorëve. Tryezat shërbejnë edhe për përmbushjen e objektivave të lidhura me hartimin e kuadrit të ri ligjor, rezultateve të sondazheve, fuqizimit të strukturave shtetërore, etj. Këto aktivitete janë shoqëruar me përgatitjen e materialeve informuese, broshura, fletëpalosje, etj. Përmirësimi i informacionit shoqërohet me rritjen e ndërgjegjësimin të të dy palëve, si konsumatorëve ashtu dhe tregtarëve ndaj të drejtave dhe detyrimeve, si dhe me rritjen e besimit reciprok. Janë realizuar në vijueshmëri në vite iniciativa në lidhje me informimin dhe edukimin e konsumatorëve dhe biznesit:

Viti 2014

- Mbajtja e prezantimeve me studentë në ambientet e disa fakulteteve te Universitetit publik dhe atyre jo publik ne Tirane , në lidhje me të drejtat e konsumatorëve sipas legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve.
- Përgatitja dhe vendosja në faqen web të Ministrisë e një publikimi për të drejtat e konsumatorëve.
- Përgatitja e 5000 copë fletëpalosje, drejtuar konsumatorëve dhe biznesit, të cilat u shpërndanë nëpërmjet Postes Shqiptare në disa zona kyçe të Tiranës dhe në qytet më kryesore të Shqipërisë
- Organizim i takimit me pjesëmarrës përfaqësues të shoqatave të konsumatorëve, organizata biznesi dhe stafe akademike , me qëllim prezantimin e rezultateve dhe diskutime për aktivitetet e ardhshme.

Viti 2015

- Përgatitja e 7000 cope fletëve ndërgjegjësimi për konsumatorët, në bazë të modelit të publikuar në faqen e Komisionit Evropian . Përmbytja konsiston në dhënien e informacionit në lidhje me të drejtat e tyre, të tilla si: e drejta për t'u tërhequr brenda 14 ditëve, nga kredia konsumatore, kontratat në largësi apo nga shitja jashtë qendrave të tregtimit. Fletëpalosjet janë shpërndarë në aktivitetet të konsumatorëve, si dhe në qendrat e biznesit, dhe vende të tjera të arritshme nga ana e tyre nëpërmjet Postës Shqiptare, si dhe mbajtja e një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrje nga të gjitha palët e interesuara: shoqatat e konsumatorëve, ministrinë, Bashkia e Tiranës, studentë, etj.
- Në mars të vitit 2015, u mbajt një tryezë të rrumbullakët me përfaqësuesit e ministrisë për çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve dhe turizmit, përfaqësues të shoqatave të mbrojtjes së konsumatorit dhe shoqatat e turizmit, si dhe përfaqësuesit e agjencive turistike me synim diskutimin e situatës të fushës së paketave të udhëtimit në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes e konsumatorëve, si dhe përmirësimit të saj.
- Në muajin dhjetor 2015, u zhvilluan tre tryeza te rrumbullakëta me entet rregullatorë, biznesin, në lidhje me transpozimin e Direktivës 2013/11/EU “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”. Qëllimi i tyre ishte marrja e mendimeve dhe informacioneve nga palët e interesuara, për trajtimin e ankesave te konsumatorëve, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve më të mira për të zhvillimin e mëtejshëm të këtyre strukturave, në kuadër të hartimit te projekt VKM së zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.

Viti 2016

- Ngritja e tendave promocionale në 4 pika kyçe të kryeqytetit që u vizituan nga rreth 1200 qytetarë. U shpërndanë më shumë se 2500 materialesh informuese: fletëpalosje dhe broshura, me informacion në lidhje me kontratat e shitjes së mallrave, paketat turistike dhe praktikatat e padrejta tregtare, si dhe materiale publicitare, si çanta, bluza, etj.
- Mbajtja e një tryeze të përbashkët me pjesëmarrje nga të gjithë aktorët për mbrojtjen e konsumatorëve: ministri të linjës; shoqatat e konsumatorëve dhe organizata të biznesit. Takimi kishte për qëllim diskutimin e masave që duhet të ndërmerren për të përmirësuar zbatimin e të drejtave të konsumatorëve dhe për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe operatorëve.
- Në fushën e sigurisë së përgjithshme të produkteve, për ndërgjegjësimin e konsumatorëve janë përgatitur fletëpalosje informative për biçikletat e fëmijëve, drejtuar si konsumatorëve ashtu dhe operatorët
- Në kuadër të ndërmarrjes se iniciativës së Ministrisë së Ekonomisë “Përfshirja e pushtetit vendor në përmirësimin e zbatimit të legjislacionit dhe rritjen e nivelit të mbrojtjes së konsumatorëve” u organizuan gjatë muajve maj–korrik 2016, në qytetet e Shkodrës, Korçës, Sarandës dhe Elbasanit, 4 takime rajonale me përfaqësuesit e 61 bashkive si dhe u përgatiten rreth 7000 (shtatë mijë) fletëpalosje të dërguara në të gjitha bashkitë.

Viti 2017

- Në muajin mars struktura e mbrojtjes konsumatorëve, zhvilloi një fushate ndërgjegjësuese, në lidhje me përfshirjen e pushtetit vendor në çështjet të mbrojtjes së konsumatorëve, për zbatimin e ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve edhe nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Slogani i këtij viti ish: “Konsumator: informohu, këshillohu, ankohu”. U zhvilluan aktivitetet në Elbasan dhe ne Lushnje, si dhe u shpërndanë materiale promovuese për mbrojtjen e konsumatorëve si: çanta letre, bluza, byzylyk plastik me sloganin e fushatës.
- Në kuadër të aktiviteteve të mbështetura nga Projekti i Binjakëzimit “Për forcimin e kapaciteteve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Sekretariatit Teknik të tij”, janë zhvilluar:
 - i. Seminari “Trajtimi i ankesave të konsumatorëve, zgjidhjet alternative dhe online të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, edukimi i konsumatorit dhe biznesit, komunikimi mbi çështjet e konsumatorit” (qershor 2017). Gjatë seminarit u prezantuan tema të tilla si: procedurat e trajtimit të ankesave të konsumatorëve, legjislacioni i BE për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, praktikatat më të mira të ADR dhe përfitimet e saj për konsumatorët.
 - ii. Aktiviteti trajnues në lidhje me politiken e përgjithshme dhe legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit në BE, zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit (qershor 2017). Gjithashtu, u prezantuan praktikatat më të mira të zbatimit të legjislacionit të BE për mbrojtjen e konsumatorit, roli dhe funksionet e mbrojtjes së konsumatorit në sistemin institucional, si dhe bashkëpunimin ndërkuftar.
 - iii. Seminari në lidhje me direktivën evropiane për të drejtat e konsumatorëve, mbrojtja e konsumatorëve në kontratat në largësi dhe jashtë qendrave të tregtimit, si dhe në tregtinë elektronike (korrik 2017). Qëllimi i trajnimit ishte prezantimi impaktit që kjo direktive ka tek mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve në kontratat e mësipërme, mjedisi ekonomik dhe ligjor, fushëveprimi, dispozitat kryesore dhe zbatimi praktik i dispozitave të direktivës.

Të gjitha aktivitetet e sipërpërmendura u shoqëruan dhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve të përgatitura me mbështetjen e projektit, në lidhje me të drejtat e konsumatorëve, detyrimet e biznesit

që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve për rastet e kontratave të sipërpërmendura. Organizimi i tryezave informuese, së bashku me përgatitjen e materialeve informuese (broshura apo fletëpalosje).

Fig. Fletëpalosjet e prodhuara për të drejtat e konsumatorit



Në 20 Maj 2018 u festuar në mbarë botën Dita Ndërkombetare Metrologjise dhe në këtë kuadër u realizua vizitë në laboratorët e DPM nga studentët e Universitetit të Vlorës. Janë shpërndarë materiale dhe është promovuar roli i metrologjisë gjerësisht në mediat sociale, (facebook; twitter etj) për përdorimin dhe kërkesat që duhet të plotësojë një instrument matës.

DPM ka organizuar aktivitete promovuese nëpërmjet trajnimeve apo fushatave sensibilizuese konkretisht:

- Për herë të parë u ka dërguar të gjithë subjekteve që disponojnë apo përdorin instrumente matës ligjërisht të kontrolluar, pyetsorë mbi nevojat që ata kanë. Këto nevoja do të plotësohen nga DPM me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga matjet e pasakta dhe përdorimin e instrumentave matës për sigurimin e gjurmueshmërisë.

- Në 3 nëntor të vitit 2016 në ambjentet e DPM-së, është kryer seminar ndërgjegjësues “Mbi vendosjen e shenjës shqiptare të konformitetit “c”. ” me përfaqësues të bizneseve të mëdha, përkatësisht Olim, Deka, Birra Stela, Miell Tirana etj, të cilët paketojnë produkte të parapaketuara.

- Është punuar intensivisht nga Sektori i Parapaketimeve për të arritur një bashkëpunim ndërinstytucional për miratimin e etiketave konform pjesës VIII të Rregullores për Parapaketimet, VKM me nr. 1352. Keshtu, në 26 Nëntor 2015 DPM zhvilloi trajnim “Mbi rregullat për vendosjen e mbishkrimeve në parapaketime” nga Sektori i Parapaketimeve për punonjësit e AKU-së. Theksojmë, shumë të rëndësishëm këtë trajnim, pasi nga viti 2015 e në vijim të gjitha etiketat që miratohen nga AKU, përmbushin edhe kërkesat e përcaktuara në pjesën VIII të rregullores për parapaketimet.

Risqet kryesore dhe masat zbutëse

- I. Ekziston risku për uljen e numrit të aktiviteteve ndërgjegjësuere ndaj konsumatorëve, përfshirë edhe vënien në dispozicion të tyre të materialeve informuese (broshura, fletëpalosje, etj.), për arsye të uljes së aktivitetit të shoqatave ekzistuese të mbrojtjes së konsumatorëve, apo bashkëpunimit midis aktoreve kryesore shtet – konsumatorë – biznes. etj.

Përmirësim i bashkëpunimit me shoqatat e konsumatorëve dhe aktorë të tjerë, përfshirja e tyre në aktivitetet e sektorit, funksionimi i Këshillit Bashkërendues për Çështjet e Mbrojtjes së Konsumatorëve, etj.

- II. Numri i stafit të Sektorit të Tregut të Brendshëm/ Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në MFE, krahasuar me përgjegjësitë institucionale të përcaktuara në legjislacion, rregulloren e punës së Ministrisë dhe në përshkrimet e punës së sektorit, rezulton e pamjaftueshme.

Do të kërkohet rritja e numrit të stafit si dhe do të kërkohet mbështetja e aktivitetit nga projekte si Projekti GIZ, TAIEX, IPA, etj.

Risqet kryesore dhe masat zbutëse

1. Ekziston risku që faqet zyrtare interneti të institucioneve të kenë mungesë informacioni ndaj konsumatorëve. Përmirësimi dhe përditësimi i informacionit në faqet e institucioneve të jete pjesë e përshkrimeve të punës. Nxjerrja e të dhënave për numrin e vizitorëve, të jetë pjesë e përshkrimit të punës të personave që merren me menaxhimin e sistemit të informacionit teknologjik.
2. Vështirësi në nxjerrjen dhe sigurimin e të dhënave të kërkuara. Sigurimi i dhënave të nëpërmjet specialisteve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), të vendosur pranë institucioneve zyrtare perkatëse.

IV. SFIDAT KRYESORE NË ZBATIMIN E STRATEGJISË

Proçesi i zbatimit dhe monitorimit të strategjisë ka ndeshur dhe do të ndeshet me disa sfida, ku ndër më kryesoret listojmë:

Lidhur me procesin e zbatimit :

- ❖ ***Kapacitet institucionale duke përfshirë numrin e limituar të stafëve.*** Mungesat e stafëve si rezultat i vonësave në procedurat e rekrutimit sjell mosfunksionimin e duhur të disa institucioneve siç është rasti i ISHMT-së. Këto mungesa shoqëruar edhe me mungesën e përvojës bëjnë të domosdoshmë ofrimin e trajnimeve si brenda dhe jashtë vendit me qëllim rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve njerëzore.
- ❖ ***Mungesa e infrastrukturës së nevojshme*** (ambiente pune, mjete pune dhe laboratorike, mjete transporti) sjell pengesa në kryerjen e inspektimeve me shtrirje në të gjithë vendin në fushën e metrologjisë.
- ❖ ***Vështirësitë në mbledhjen e opinionit qytetar për funksionimin e tregut*** për shkak të mungesës së aktivitetit të shoqatave ekzistuese të mbrojtjes së konsumatorëve, mungesës së informacionit në faqe zyrtare të interneti të institucioneve/konsumatorëve/bizneseve, apo mos funksionimi i tyre për shkak të problemeve teknike, do të sillte uljen e numrit të konsumatorëve apo bizneseve të aksesueshem për realizimin e anketimeve.
- ❖ ***Mungesa e sistemeve të integruar të bazës së të dhënave dhe mirëmbajtjes së tyre në institucionet ekzistuese.*** Ky është një problem i ndjeshëm për institucione të reja si ISHMT por edhe për disa sektorë tjerë si farmaceutika ku harta online e farmacive e cila do siguronte informacionin e duhur për shtrirjen e tyre në gjithë vendin.

Lidhur me procesin e monitorimit dhe vleresimit :

- ❖ ***Procesi krijimit të qeverisë së re ishte një ndër sfidat më të mëdha me të cilat u përball grumbullimi i të dhënave për hartimin të raportit.*** Në raportin e monitorimit të Strategjisë gjatë pjesës së dytë të vitit 2017 funksionimi normal i administratës pati ndikime të drejtëpërdrejta. Ndryshimi i strukturave të ministrive dhe institucioneve të pavarura si pasojë e situatës pas-zgjedhore, ishin elementë të cilët patën ndikim e tyre në ritmin e zbatimit të Strategjisë dhe krijuan probleme në procesin e raportimit të arritjeve nga institucione të ndryshme.
- ❖ ***Mungesa e strukturave koordinuese dhe përgjegjshmëria nga ana e institucioneve.*** Mbledhja e informacionit ishte një nga sfidat më të mëdha me të cilat u ndesh hartimi i raportit të monitorimit. Institucione apo struktura të ndryshme sollën kontribute minimale lidhur me arritjet e strategjisë. Problematike mbetet raportimi nga struktura jashtë strukturës kryesore përgjegjëse

Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, por edhe struktura brenda sistemit. Kapacitete e stafëve për hartimin e analizave dhe raportimin e zbatimit të strategjisë bazuar në evidenca që mbështesin arritjet mbeten në përgjithësi të dobta. Trajnimi i stafëve për raportimin dhe analizën e politikave është shumë e rëndësishme.

- ❖ ***Mungesa e një qasje sistematike në grumbullimin dhe raportimin e të dhënave.*** Edhe pse strategjia kishte tregues të përcaktuar qartë për një pjesë të tyre nuk u bë e mundur raportimi i të dhënave.
- ❖ ***Në përfundim, një nga sfidat mbetet dhe prezantimi i sigurtë dhe i hapur i problemeve që ndeshën në zbatimin e strategjive.*** Kjo kërkon një ndryshim në kulturën e punës së administratës shqiptare: kulturën e analizës dhe evidentimit të problematikave në mënyrë sa më objektive. Evidentimin e disa nga risqeve dhe sfidave me të cilat do të haseshin realizimi i aktiviteteve në disa fusha u krye vetëm nga ISHMT dhe Sektori e Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, ndërsa asnjë nga strukturat e tjera nuk paraqiti informacion mbi problematikat, sfidat dhe risqet e mundshme me të cilat është ndeshur apo do ndeshet Strategjia. Kjo kërkon një qasje sa më sistematike dhe gjithë përfshirëse në të gjitha nivelet teknike dhe menaxheriale gjatë procesit të raportimit të secilës strukturë.

Shtojca 1 : Plani i Veprimit i Integruar 2014 – 2020²⁸

No. Obj dhe Aktivit. (konsoliduar)	Objektivat dhe produktet	Institucioni përgjegjës	Afatet e zbatimit	Ecuria e Zbatimit te Aktiviteteve deri në Gusht 2018
1	Plotësimi i legjislacionit në të gjithë zinxhirin ushqimor, në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve, si dhe harmonizimi i tij me kuadrin rregullator evropian.			
1.1	Hartimi i 40 akteve nënligjore të harmonizuara me kuadrin rregullator evropian	MBZHR	Deri në v. 2015	<p>*Udhëzim i Ministrit nr. 4, datë 14.05.2014 “Mbi produktet ushqimore dhe ingredientët ushqimor të trajtuar me rrezatim jonizues”.(Direktiva e Këshillit 1999/2/KE LEX-FAOC019333)</p> <p>*Urdhër i Ministrit nr. 234, datë 20.05.2014 që amendon Urdhrin nr. 261, datë 10.9.2009 “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. Rregullore Komisionit 2073/2005/KE. CELEX nr. 32005R2073-EN</p> <p>*Urdhër i Ministrit nr. 350, datë 15.07.2014 që miraton Rregulloren “Në lidhje me laktoproteina të caktuara (kaseina dhe kaseinate) të destinuar për konsum njerëzor” (Direktivë e Këshillit 83/417/KEE, LEX-FAOC018693)</p> <p>* Urdhëri i përbashkët, nr. 297, datë 06.06.2014 i Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë, Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetësisë, “Për përditësimin e Shtojcës II, të vendimit nr. 1555, datë 12.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të regjistrimit dhe kriterëve të vlerësimit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve”, i ndryshuar është miraturar. Ky urdhër është në përputhje me listën e përditësuar të Direktives 91/414/EEC.</p>
1.2	Hartimi i 150 akteve nënligjore të harmonizuara me kuadrin rregullator evropian	MBZHR	2016-2020	<ol style="list-style-type: none"> 1. VKM për Informimin e konsumatorit, miratuar VKM nr. 434, datë 11.07.2018 2. Urdhër mbi substancat aktive farmakologjike dhe klasifikimin e tyre në lidhje me nivelet maksimale të mbetjeve në produktet ushqimore me origjinë shtazore, miratuar Urdhër nr. 139/1, datë 07.04.2017 3. VKM “Për rregullat e regjistrimit, procedura dhe kriteret e vlerësimit të PMB-ve”. Është dërguar drafti për mendim në ministritë e linjes. 4. VKM “Për rregullat për tregtimin, transportin, ruajtjen dhe magazinimin e PMB-ve”. Po punohet me draftin. 60% e realizuar 5. Urdhër i ministrit, “Për përditësimin e Urdhrit të ministrit nr. 72, datë 2/03/2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”. Po punohet me draftin. 70% e realizuar 6. Ligj nr. 106/2016 për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre (përafroft pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007) 7. Ligj nr. 105/2016 Për mbrojtjen e bimëve 8. Ligj nr. 103/2016 për akuakulturën 9. Urdhër i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 182, datë 17.3.2016 Për miratimin e rregullores “Për paraqitjen e vlerave ushqimore dhe shëndetësore të produkteve ushqimore” 10. Vendim nr. 875, datë 14.12.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të

²⁸ Note: Emërtimi i institucioneve në këtë raport ka ndryshuar kundrejt variantit të dokumentit të Strategjisë, duke reflektuar ndryshimet e strukturës së ministrive pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017.

				<p>farave të bimëve vajore dhe fibrore</p> <p>11. Urdhër i Ministrisë nr. 9, datë 10.10.2016 për kontrollet zyrtare për trichinella (përaftron Rregulloren 2015/1375)</p> <p>12. Urdhër i Ministrisë nr. 645, datë 23.12.2016 Për kriteret mikrobiologjike të produkteve ushqimore (përaftron Rregulloren 2073/2005)</p> <p>13. Urdhër i Ministrisë nr. 12, datë 6.1.2017 që ndryshon urdhrin 5/2014 për maksimumin e lejuar të pesticideve në bananet, grurë, mollë, patate, rrushit të tavolines, specave dhe ullinjve (përaftron Rregulloren 396/2005)</p> <p>14. Urdhri nr. 72, datë 2.3.2017 për aprovimin e substancave aktive të produkteve të mbrojtjes së bimëve</p> <p>15. Urdhër i Ministrisë nr. 435, datë 15.8.2016 për identifikimin dhe regjistrimin e derrave (përaftron direktivën 2008/71/EC)</p> <p>16. Urdhër i Ministrisë nr. 505, datë 7.12.2016 për problemet e shëndetit të kafshëve që ndikojnë në tregtinë me BE-në (përaftron direktivën 64/432/EEC)</p> <p>17. Urdhër i Ministrisë nr. 506, datë 7.12.2016 për rregullat e shëndetit në lidhje me nën-produktet shtazore dhe ato me origjinë shtazore që nuk janë të destinuara për përdorim njerëzor (përaftron Rregulloren 1069/2009/EC)</p> <p>18. Urdhër i Ministrisë nr. 1, datë 27.7.2017 Për kushtet e shëndetit të kafshëve që ndikojnë në tregtinë me vendet e BE-së (përaftron direktivën 91/68/EEC)</p> <p>19. Ligji nr. 80/2017 që amendon ligjin nr. 64/2012 për peshkimin (përaftron rregulloren 1224/2009)</p> <p>20. VKM nr. 719, datë 12.10.2016 “për menaxhimin e burimeve të peshkimit dhe disa rregulla për funksionimin e regjistrimit të peshkimit</p>
2	Garantimi i sigurisë së ushqimit, produkteve ujore, vecanërisht molusqeve bivalve, sipas parimit nga ferma në tavolinë.			
2.1	Vlerësimi dhe kategorizimi i stabilimenteve ushqimore në bazë të vlerësimit të riskut.	MBZHR	2020	AKU ka kryer vlerësimin e riskut mbi kategorizimin e OBU që prodhojnë, përpunojnë dhe shpërndajnë ushqime me origjinë shtazore dhe jo shtazore dhe klasifikimit të riskut të ndarë sipas grup produkteve (të lartë, të mesëm dhe të ulët)
2.2	Kryerja e kontrollit zyrtar të ushqimeve, produkteve ujore në bazë të planit vjetor dhe shumëvjetor të kontrollit dhe mostrimit të hartuar në bazë të riskut dhe që përfshin çdo vit 50% të operatorëve të biznesit ushqimor me risk të lartë dhe të mesëm.	MBZHR	Deri në v.2015	Janë miratuar planet kombëtarë Vjetorë për kontrollet zyrtare në bazë të riskut dhe marrjes së mostrave për produktet ujore, ushqimore, bimë dhe mbrojtjes së bimëve nëpërmjet miratimit të 2 Urdhrave të Ministrisë: nr 622, datë 6.1.2016 dhe nr. 4, datë 2.3.2017 për periudhat 2016-2017 dhe 2017-2018 respektivisht. Është miratuar Plani i Veprimeve nr. 1386, datë 4.5.2016 për monitorimin e qumeshit të papërpunuar që është zbatuar në 2 faza: Prill-Maj 2016 dhe Shtator-Tetor 2016. Plani i Kontrollit Zyrtar Vjetor në bazë të riskut dhe Marrjes së mostrave është hartuar nga AKU dhe i miratuar nga Ministri i MBZHR i cili përcakton qartë objektet e kontrollit, dmth numrin e OB të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe jo shtazore, duke përcaktuar klasifikimin e riskut të ndarë sipas grup produkteve. Në bazë të këtij kategorizimi është hartuar metodologjia “frekuenca e kontrolleve zyrtare të planifikuara me bazë të riskut të operatorëve të biznesit”. Ku frekuenca e kontrolleve zyrtare të planifikuara është gjithmonë në proporcion me nivelin e riskut. Nga trupat inspektuese të AKU janë kryer inspektime në zbatim të planit vjetor 2017, me objekt licensimi të OBU sipas kërkesave të OBU, riinspektime si dhe indiciove ,
2.3	Rritja e nivelit të zbatimit të sistemit të gjurmueshmërisë duke rritur me 5% çdo vit numrin e operatorëve të biznesit ushqimor që aplikojnë atë.	MBZHR	Deri në v.2015	Nuk ka informacion

2.4	Vendim i Komisionit Evropian per listimin e Shqiperise lidhur me te drejten e eksportimit ne BE te molusqeve bivalve (per nje zone)	MBZHR	Deri ne v.2015	Nuk është realizuar si objektiv akoma. Vazhdon monitorimi i molusqeve sipas planit kombëtar të monitorimit i cili përditësohet cdo vit (AKU në bashkëpunim me ISUV) duke rregjistruar gjithë setin e rezultateve të analizave si një parakusht për marrjen të drejtën e eksportit në BE.
2.5	Rritja e standardit te kontrollit zyrtar te ushqimeve dhe produkteve ujore ne baze te planit te permiresuar vjetor dhe shume vjetor te kontrollit dhe mostrimit qe do rezultojte ne uljen 5% çdo vit të moskonformiteteve kundrejt vitit te kaluar..	MBZHR	2017	Nuk ka informacion
2.6	Shtrirje e monitorimit, klasifikimi dhe miratimi nga Komisioni Evropian (DG SANCO) i tetë zonave potenciale te prodhimit te molusqeve bivalve te gjalle sipas kriterëve te BE-se si dhe rishikimi i vazhdueshem i mbikëqyrjes sanitare;	MBZHR	2017	Nuk është realizuar
3	Garantimi ne nje nivel me te larte te shëndetit të konsumatorëve nga parandalimi dhe eliminimi i risqeve ushqimore.			
	Realizimi 100% i programeve kombetare te monitorimit te mbetjeve, kriterëve mikrobiologjike dhe kontaminanteve ne kafshe te gjalla, produkte ushqimore me origjine shtazore dhe jo shtazore, si dhe ujerave te molusqeve bivalve	MBZHR	2017	Nuk ka informacion
4	Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të AKU dhe infrastrukturës operative të saj, në veçanti të laboratorëve rajonalë dhe pikave të inspektimit kufitar.			

4.1	Trajnimin vjetor te 10% te stafit.	MBZHR/ AKU	2020	<p>- Trajnimin i specialistëve të laboratorëve të mbrojtjes së bimëve të AKU-së për diagnostikimin e parazitëve karantinorë(Shkurt 2016) Është kryer trajnimi edhe për disa specialistë të laboratorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> •- Trajnimi nga TIKA edhe për disa specialistë të laboratorit në mbeshtetje të programit në përkrahje të sigurisë së jetës dhe ushqimit në vendet e Europës Lindore dhe Ballkanit “Program trajnimi HACCP në Shqipëri” Janar 2016. - Trajnim nga IFC për disa pjesëmarrjes të stafit të Drejtorisë së Përgjithme të AKU “Kontrollet me bazë rrisht në Pikat e Inspektimit Kufitar”. Nëntor 2016 - Trajnim nga TAIEX për disa pjesëmarrjes të stafit të MBZHR dhe Drejtorisë së Përgjithme të AKU për monitorimin e qumështit lëndë e parë. Janar 2017- Harmonizimi i legjislacionit mbi ushqimet gjenetikiisht të modifikuara (kodi referencës: AGR 64069) - Trajnim nga TAIEX për disa specialistë të laboratorit gjatë 2017: Harmonizimi i legjislacionit mbi ushqimet gjenetikiisht të modifikuara (kodi referencës: AGR 64069); - Legjislacioni i BE-së mbi informacionin ushqimor për konsumatorët (kodi referencës: AGR 64035) - Mbetjeve e pesticideve në produktet me origjinë bimore (kodi referencës: AGR 64037) <p><u>Trajnime te Inspektorët E Sektorit Përkatës Së Drejtorisë Së Përgjithshme Dhe Drejtorive Rajonale Të AKU Në Pikat E Inspektimit Kufitar</u></p> <ul style="list-style-type: none"> •Trajnimi nga TIKA edhe për disa specialistë të laboratorit në mbeshtetje të programit në përkrahje të sigurisë së jetës dhe ushqimit në vendet e Europës Lindore dhe Ballkanit “Program trajnimi HACCP në Shqipëri”. Janar 2016. • Trajnimi nga BTSF “Kontrollin në PIK”. Qershor 2016 •Trajnim nga IFC për disa pjesëmarrjes të stafit të Drejtorisë së Përgjithme të AKU “Kontrollet me bazë rrisht në Pikat e Inspektimit Kufitar”. Nëntor 2016 •Trajnimi nga TAIEX “Funksionimin e sistemit TRACES”. Nëntor 2016 •Trajnimi nga TAIEX “Legjislacioni i BE mbi kontrollet në import në Pikat e Inspektimit Kufitar”. Prill 2017 <p>Në lidhje me unifikimin e metodave laboratorike dhe trajnim të stafit të Laboratorëve Rajonale të AKU-së për vitin 2018 jane realizuar këto trajnime (dhe jemi në proces të realizimit sipas grafikut të përcaktuar):</p> <ul style="list-style-type: none"> - TVB-në në peshkun e freskët, official journal 2074/2005 kodi 10-AV-001, Maj 2018 - Numërimi i NPM aerobë në qumështin e freskët me teknikën “numërim mikrobik të përgjithshëm”, kodi 10-MU-002. Korrik 2018 - Numërimi i qelizave somatike me metodën mikroskop, kodi 10-MU-015. Korrik 2018 - numërimi i Bacilus Cereus i dyshimtë tek buka, teknika e numërimit në pjatë në 30 oC, kodi 10-MU-020. Qershor 2018 - Numërimi i Escherichia coli B-glukoronidazë-pozitive me teknikën “numërim mikrobik të përgjithshëm” kodi 10-MU-005. Qershor 2018 - Analiza mikrobiologjike e ujit, Escherichia coli dhe koliformë me teknikën “filtrim me membranë” kodi 10-MU-010. Qershor 2018 - Numërimi i Enterobaktereve, teknika e numërimit në tuba, kodi 10-MU-007. Korrik 2018 - Zbulimi i salmonella spp kodi 10-MU-002, Maj 2018 - Zbulimi i campylobacter spp në ushqime dhe ushqimit për kafshë kodi 10-MU-021. Qershor 2018 - Zbulimin e Trikinelës në mishin e kafshëve të ndryshme, tretje enzimatiqe, kodi POS 10- DP- 006. Maj 2018
-----	------------------------------------	------------	------	--

				<p>- Numri i jodit dhe peroksideve në yndyrna dhe vajra, EC 2561/91, kodi 10-CU-001.</p> <p>Aktualisht AKU, MBZHR, dhe ISUV po punojnë me asistencën e Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” (Contract no. AL/IPA2013/04” filluar në korrik 2016 dhe zgjat 36 muaj). Objektivi i përgjithshëm i Projektit pjesë e kësaj kontrate është për të mbështetur kapacitetet administrative kombëtare për të siguruar nivele të përmirësuara të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor.</p> <p><u>Trajnime në të cilat ka pasur pjesëmarrje edhe të Sektorit në DP/ DRAKU:</u></p> <p>- Pjesëmarrjen në Workshopin TAIEEX me titull: Traceability of Food and Feed, organizuar në Tiranë, datë 12.02.2018.</p> <p>- IPA Trajnim mbi administrimin e sistemit LIS organizuar nga Projekti “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”. organizuar në Tiranë, në mars 2018 (eksperti i projektit). Trajnim II mbi administrimin e sistemit LIS nga administratorët, organizuar po nga ky Projekt.</p> <p>- Pjesëmarrjen në Workshopin me titull: Laboratory Quality Management and Good Safety Practices for Laboratories” për data 23-24.05.2018 organizuar nga projekti i laboratorëve, qëllimi është ngritja dhe implementimi i këtij sistemi në AKU.</p> <p>- Pjesëmarrje në IFC, organizuar në Tiranë datë 11-15.12.2017 për “Developing a risk-based SPS border inspection system in Albania”. Vazhdimësi e trajnimit në datat 18–22 Qershor 2018.</p>
4.2	Unifikimin e metodave dhe metodologjive të analizimit të produkteve ushqimore	MBZHR/ AKU	2020	<p>1.U krye unifikimi i disa metodologjive të miratuara në cilësi nga Qendra e Referencës ISUV në lidhje me vlerësimin e kritereve të sigurisë dhe cilësisë, si dhe shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve në vartësi të laboratorit. Prill 2015</p> <p>2. Unifikimi i metodat laboratorike për diagnostikimin e parazitëve nga Qendra e Referencës Departamentit të Mbrojtjes Bimëve pranë UBT shkurt 2016.</p> <p>Vazhdon përdorimi i dokumentacionit të unifikuar të strukturave inspektuese, si dhe ai i aplikimit të tarifave të miratuara për inspektorët e Pikave të Inspektimit Kufitar. Në 2016- 2017 nuk është kryer trajnim për stafin e laboratorit të AKU bazuar në kërkesën e kryer mbi nevojat për unifikim të metodave laboratorike dhe trajnim të stafit të Laboratorëve Rajonale të AKU-së për vitin 2016-2017.</p> <p>Bazuar në kërkesën e kryer mbi nevojat për unifikim të metodave laboratorike dhe trajnim të stafit të Laboratorëve Rajonale të AKU-së për vitin 2018 jane realizuar këto trajnime (dhe jemi në proces të realizimit sipas grafikut te përcaktuar):- TVB-në në peshkun e freskët, official journal 2074/2005 kodi 10-AV-001, maj 2018- Numërimi i NPM aerobë në qumështin e freskët me teknikën “numërim mikrobik të përgjithshëm”, kodi 10-MU-002. Korrik 2018- Numërimi i qelizave somatike me metodën mikroskop, kodi 10-MU-015. Korrik 2018- numërimi i Bacilus Cereus i dyshimtë tek buka, teknika e numërimit në pjatë në 30 oC, kodi 10-MU-020. Qershor 2018- Numërimi i Escherichia coli B-glukoronidazë-pozitive me teknikën “numërim mikrobik të përgjithshëm” kodi 10-MU-005. Qershor 2018- Analiza mikrobiologjike e ujit, Escherichia coli dhe koliformë me teknikën “filtrim me membranë” kodi 10-MU-010. Qershor 2018- Numërimi i Enterobaktereve, teknika e numërimit në tuba, kodi 10-MU-007. Korrik 2018- Zbulimi i salmonella spp kodi 10-MU-002, Maj 2018- Zbulimi i campylobacter spp në ushqime dhe ushqimit për kafshë kodi 10-MU-021. Qershor 2018 - Zbulimin e Trikinelës në mishin e kafshëve të ndryshme, tretje enzimatike, kodi POS 10- DP- 006. Maj 2018- Numri i jodit dhe peroksideve në yndyrna dhe vajra, EC 2561/91, kodi 10-CU-001.</p> <p>Aktualisht AKU, MBZHR, dhe ISUV po punojnë me asistencën e Projektit IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” (Contract no. AL/IPA2013/04” filluar në korrik 2016 dhe zgjat 36 muaj).Objektivi i përgjithshëm i Projektit pjesë e</p>

				<p>kësaj kontrate është për të mbështetur kapacitetet administrative kombëtare për të siguruar nivele të përmirësuara të sigurisë ushqimore në të gjithë zinxhirin ushqimor. Qëllimi: - Ngritja e një rrjeti kosto-efiçent laboratorik të aftë për të garantuar informacion të besueshëm dhe në kohë mbi sigurinë e ushqimeve të tregtuara dhe shëndetin e kafshëve. - Rritja e kapaciteteve të rrjetit laboratorik për të kryer monitorime dhe analiza të produkteve ushqimore dhe ushqim për kafshë me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnozës mikrobiologjike në ushqim dhe ushqim për kafshë, standarteve të cilësisë, semundjeve të kafshëve, në përputhje me standarte të përmirësuara. Gjatë prezantimeve të mëpasshme, duke u nisur nga gjendja aktuale në të cilën ndodhen laboratorët rajonalë të AKU, u sugjerua nga ekspertet ndërkombëtarë të Projektit, fillimi i procedurave për akreditimin e disa provave, bazuar të cilave është kryer parashikimi në projekt buxhet 2019-2020. Ø Trajnime në të cilat ka pasur pjesëmarrje edhe të Sektorit në DP/ DRAKU:- Pjesëmarrjen në Workshopin TAIEX me titull: Traceability of Food and Feed, organizuar në Tiranë, datë 12.02.2018. - IPA Trajnim mbi administrimin e sistemit LIS organizuar nga Projekti “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”, organizuar në Tiranë, në mars 2018 (eksperti i projektit). Trajnim II mbi administrimin e sistemit LIS nga administratorët, organizuar po nga ky Projekt.- Pjesëmarrjen në Workshopin me titull: Laboratory Quality Management and Good Safety Practices for Laboratories” për data 23-24.05.2018 organizuar nga projekti i laboratorëve, qëllimi është ngritja dhe implementimi i këtij sistemi në AKU.- Pjesëmarrje në IFC, organizuar në Tiranë datë 11-15.12.2017 për “Developing a risk-based SPS border inspection system in Albania”. Vazhdimësi e trajnimit në datat 18–22 Qershor 2018.</p>
4.3	Pjesëmarrjen në teste ndërkrhasimore.	MBZHR/ AKU	2020	<p>a. Testimet ndërlaboratorike të organizuara nga ISUV:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Metoda Rose Bengal për diagnostikimin e brucelozës. Prill 2015 2. Numërimi i ngarkesës mezofile. Kodi i Shpërndarjes 5RTm10G. Tetor 2015 3. Numërimi i Enterobakterieve. Kodi i Shpërndarjes 5RTm10F. Tetor 2015 4. Numërimi i Stafilokokëve koagulazë pozitiv. Kodi i Shpërndarjes 5RTm11B. Nëntor 2015. 5. Numërimi i Escherichia coli beta-glucuronidazë positive-Teknika e numërimit në pjatë. Kodi i Shpërndarjes 5RTm11E. Nëntor 2015 <p>b. Testimet ndërlaboratorike të organizuara nga Departamenti i Mbrojtjes Bimëve pranë UBT.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ambjentet ushqyes për rritjen e fusariozave e disa patogjenëve kërpudhorë në kulturë të pastër 2. Metodat për diktimin apo zbulimin e patogjeneve kërpudhore në farë. 3. Protokollat standarte për objektet karantinore, patogjenë të farës <ul style="list-style-type: none"> • Protokoll i EU për diagnostikimin e organizmit karantinore. • Protokoll diagnostikues Synchronium endobiotichum • Protokoll diagnostikimi për parazitin karantinor Clavibacter michiganensis subsp. Sepedonicus • Protokoll diagnostikimi për parazitin karantinor. Kalbëzimi bakterial ngjyrë kafe Ralstonia solanacearum • Protokoll diagnostikues i nematodës gungore të rrënjëve, Meloidogyne incognita • Metoda serologjike në diagnostikimin e viruseve
4.4	Ngritja e sistemit të menaxhimit të cilësisë.	MBZHR/ AKU	2020	<ul style="list-style-type: none"> • Është kryer vlerësimi i laboratorëve dhe vendosja e tyre në formatin e sistemit të menaxhimit të cilësisë. (Mars 2016) • Është kryer vlerësimi i laboratorëve veterinar shtetëror të AKU nga Qendra Kombëtare e Referencës Laboratorike Veterinare ISUV referuar aktivitetit në dy vitet e fundit 2015-2016. Shkurt-mars 2017. • Vazhdon mirëmbajtja e procedurave dhe dokumentacionit që janë pjesë e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe aktualisht të gjithë laboratorët rajonalë të AKU zbatojnë procedurat dhe dokumentacionin e

				unifikuar bazuar në Urdhërin nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”, si dhe kryhet njoftim i menjëhershëm on line i informacionit të shpejtë me institucionet e linjës në rast jokonformiteti që bën të mundur identifikimin dhe marrjen e masave për produktet që çenojnë sigurinë ushqimore, po ashtu dhe për diagnozën e kafshëve. - Projekti mbështetës “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit të laboratorëve të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri” (Contract no. AL/IPA2013/04” filluar në korrik 2016 dhe zgjat 36 muaj) fillimisht vlerësoi situatën aktuale ku problematike qëndrojnë: numri i ulët i stafit, trajnimi i stafit dhe zhvillimi i testeve ndërlaboratorike, burimet buxhetore të kufizuara për të mbuluar shpenzimet operative.
5	Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në shërbimin veterinar dhe rritja e efektivitetit në nivel qendror e rajonal			
5.1	Riorganizimi i shërbimit veterinar në nivel qendror dhe rajonal sipas standarteve;	MBZHR	Deri në v.2015	Vendim nr. 146, datë 13.3.2018 Për Krijimin, Organizimin Dhe Funksionimin E Agjencive Rajonale Të Shërbimit Veterinar Dhe Mbrojtjes Së Bimëve . Krijimin e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve (ARSHVMB), si persona juridikë publikë, në varësi të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, me seli në Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe Elbasan.
5.2	Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe përditësim i legjislacionit në fushën e shëndetit dhe mirëqënies së kafshëve.	MBZHR	Deri në v.2015	Nuk është dhënë informacion
5.3	Përcaktimi i parimeve bazë për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqënjes së kafshëve, sipas standarteve ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE) dhe të Bashkimit Europian.	MBZHR	2016-2020	Nuk është dhënë informacion
6	Mbrojtja e shëndetit të kafshëve dhe ulja e riskut të kalimit të zoonozave te njerëzit			
6.1	Imunizimi 100% i bagëtive të imta në të gjithë vendin nga sëmundja e brucelozës si dhe gjurmimi i sëmundjes së brucelozës në gjedhë në 10% të krerëve çdo vit	MBZHR	2015-2020	Në vitin 2016 bashkëpunim me projektin PAZA filloi fushata e vaksinimit të brucelozës të remontit në të imta “Përmirësimi i shëndetit të njerëzve duke luftuar sëmundjet zoonotike” në masën 690.000 krerë të imta (remont) nga të cilat gjatë vitit 2016 u vaksinuan 594.780 krerë.
6.2	mbajtja nën kontroll të plotë të sëmundjes plasjes duke vaksinuar në të gjithë vatrën e këtij infeksioni dhe e TBC duke gjurmuar dhe eliminuar kafshët e infektuara në vatra.	MBZHR	2015-2020	Nuk është dhënë informacion

6.3	Kontrolli i tërbimit duke vaksinuar kafshët e egra të cilat përbëjnë rezervuarin kryesor të përhapjes së kësaj sëmundje në kafshët shtëpiake dhe njerëz	MBZHR	2017-2020	Në muajin Maj 2017, për të shtatën herë radhazi, u realizua vaksinimi e dhelprave kundër sëmundjes së tërbimit. Avionët e vegjël, nëpërmjet makinerive speciale dhe hartave të sakta shpërndajnë në mënyrë të automatizuar dhe kontrolluar 20 vaksina për kilometër katror, rreth 560,000 vaksina karrem. Ky proces bëhet dy herë në vit, në pranverë dhe vjeshtë.
7	Përcaktimi i veprimtarisë së laboratorëve të autorizuar të kontrollit zyrtar për analizat që ato janë përgjegjës të kryejnë dhe publikimi i tyre.			
7.1	Vlerësimi paraprak i Laboratorëve Rajonalë. Përgatitja e testeve të aftësisë për Laboratorët Rajonalë dhe në bazë të rezultateve të tyre do të realizohet autorizimi i pjesshëm për kryerjen e analizave për Shëndetin e Kafshëve	MBZHR	Deri në v. 2015	Nuk është dhënë informacion
7.2	Rritja e kapaciteteve teknike të Laboratorëve Rajonalë për realizimin e Analizave Ushqimore (mikrobiologjike dhe kimike).	MBZHR	Deri në v. 2015	Nuk është dhënë informacion
7.3	Realizimi i kalibrimeve vjetore të Laboratorëve Rajonalë (përfshihen peshore dhe gurë peshë, termometra dytësorë, aparatura të ndryshme, etj)	MBZHR	Deri në v. 2015	Nuk është dhënë informacion
7.4	Ngritja e sistemit të informacionit laboratorik	MBZHR	Deri në v. 2015	Nuk është dhënë informacion
8	Njohja e rezultateve në nivel kombëtar dhe europian/ndërkombëtar për të paktën 20 lloje testimesh nga laboratorët e ISUV			
	Akreditimi i të paktën 20 lloje testimesh nga organe akredituese nënshkruese të MLA me EA ose Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve	MBZHR	2016-2020	Laboratori I ISUV është akredituar për 24 lloje provash analizash deri tani
9	Garantimi i konsumatorit për një produkt të pastër nga parazitët karantinor në patatën e hershme dhe reduktimi në maksimum i zjarrit bakterial në pemët frutore farore.			
	Reduktimi në masën 10% çdo vit të parazitëve karantinor në patatën e hershme. Reduktimi në masën 10% çdo vit të zjarrit bakterial.	MBZHR	Deri në v. 2015	Nuk është dhënë informacion
10	Krijimin e zonave të lira nga parazitët karantinor.			

10.1	Reduktimi në masën 10% çdo vit të zjarrit bakterial në pemët frutore farore		2016-2020	Nuk është dhënë informacion
10.2	Reduktimi në masën 10% çdo vit të parazitëve karantinor në pataten e hershme.		2016-2020	Nuk është dhënë informacion
11	Përditësim i legjislacionit për sigurinë e Instalimeve dhe produkteve jo-ushqimore duke ndjekur zhvillimet e legjislacionit evropian ;			
11.1	Hartimi i VKM "Për miratimin e rregullit teknik të pajisjeve nën presion të transportueshme", si dhe Rregullores për sigurinë në përdorim të bombolave të gazit për gatim dhe ngrohje nga konsumatorët.	MTI/MEI dhe MZHETS	Deri në v. 2015	VKM nr. 212, datë 16.3.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës"
11.2	Përgatitja dhe miratimi i VKM-së "Për emërtimin e fibrave textile, etiketimin dhe markimin e fibrave përbërëse të produkteve të tekstilit"	MEF	Deri në v. 2015	VKM nr. 1058, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik "Mbi emrat e fibrave textile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve textile".
11.3	Hartimi i legjislacionit në lidhje me instalimin i detyrueshëm të relës diferenciale termike (salva-vita), për mbrojtjen nga goditjet e rrymës elektrike të tensionit të ulët në banesa.	MEI	Deri në v. 2015	VKM nr. 245, datë 30.03.2016 për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet impiantet dhe instalimet elektrike"
11.4	Përgatitja e VKM për sigurinë e ashensorëve që janë vënë në përdorim	MEF	Deri në v. 2015	VKM nr. 1056, datë 23.12.2015, "Për miratimin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim"
11.5	Miratimi i 13 VKM-ve për vendosjen në treg të produkteve të sigurta lidhur me pajisjet nën presion, enët e thjeshta nën presion, ashensorët, përputhshmëria elektromagnetike, pajisjet elektrike që përdorin voltazh të ulët, pajisjet me gaz, makineritë, pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambjente potencialisht shpërthyes, pajisjet mbrojtëse personale, boilerët e ujit që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë, instrumentat matës, droselat, pajisjet në	MEF	Deri në v. 2015	Akteve nënligjore janë realizuar si më poshtë : 1. VKM nr. 1060, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për makineritë" 2. VKM nr. 1061, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet elektrike të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit 3. VKM nr. 1062, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion" 4. VKM nr. 1063, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për emetimin e zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura" 5. VKM nr. 1064, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat e efikasitetit për boljerët e ujit që përdorin lëndë djegëse të lëngët ose të gaztë" 6. VKM nr. 1065, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Enët e thjeshta nën presion" 7. VKM nr. 1066, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse për përdorim në ambiente potencialisht shpërthyes" 8. VKM nr. 1067, datë 23.12.2015 për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet e gazit" 9. VKM nr. 245, datë 30.03.2016 për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet impiantet dhe instalimet elektrike"

	mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave.			<p>10. VKM nr. 1059, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat e eficensës së droselave për ndricim fluoreshent””</p> <p>11. VKM nr. 1053, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet mbrojtëse personale (PMP)” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”</p> <p>12. VKM nr. 1057, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për ashensorët” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara</p> <p>13. VKM nr. 1054, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për përputhshmërinë elektromagnetike” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara</p> <p>14. VKM nr. 1055, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për instrumentet matëse”,</p> <p>15. VKM nr. 1351, datë 03.10.2008, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike metrologjike të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluara” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”</p> <p>16. VKM nr.1056, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për sigurinë e ashensorëve në përdorim”</p> <p>17. VKM nr. 488, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve", i cili përfron plotësisht Rregulloren (KE) nr. 1272/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 16 Dhjetor 2008 mbi Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve,</p> <p><u>Ligje të hartuara ose në proces</u></p> <p>- Ligji 32/2016, datë 24.03.2016 “Per garantimin e sigurisë se punës te pajisjeve dhe instalimeve nën presion”</p> <p>- Është hartuar draft projektligji për produktet e ndërtimit që adopton rregulloren 305/2011 të BE-së dhe i është dërguar për mendim palës kosovare në kuadër të unifikimit të kornizës ligjore për produktet e ndërtimit.</p> <p>Është hartuar dhe janë në proces marrje mendimi nga institucionet relevante:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike” • Rregulli teknik “Për enët e transportueshme nën presion” • Rregulli teknik “për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë në linjat elektrike ajrore e kablore mbi 1kv” • Rregulli teknik “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1KV”
11.6	Miratimi i ligjit për pajisjet mjekësore	MSH	Deri në v. 2015	Ligji nr. 89/2014, datë 17.7.2014 “Për pajisjet mjekësore”
11.7	Përgatitja e rregullit teknik për fishekzjarret	MM	Deri në v. 2015	Nuk është realizuar
11.8	Përgatitja dhe miratimi i ligjit të ri për materialet e ndërtimit	MZhUT	Deri në v. 2015	Është përgatitur koncept-dokumenti i ligjit për materialet e ndërtimit dhe ka kaluar për mendim në ministrinë e linjës te cilat janë përgjigjur me “parimisht dakord”. Është hartuar draft projektligji për produktet e ndërtimit që adopton rregulloren 305/2011 të BE-së dhe i është dërguar për mendim palës kosovare në kuadër të unifikimit të kornizës ligjore për produktet e ndërtimit. Priten komentet e palës kosovare. Po konsultohet për konceptimin fillestar të një projektakti për këtë fushë, por nuk janë ndërmarrë akoma hapa për përfshirjen në matricën e projekt akteve.
11.9	Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese/informuese për organizatat e konsumatorëve dhe ato të biznesit (takime	Të gjitha institucionet	Deri në v. 2015	

	informuese, materiale informuese, etj)			
11.10	Hartimi dhe miratimi i rreth 30 akteve të reja ligjore/ nënligjore për grup produkte, nëpërmjet transpozimit të direktivave evropiane në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.	Të gjitha institucionet	2016-2020	<p>1. Ligji nr. 27/2016 “Mbi menaxhimin e kimikateve</p> <p>2. VKM nr. 770, datë 02.11.2016 “Për instrumentet matës dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara” (direktiva 2014/32/EU)</p> <p>3. VKM nr. 942, datë 12.2016 “Per etiketimin e energjisë së llampave dhe ndricuesve elektrike” (transpozon Rregulloren (EU) nr. 874/2012)</p> <p>3. VKM nr. 488, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve" (përafroon plotësisht Rregulloren (KE) nr. 1272/2008)</p> <p>5. VKM" nr. 489, datë 29.06.2016 “për miratimin e listës së substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën e svhc dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC”</p> <p>6. VKM “Mbi kufizimet në prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuara të rrezikshëm</p> <p>7. VKM nr. 665 “Për importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme” (transpozon plotësisht Rregulloren (EU) nr. 649/2012)</p> <p>8. VKM nr. 675, datë 28.09.2016 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”. (transpozon Direktiven 2008/43/EC)</p> <p>9 VKM nr. 189, datë 9.3.2016 për miratimin e rregullit teknik "Për kerkesat thelbësore, markimin CE dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve mjekësore diagnostikuese in vitro" (transpozon Direktiven 98/79/EC)</p> <p>10. Vendim nr. 487, datë 29.6.2016 për klasifikimin e produkteve biocide (përafroon pjesërisht rregulloren (EC) nr. 528/2012)</p>
12	Krijimi i një baze fillestare të dhënash për nivelin e sigurisë së produkteve të konsumatorëve që janë në treg			
12.1	Krijimi i “Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut” për produktet jo-ushqimore, me infrastrukturën perkatese dhe kapacitetet e nevojshme institucionale.	MEF	Deri në v. 2015	<p>Me VKM. nr. 36, datë 20.01.2016 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHMT” është krijuar ISHMT dhe miratimi i organigramës është bërë me Urdhër të Kryeministrit nr. 86, datë 16.05.2016. ISHMT ka filluar funksionimin normal në Janar 2017. Sipas strukturës së miratuar ISHMT është e organizuar në 4 drejtori dhe një sektor, me një numër total punonjësish prej 90 persona. Në vitin 2017 numri i punonjësve të emëruar në ISHMT në total ishte 49 persona nga të cilët 44 ishin inspektorë. Në vitin 2017 Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve kishte të emëruar vetëm 34.3 % të stafit. Në dy sektorë (sektori i produkteve elektrike dhe sektori i produkteve mekanike) nga 4 në total nuk kishte të emëruar asnjë inspektor. Për vitin 2017 ISHMT kishte në përdorim vetëm një zyrë në ambientet e MFE (rreth 25 m²). Në shtator 2017 i kaluan si kapital për përdorim 2 autolaboratorë matës nga DPM (për inspektimin metrologjik) dhe 1 mjet transporti (autoveturë) nga MFE. Me VKM nr. 383, datë 27.06.2018 “Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organikë në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2018” dhe Urdhërit të Kryeministrit nr. 107, datë 31.07.2018 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 86, datë 16.05.2016 të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut”” (bashkëngjitur), struktura e ISHMT-së ka pësuar ndryshime, Drejtoria e</p>

				Mbikëqyrjes së Standardeve për Turizmin largohet nga ISHMT-ja dhe kalon në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, dhe Ujërave në varësi të MTM.
12.2	Krijimi i sistemit të dhënash për nivelin e sigurisë së produkteve të konsumatorëve që janë në treg, përfshirë dizejimin e kërkesave, zhvillimin e sistemit dhe politikave të sigurisë dhe mirëmbajtjes së sistemit, tranimin e personave përgjegjës për supervizimin e zbatimit të sistemit	ISHMT	Deri në v. 2015	VKM për miratimin e ISHMT edhe pse daton në 20.01.2016, ky institucion filloi aktivitetin e tij në Janar 2017. Si një institucion i ri dhe me një fokus shumë të gjërë të fushës së veprimtarisë nuk iu vu në dispozicion asnjë bazë të dhënash nga institucione të tjera, mbi subjektet apo inspektimet e kryera që ishin nën juridiksionin e këtyre institucioneve si nga DPM, MK në lidhje me inspektimin e metrologjisë, në fushën e të drejtave të autorit. Aktualisht ISHMT është angazhuar në ngritjen e bazës të të dhënave të operatorëve ekonomikë sipas fushave që mbulon ky institucion, nëpërmjet evidencimeve nga vetë stafi si dhe bashkëpunimit me QKB, DPD, DPT, etj. ISHMT nuk disponon program për administrim të dhënash dhe shkëmbim informacioni. Në projektin EuropeAid/137616/IH/SER/AL "Technical Assistance to carry out effective market surveillance in line with acquis" i cili do të fillojë në 6-mujorin e II-të të vitit 2018 është parashikuar krijimi i një softueri për të shërbyer si një qendër dhe kujtesë për të gjithë aktivitetet e sistemit të mbikëqyrjes së tregut si dhe trajnimit i stafit për përdorimin e tij.
12.3	Përgatitja dhe miratimi i VKM për ngritjen e Inspektoriatit të Mbikëqyrjes së Tregut së bashku me miratimin e organigramës	ISHMT	Deri në v. 2015	VKM nr. 36, datë 20.1.2016 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut" si dhe Urdhri I Kryeministrit nr. 36, datë 16.05.2016 që miraton strukturën organizative të ISHMT
12.4	Hartimi dhe miratimi i Urdhrit të Ministrit për Procedurat Standarde Operacionale të Mbikëqyrjes së Tregut.	MEF	Deri në v. 2015	Urdhri I Ministrit nr. 305, datë 30.05.2014 "Për procedurat standarte operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes".
13	Ulja me 10% cdo vit e shkallës së moskonformiteteve të produkteve në treg.			
13.1	Trainimi i inspektorëve për metodologjinë e vlerësimit të riskut, procedurat standarde të operimit, legjislacionit të vecantë teknik sipas grup produkteve përkatëse, etj	ISHMT	2017	Gjatë vitit 2017 janë kryer 11 trajnime ku kanë marrë pjesë 42 inspektorë. Trajnimet kanë konsistuar në rritjen e shkallës së njohurive të inspektorëve mbi legjislacionin dhe procedurën e inspektimit, inspektimit online, legjislacionin dhe rregullat teknike sipas grup produkteve, mbi deklaratën e konformitetit si dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit për produktet lodra, mbi pajisjet elektrike e elektronike, pronësinë intelektuale, etj. Gjatë periudhës janar-qershor 2018 janë kryer 5 trajnime të mbështetur nga GIZ, Projekti Quality Infrastructure in the Western Balkans dhe Instituti Gjerman i Metrologjisë ku kanë marrë pjesë inspektorët nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Produkteve, që kanë qenë të fokusuar për fushat inspektimi dhe grup produktesh specifike.
13.2	Kryerja e aktiviteteve mbikëqyrese bazuar në vlerësimin e riskut dhe rritja me 20% e numrit të kontrolleve rastësore për produktet ku informacioni i përgjithshëm nuk është i plotë.	ISHMT	2017	Nga ana e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve (DMP) për vitin 2017 janë kryer 61 inspektime ku janë kontrolluar 607 produkte (lodra, parapaketim, instrumenta matës) nga të cilat 248 kanë qenë jo në konformitet. Janë vendosur 4 masa urgjente (bllokim malli, shkatërrim, tërheqje nga tregu), 8 masa administrative gjore dhe 3 masa korrigjuese. Për 6-mujorin e I-rë 2018 nga DMP janë kryer 487 inspektime (lodra, detergjentë, parapaketim, instrumenta matës) ku janë kontrolluar 1177 produkte nga të cilat 155 kanë qenë jo në konformitet. Janë vendosur 43 masa administrative nga të cilat 9 masa urgjente, 34 gjore
14	Ulja me 3% e moskonformiteteve të naftes, gazit dhe nënprodukteve të tyre ndaj kërkesave ligjore lidhur me treguesit cilesorë			

14.1	Rritja me 10% e kontrolleve të ushtruara në subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre	ING	Deri në v. 2015	<ul style="list-style-type: none"> • Është organizuar një grup kontrolli i përbashkët me pjesëmarrjen e inspektoreve të ISHTI dhe specialisteve të strukturës administrative përgjegjëse në MEI, mbështetur në urdhrin e ministrit nr 153 datë 09.05.2016. Janë kryer 91 kontrolle në subjektet kryesore që përdorin pajisje impiante dhe instalime nën presion. • Është rritur numri i kontrolleve të ushtruara nga ana e ISHTI në subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.
14.2	Fuqizimi i kapaciteteve teknike të inspektorëve	ING	Deri në v. 2015	Nuk ka informacion
14.3	Mirëmbajtja e akreditimit të laboratorit të naftës pranë IQT	ING	Deri në v. 2015	Laboratori I naftës në ISHTI është akredituar për 87 lloj analizash në 20.6.2016
15	Garantimi i sigurisë së ashensorëve në shërbim/ përdorim			
15.1	Intensifikimi i aktiviteteve mbikëqyrëse nga Inspektorati për fushën e sigurisë së ashensorëve për arritjen e regjistrimit të tyre dhe kryerjes së inspektimeve periodike	ISHMT	2016-2020	ISHMT edhe pse me kapacitete të pamjaftueshme njerëzore, në lidhje me sigurinë e ashensorëve ka punuar për ngritjen e një regjistri të ashensorëve që janë të instaluar dhe funksionalë në të gjithë territorin e vendit. Në këtë drejtim është kërkuar informacion nga të gjitha NJQV mbi ashensorët e instaluar në ndërtesa në bashkëpronësi ose në ambiente shtëpiake dhe nga të gjitha institucionet shtetërore dhe private informacion mbi ashensorët e instaluar në vende pune. Është përpiluar dhe miratuar Formulari i regjistrimit të ashensorit i cili gjendet edhe në web-site e ISHMT-së. Për plotësimin e Formularit të regjistrimit janë organizuar takime me administratorët e konfirmuar të banesave si dhe me përfaqësues të institucioneve private për njohjen e tyre mbi detyrimet që i ngarkon legjislacioni në fuqi mbi sigurinë e ashensorëve. Gjithashtu në web-site e ISHMT është pasqyruar gjithë informacioni i nevojshëm që duhet të kenë personat përgjegjës për ashensorët.
15.2	Organizimi i nje fushate ndërgjegjësimi për konsumatorët dhe sipërmarrësit për detyrimet lidhur me sigurinë e ashensorëve në përdorim	ISHMT	2016-2020	Në vitin 2017 në kuadrin e projektit të GIZ “Harmonization of Economic and Trade legislation with EU acquis” dhe në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës u trajnuan mbi çështje të sigurisë së ashensorëve rreth 50 administratorë të ndërtesave në Tiranë dhe rreth 70 anëtarë të Task Forcës së ngritur nga Bashkia e Tiranës për zbatimin e ligjit për administrimin e ambienteve të përbashkëta. Ndër të tjera, sesionet e trajnimit u fokusuan në rolin dhe përgjegjësitë ligjore të administratorëve për të kryer mirëmbajtjen dhe kolaudimin periodik të ashensorëve. Gjithashtu në kuadrin e këtij projekti janë botuar rreth 200 fletëpalosje mbi sigurinë e ashensorëve për informimin e konsumatorëve dhe personave përgjegjëse për ashensorët.
16	Ulja në 6% në vit e bombolave të gazit në përdorim, që janë të pakontrolluara (inspektimi periodik)			
16.1	Organizimi i nje fushate ndërgjegjësimi për konsumatorët dhe sipërmarrësit për detyrimet lidhur me sigurinë e ashensorëve në përdorim	ING	2016-2020	Është realizuar edhe nje fushate ndërgjegjësuese kundrejt subjekteve lidhur me rritjen e sigurisë së pajisjeve në presion.
16.2	Evidentimi, regjistrimi dhe gjurmimi nga Inspektorati Përgjegjës për pajisjet nën presion, i të gjitha bombolave të gazit që janë për përdorim familjar.	ING	2016-2020	Proçedohet me evidentimin, regjistrimin dhe gjurmimin nga ISHTI të pajisjeve nën presion. Kjo do të thotë që nuk ka një regjistër të bombolave të gazit

16.3	Ushtrimi i kontrolleve në gjithë pikat e tregimit të bombolave të gazit	ING	2016-2020	<ul style="list-style-type: none"> • Është organizuar një grup kontrolli i përbashkët me pjesëmarrjen e inspektorëve të ISHTI dhe specialistëve të strukturës administrative përgjegjëse në MEI, mbështetur në Urdhrin e Ministrit nr. 153, datë 09.05.2016. Janë kryer 91 kontrolle në subjektet kryesore që përdorin pajisje impiante dhe instalime nën presion. • Është rritur numri i kontrolleve të ushtruara nga ana e ISHTI në subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre. • Janë marrë masa dhe po procedohet për evidentimin, regjistrimin dhe gjurmimin nga ISHTI për të gjitha pajisjet nën presion, bombolat e gazit që janë për përdorim familjar e të ngjashëm. Gjithashtu me anë të kontrolleve të subjekteve të tregimit të bombolave të rimbushjes me gaz është realizuar dhe po vazhdon puna për ndërgjegjësimin kundrejt subjekteve lidhur me rritjen e sigurisë së këtyre pajisjeve dhe ndërmarrjen e sanksioneve përkatëse.
16.4	Ndërgjegjësimi i subjekteve të tregimit të bombolave të rimbushjes me gaz	ING	2016-2020	
17	Ulja me 4% e moskonformiteteve të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre ndaj kërkesave ligjore lidhur me treguesit cilësorë			
17.1	Rritja me 12% e kontrolleve të ushtruara në subjektet e tregimit me shumicë dhe pakicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre	ING	2016-2020	
17.2	Fuqizimi i kapaciteteve teknike të inspektorëve	ING	2016-2020	
17.3	Mirëmbajtja e akreditimit të laboratorit të naftës pranë IQT	ING	2016-2020	
18	Eliminimi i rasteve të aksidenteve nga goditjet e rrymës elektrike të tensionit të ulët			
18.1	Realizimi i projektit për përfshirjen e reles diferencialo termike në instalimet elektrike në banesat familjare.	ING	2017	
18.2	Organizimi i një fushate të gjerë ndërgjegjësimi për konsumatorët për rëndësinë e kësaj mase sigurie	ING	2017	
19	Përmirësimi i sigurisë së barnave për përdorim njerezor dhe sigurisë së paisjeve mjekësore			
19.1	Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Paisjeve Mjekësore	MSH	Deri në v. 2015	Struktura e AKBPM është miratuar me VKM Nr. 24 dt. 14.1.2015 dhe është funksionale http://ew.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/33-2015.pdf . http://ew.akbpm.gov.al/
19.2	Hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri për barnat	MSH	Deri në v. 2015	Miratuar: LIGJ nr. 105/2014 Për Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik . Gjithashtu është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Rregullorja e re në bazë të së cilës do të funksionojë tregtimi i barnave në shërbimin farmaceutik.

19.3	Hartimi dhe miratimi i Rregullores së inspektimit	MSH	Deri në v. 2015	Miratar: Urdher nr. 321, datë 31.07.2015 të Ministrit të Shëndetësisë "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor"
19.4	Hartimi i aktit nënligjor për rritjen e kontrollit dhe monitorimit të rrjetit farmaceutik	MSH	Deri në v. 2015	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 8.4.2015 Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë
19.5	Hartimi dhe miratimi i Rregullores "Mbi mënyrën e raportimit, mbledhjes dhe vlerësimit të efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barnave"	MSH	Deri në v. 2015	Në procedurë miratimi draft-rregullorja e Farmakovigjilencës (2018)
19.6	Krijimi i nje harte të plotë të rrjetit të farmacive, importuesve dhe distributorëve	MSH	Deri në v. 2015	Nuk është realizuar
19.7	Finalizimi i procesit të shqyrtimit dhe miratimit të fletëudhëzuesve të barnave në gjuhën shqipe	MSH	Deri në v. 2015	Pjesë e ndryshimeve të propozuara, në VKM nr. 299, datë 08.04.2015 "Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në RSH"- 2018
19.8	Informatizimi i rrjetit farmaceutik dhe krijimi i një baze të dhënash kombëtare	MSH	Deri në v. 2015	Data base i Sektorit të Inspektimit me të dhënat e detajuara të subjekteve farmaceutike, në respektim të udhëzimeve dhe rregullave të miratuara Inspektorati Qendror
19.9	Fillimi i procesit të akreditimit të Laboratorit shtetëror të kontrollit të barnave	MSH	Deri në v. 2015	Në proces, pas përfundimit të rikonstruksionit dhe shtesë godine të Agjencisë ku është përfshirë dhe ngritja e Laboratorit të Kontrollit të Barnave (në përputhje me standardet e kërkuara, për vitet 2018-2020, që paraprin procesin e akreditimit).
19.10	Organizimi i fushatave sensibilizuese për profesionistët e shëndetit dhe përdoruesit e barnave	MSH	Deri në v. 2015	Konferenca me titull "Farmakovigjilencia dhe Siguria e Barnave" organizuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në bashkëpunim me Departamentin e Farmacisë Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë dhe Urdhërin e Farmacistëve të Shqipërisë, në datat 29 Qershor dhe 6 Korrik 2018
20	Përmiresimi i sigurisë së produkteve kozmetike.			
20.1	Adoptimi i legjislacionit për kozmetiken	MSH	2016-2020	Aprovuar Ligj nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike" https://ew.parlament.al/akt/ligj-nr-262017-per-produktet-kozmetike/
20.2	Krijimi i strukturës për kontrollin e tregut për produktet kozmetike	MSH	2016-2020	Në bazë të ligjit nr. 26/2017 "Për produktet kozmetike" neni 20, "Mbikqyrja dhe kontrolli" Inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë, është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatueshmërisë së këtij ligji dhe akteve ligjore , të dala në zbatim të tij.
21	Ulja e moskonformiteteve të barnave të tregtuara cdo vit me 10% në krahasim me vitin paraardhës			
21.1	Monitorimi i tregut për barnat lidhur me respektimin e kërkesave përkatëse ligjore	MSH	2016-2020	Kryerja e inspektimeve online nga inspektorët e Sektorit të Inspektimit (implementimi i programit "e-Inspektimi" nga Korriku i vitit 2017 e në vijim).

21.2	Akreditimi dhe mirëmbajtja e akreditimit për laboratorin shtetëror të kontrollit të barnave	MSH	2016-2020	Në proces, pas përfundimit të rikonstruksionit dhe shtesë godine të Agjencisë ku është përfshirë dhe ngritja e Laboratorit të Kontrollit të Barnave (në përputhje me standardet e kërkuara, për vitet 2018-2020, që paraprin procesin e akreditimit).
21.3	Mirëmbajtja Informatizimi i rrjetit farmaceutik dhe krijimi i një baze të dhënash kombëtare	MSH	2016-2020	Data base i Sektorit të Inspektimit me të dhënat e detajuara të subjekteve farmaceutike, në respektim të udhëzimeve dhe rregullave të miratuara Inspektorati Qendror
21.4	Futja e sistemit track and trace - krijimi i sistemit të informacionit të ndjekjes së barit (kur hyn si produkt deri tek pacienti)	MSH	2016-2020	Kryerja e inspektimeve online nga inspektorët e Sektorit të Inspektimit (implementimi i programit "e-Inspektimi" nga Korriku i vitit 2017 e në vijim).
22	Përmirësimi i sigurisë së pajisjeve mjekësore.			
22.1	Finalizimi i sistemit lidhur me pajisjet mjekësore që aktualisht janë jashtë kontrollit;		2017	
23	Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombetare si standarde shqiptare			
23.1	Adoptimi si standarde shqiptare i 3400 standardeve evropiane të publikuara nga CEN, CENELEC dhe ETSI	DPA/MEF	2017	Parashikimi për adoptimin e 2.700 evropiane të publikuara nga CEN, CENELEC dhe ETSI është realizuar në masën 127% deri në periudhën e raportimit (Gusht 2017). Janë adoptuar 3.436 st. shqiptare në total, gjatë periudhës Janar 2016 - Gusht 2017, nga të cilat: 2.627 janë st. shqiptare të adoptuara nga CEN dhe CENELEC; dhe 809 st. shqiptare të adoptuara nga ETSI.
23.2	Adoptimi si standarde shqiptare i 900 standardeve ndërkombetare të publikuara nga IEC dhe ISO	DPA/MEF	2017	Parashikimi për adoptimin e 900 standardeve ndërkombetare është realizuar në masën 128% deri në periudhën e raportimit (Gusht 2017). Janë adoptuar 1.154 st. shqiptarë të publikuara nga ISO dhe IEC gjatë periudhës Janar 2016 - Gusht 2017.
24	Adoptimi 100% i Standardeve CEN/CENELEC, ETSI dhe 40% e totalit të standardeve IEC dhe ISO dhe plotësimi i kushteve teknike për anëtarësim me të drejta të plota të DPS-së, në CEN&CENELEC			
24.1	6900 standardeve evropiane e ndërkombetare të publikuara nga CEN, CENELEC, ETSI dhe ISO e IEC	DPS/MEF	2016-2020	Janë adoptuar gjithsej deri në periudhën e raportimit (Gusht 2017) 4.590 standarde evropiane e ndërkombetare të publikuara nga CEN, CENELEC, ETSI dhe ISO e IEC si shqiptare. E shprehur në përqindje është: 98% të totalit të st. evropiane të publikuara nga CEN&CENELEC; 75% të totalit të st. evropiane të publikuara nga ETSI; 25% të totalit të st. ndërkombetare të publikuara nga ISO; 21% të totalit të st. ndërkombetare të publikuara nga IEC.
24.2	Ndryshimi i legjislacionit dhe procedurave të punës së DPS në varësi të ndryshimeve në legjislacionin dhe rregulloret evropiane në këtë fushë	DPS/MEF	2016-2020	Gjatë 2016 është përgatitur (brenda afatit të parashikuar) dhe dërguar për miratim në Keshillin e Ministrave projektvendimi "Për Veprimtarinë e Standardizimit", i cili transponon Rregulloren e BE 1025/2012 "Për Standardizimin Evropian". Gjithashtu, janë rishikuar dhe miratuar nga Bordi Drejtues i DPS 9 Rregullore të Brendshme të DPS, të cilat janë në përputhje të plotë me rregulloret e CEN&CENELEC dhe ndryshimet e tyre.

24.3	Anëtaresimi në Njesinë Ndërkombetare të Telekomunikacionit (ITU) dhe fillimi i adoptimit të standardeve ndërkombetare në fushën e telekomunikacionit (në varësi të anëtaresimit të DPS ne ITU).	DPS/MEF	2016-2020	Baza ligjore për adoptimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e telekomunikacionit është e plotë. DPS do të komunikojë me Njesinë Ndërkombëtare të Telekomunikacionit (ITU) për të parë procedurat/kriteret e anëtaresimit dhe fee e anëtaresimit.
24.4	Aplikimi për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC	DPS/MEF	2016-2020	Baza ligjore, rregulloret e brendshme dhe gjithë procedurat e punës për organizimin dhe funksionimin e sistemit të standardizimit në Shqipëri janë në përputhje të plotë me kriteret dhe rregulloret e CEN&CENELEC. Në prill 2017 u firmos Marrëveshja midis DPS dhe CEN e CENELEC, për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet DPS dhe dy organizmave europiane të standardizimit, si dhe vazhdimi i plotësimit të të drejtave dhe detyrimeve të DPS si anëtare në këto organizma. Miratimi i projektvendimit "Për Veprimtarinë e Standardizimit" është një akt ligjor shumë i rëndësishëm që i shërben plotësimit të kriteve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN&CENELEC.
25	Rritja çdo vit me 2 % e numrit të standardeve të shitura dhe përdorura nga operatorët			
25.1	Shitja e rreth 4160 standardeve shqiptare	DPS/MEF	Deri në v. 2015	Janë shitur gjithsej 5.639 standarde shqiptare - periudha Janar 2013 - Dhjetor 2015.
25.2	40 standarde të perkthyer (te fushes se ndertimit)	DPS/MEF	Deri në v. 2015	Janë adoptuar me perkthim të plotë 24 standardet shqiptare të Eurocodeve nr. 4, 6, 7, dhe 8. Këto standarde i perkasin fushës së ndërtimit.
25.3	Përkthimi në gjuhën shqipe i 120 standardeve të fushave prioritare të ekonomisë.	DPS/MEF	2017	Në PBA 2017 është kërkuar fond shtesë (2.000.000 leke) me qëllim fillimin e procedurave për përkthimin e standardeve më të kerkuara nga biznesi dhe ato për vleresimin e konformitetit.
25.4	Shitja e rreth 10.000 standardeve shqiptare.	DPS/MEF	2017	
25.5	Organizimi i fushatave ndërgjegjëse për operatorët ekonomike dhe konsumatorët për rëndësinë e standardeve në produktet dhe shërbimet e ofruara në treg	DPS/MEF	2015-2020	Të gjitha standardet puro shqiptare në fuqi, ato të adoptuara si dhe standardet e shfuqizuara gjenden në Katalogun e Standardeve Shqiptare, që publikohet çdo vit. Katalogu gjendet online në faqen e internetit të DPS, ew.dps.gov.al , në format letër dhe elektronik me CD. Gjatë periudhës 2015-Gusht 2017 janë shpërndarë mbi 700 Kataloge (në format letër dhe me CD); janë publikuar 13 Buletine Informative të Standardeve (4 Buletine çdo vit), të cilët i janë shpërndarë, kryesisht elektronikisht, kompanive të biznesit, dhomave dhe shoqatave të tregtisë, universiteve, ministrive, institucioneve të infrastrukturës së cilesisë. Janë dhënë 7 trajnime mbi standardet dhe rolin e tyre tek kompanitë private dhe tek fak. inxhinierisë informatike, bujqësore, mekanike, etj. janë organizuar aktivitete promovuese dhe sensibilizuese çdo vit në ditën botërore të standardeve, ku pjesëmarrja ka qenë e konsiderueshme; janë publikuar rreth 90 artikuj promovues dhe mbi 200 ekstrakte të fushave për standarde me interes për biznesin dhe ekonominë; komunikimet nëpërmjet faqes së internetit dhe mediave sociale të DPS kanë qenë aktive, të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar online në ew.dps.gov.al përfshirë këtu edhe takimet dhe dokumentat e miratuara nga Bordi Drejtues, rregulloret, buletinet, Katalogu i Standardeve Shqiptare, njoftime në Sekretariatit e ISO / IEC dhe CEFTA, artikuj të ndryshëm promovues, takimet me student dhe palë të interesuara, standardi më i ri i publikuar nga DPS, dialog me palët e interesuara. Si rezultat, numri i klikimeve për publikimet në mediat sociale: DPS facebook DPS Google + dhe DPS LinkedIn është rritur ndjeshëm krahasuar me vitet e kaluara, si dhe kërkesat për të marrë pjesë në punën teknike për adoptimin e standardeve, nëpërmjet Komiteteve Teknike të DPS, është rritur gjatë kësaj periudhe.

26	Njohja e raporteve të testimit të laboratorëve testues të akredituar shqiptar në BE			
26.1	<p>Miratimi i ligjit të ri “Për Akreditimin e Organizmave të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” për të qënë plotësisht i hamonizuar me Rregulloren Europiane nr.765/2008 “Kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut”.</p> <p>Kompletimi me akte nënligjore për aspektet e procedurave të akreditimit.</p>	DPA/MEF	Deri në v.2015	<p>Në datën 11 Shtator 2014 është miratuar ligji “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” . Në datën 29.07.2015 është miratuar VKM nr. 667 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”. Në datën 9.9.2015 u miratuan Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 737 “Për tarifën e akreditimit dhe të trajnimeve që zhvillohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.” dhe VKM nr. 738 “Për mënyrën e pagesës së anëtarëve të Bordit të Akreditimit dhe të Grupeve Teknike të Punës”.</p> <p>Në datën 27.07.2015, Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes ka miratuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Urdhëri nr. 3643/1 ”Rregullorja e bordit të akreditimit” - Urdhëri nr. 3643/2 “Rregullorja e grupeve teknike të punës” - Urdhëri nr. 3643/3 “Procedura e trajtimit të ankesave dhe apeliemeve”. <p>Në datën 18.07.2017 me urdhërin nr. 5199/1, Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes ka miratuar disa ndryshime në Urdhërin nr. 3643/1, datë 27.07.2015: “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”.</p> <p>Ne këtë mënyrë, i gjithë kuadri ligjor i nevojshëm për fushën e akreditimit është miratuar dhe është në përputhje të plotë me Rregulloren Europiane nr. 765/2008 “Kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut”.</p>
26.2	<p>Rishikimi i të gjithë dokumentacionit të sistemit të menaxhimit të DPA-së, për arritjen e përputhjes me dokumentat e reja europiane ndërkombëtare, si dhe përmbushjen e gjetjeve të grupit të paravlerësimit të EA dhe përgatitja për kalimin me sukses të vizitës së radhës.</p>	DPA/MEF	Deri në v.2015	<p>I gjithë dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të DPA është rishikuar në përputhje me kërkesat e Rregullores Evropiane nr. 765/2008 dhe të standardit S SH ISO/IEC 17011:2004. I gjithë dokumentacioni i rishikuar është përkthyer dhe i është dërguar EA për organizimin e vizitës vlerësuese</p>
26.3	<p>Përgatitja e të gjithë dokumentacionit e nevojshëm për harmonizimin e procedurave të akreditimit dhe praktikave europiane në fushën e certifikimit dhe inspektimit.</p>	DPA/MEF	Deri në v.2015	<p>I gjithë dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të DPA për fushën e certifikimit dhe inspektimit është rishikuar në përputhje me kërkesat e Rregullores Evropiane nr. 765/2008, standardit S SH ISO/IEC 17011:2004 dhe standardeve të akreditimit.</p>

26.4	Arrija e nënshkrimit të marrëveshjes së njohjes reciproke me EA në fushën e testimit të laboratorëve testuesë) ofrimi me cilësi i shërbimit të akreditimit tek të gjitha OVK duke respektuar parimet dhe standardet e akreditimit.	DPA/MEF	Deri në v.2015	<p>1. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës Evropiane për Akreditim – EA, të zhvilluar në Budapest Hungari, në datë 25- 26 Nëntor 2015, u zhvillua dhe ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes të Njohjes Reciproke. Vendimi për pranimin e DPA si nënshkruese e marrëveshjeve të njohjes reciproke, në fushën e laboratorëve testues u morr në datë 2 Tetor 2015 në mbledhjen e Komitetit të Njohjeve Reciproke të Organizatës Evropiane për Akreditim, EA - MAC.</p> <p>2. DPA u pranua në Maj të 2015 anëtare me të drejta të plota në Organizatën Evropiane për Akreditim . Anëtarësimi me drejta të plota në EA, është jo vetëm plotësim i kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit në fushën e akreditimit, por edhe dhënia e së drejtës së DPA për të marrë pjesë në vendimet e Organizatës Evropiane për Akreditim duke shprehur dhe mbrojtur interesat e Qeverisë dhe biznesit Shqiptarë.</p> <p>3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit gëzon statusin e anëtarit me të drejta të plota në Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF) dhe anëtarit shok në Organizatën Ndërkombëtare të Akreditimit të Laboratorëve (ILAC).</p> <p>4. Në fund të vitit 2016 janë rregjistruar 63 OVK të akredituara dhe përkatësisht 28 laboratorë testues, 3 kalibrues, 4 mjekësorë, 3 organe certifikuese të personelit, 3 të sisteme të menaxhimit dhe 12 organe inspektuese. Gjatë 2016 janë akredituar dhe riakredituar 27 OVK nga të cilat 18 laboratorë testues, 2 laboratorë kalibrues, 3 laboratorë mjekësorë dhe 4 organe inspektuese. Gjatë 2016 janë rregjistruar 17 aplikime të reja dhe 11 aplikime për zgjerim të akreditimit. Janë kryer vizitat mbikëqyrëse sipas planit tek të gjitha OVK e akredituara (45 vizita). Është pezulluar akreditimi për 3 OVK . Gjatë 2016, Drejtoria e Akreditimit ka kryer 123 aktivitete në lidhje me akreditimin.</p>
26.5	Ndërgjegjësimi në lidhje me akreditimin të konsumatorëve, organizatave të mbrojtjes së konsumatorëve, institucioneve vendimarrëse, operatorëve ekonomik për rolin e akreditimit	DPA/MEF	Deri në v.2015	Drejtoria e Zhvillimit në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes zhvilloi në muajin Shkurt 2017 aktivitetin promovues me temë “Akreditimi- përfitim për biznesin, garanci për konsumatorin” . Në aktivitet morën 100 pjesëmarrës.
26.6	Rikonfirmimi i EA-MLA në fushën e testimit	DPA/MEF	2016-2020	Vlerësimi i EA është kryer në Prill 2017. Pritet konfirmimi në Prill 2018
26.7	Aplikimi në EA për firmosjen e EA-MLA dhe për fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit	DPA/MEF	Deri në v.2016	DPA ka aplikuar për firmosjen e EA-MLA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit në Korrik 2015. Ky aplikim është pranuar dhe EA ka kryer vlerësimin e këtij aplikimi në datën 10-14 Prill 2017
26.8	Rritja e numrit të aplikimeve për akreditim duke përfshirë edhe laboratorët mjekësorë	DPA/MEF	Deri në v.2016	Numri i aplikimeve për akreditim nga laboratorët mjekësorë është rritur. Në fund të vitit 2016, DPA kishte akredituar 4 laboratorë mjekësorë nga 1, i akredituar në 2015. Për periudhën Janar-Gusht 2017, 4 laboratorë mjekësorë kanë aplikuar për akreditim.
26.9	Realizimi i vlerësimit nga EA për trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit	DPA/MEF	2017	Vlerësimi i EA për EA-MLA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit është realizuar në periudhën 10-14 Prill 2017.
26.10	Përmiresimi i skemave të akreditimit dhe i legjislacionit në fushën e akreditimit në përputhje me rregulloret dhe dokumentat evropianë	DPA/MEF	2017	Skemat e akreditimit që DPA ofron janë në përputhje me kërkesat e Rregullores Evropiane 765/2008 dhe standardit S SH ISO/IEC 17011. Kjo është vërtetuar edhe nga vlerësimi i fundit i EA (Prill 2017).

26.11	Njohja e certifikatave të lëshuara nga DPA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit	DPA/MEF	2018	Pritet që njohja e certifikatave të lëshuara nga DPA në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit të realizohet në Prill 2018
26.12	Ofrimi i akreditimit nga DPA për trupat inspektues të pajisjeve elektrike	DPA/MEF	2018	DPA ka filluar ofrimin e skemës së akreditimit për trupa inspektuese të pajisjeve elektrike dhe aktualisht janë akredituar dy organizma.
26.13	Përgatitja e dokumentacionit për arritjen e njohjes reciproke në fushe e akreditimit të trupave inspektues	DPA/MEF	2018	DPA ka aplikuar për firmosjen e EA-MLA në fushën e inspektimit në Korrik 2015. Ky aplikim është pranuar dhe EA ka kryer vlerësimin e këtij aplikimi në datën 10-14 Prill 2017
26.14	Aplikimi për nënshkrimin e EA_MLA-së për fushën e inspektimit (2019)	DPA/MEF	2019	DPA ka aplikuar për firmosjen e EA-MLA në fushën e inspektimit në Korrik 2015.
26.15	Pranimi i certifikatave të lëshuara nga DPA për fushën e inspektimit (2020)	DPA/MEF	2020	Pritet që njohja e certifikatave të lëshuara nga DPA në fushën e inspektimit të realizohet në Prill 2018.
26.16	Anëtarësimi në EA me drejta të plota (2020)	DPA/MEF	2020	Që nga Maji 2015, DPA është anëtare me drejta të plota në EA.
27	Fushata ndërgjegjësuere per operatorët ekonomikë dhe organizatat e mbrojtjes së konsumatorëve për rolin e akreditimit në cilësinë e jetës, sigurinë e produkteve të konsumit në treg dhe rritjen e konkurrencës dhe shkëmbimeve tregtare (2014-2020)	DPA/MEF	2016-2020	Në 3 Shkurt 2017 realizoi një aktiviteti promovues me temë “Akreditimi- përfitim për biznesin, garanci për konsumatorin” në të cilin morën pjesë përfaqësues nga biznesi dhe nga konsumatori. Në aktivitet morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës.
28	Përmirësimi i legjislacionit në fushën e metrologjisë në përputhje me direktivat evropiane			
28.1	Rishikimi i Ligjit nr. 9875, datë 14/02/2008 “Për metrologjinë”	DPM/MEF	Deri në v.2015	Miraturar në datën 23.09.2015 ligji nr.100/2015 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9875, datë 14.2.2008 "Për Metrologjinë", i ndryshuar.
28.2	Hartimi dhe miratimi i VKM-se “Per etalonet kombetare”	DPM/MEF	Deri në v.2015	VKM nr. 1052, datë 23.12.2015 "Për deklarimin e etaloneve kombëtare të matjeve dhe mbajtjesit e tyre"
29	Njohja ndërkombëtare e shërbimeve të DPM-së në fushën e forcës dhe presionit dhe përgatitja për zgjerimin e njohjes edhe në 5 fusha të tjera			
29.1	Akreditim i 7 laboratoreve (masë, forcë, presion, volum, elektrik, temperaturë, gjatësi), zgjerim i objektit të akreditimit në fushën e masës, forcës.	DPM/MEF	Deri në v.2015	DPM ka implementuar sistemin e menaxhimit të cilësisë në përputhje me S SH ISO/IEC 17025:2006 “Kërkesa të Përgjithshme për Kompetencën e Laboratoreve Testues dhe Kalibrues”. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është ngritur në labororet e kalibrimit të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale. Pas nje procesi të gjatë pune dhe përkushtimi të specialisteve të laboratoreve, u be i mundur akreditimi i katër laboratorëve : 1. Laboratori i Masës; 2. Laboratori i Forcës; 3. Laboratori i Presionit; 4. Laboratori i Volumeve. Akreditimi u mundësua nga Trupa Shqiptare e Akreditimit DPA. Për të vlerësuar kompetencen teknike të laboratoreve, DPA angazhoi eksperte të jashtëm nga trupe akreditimi nënshkruese e EA MLA. Çertifikata e akreditimit u lëshua në datë 16.09.2016.

29.2	Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe në dy laboratore të tjerë nga EURAMET (forcë dhe presion)	DPM/MEF	Deri në v.2015	Jane akredituar 4 laboratore (volum, masë, presion dhe forcë) në 16.09.2016, përkateisht me certifikatën nr. LK003 të Drejtorisë të Përgjithshme të Akreditimit.
29.3	Deklarimi në databasë të BIPM-së të 2 fushave (Forcë dhe presion)	DPM/MEF	Deri në v.2015	Është në proces njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorin e forcës dhe presionit (është realizuar pjesmarrja në ndërkrahime laboratorike për të dyja fushat)
29.4	Zgjerimi i bazës etalonuese të laboratoreve elektrik (automatizimi i matjeve të tensionit të vazhduar), forcës,volumeve-rrjedhjeve (instrument matës për kalibrim rezervuaresh) dhe ngritja e laboratorëve: të kohë-frekuencës, të kontrollit të zhurmave dhe të kontrollit të instrumentave matës në fushën e shëndetësisë.	DPM/MEF	Deri në v.2015	Nuk është realizuar
29.5	Realizimi i 3280 kalibrimeve (viti 2014-2015) në fushën e masës, forcës, volum, rrjedhjeve,gjatësi, presion, temperaturë, matje elektrike,lageshtësie.	DPM/MEF	Deri në v.2015	Janë realizuar tenderime me fondet buxhetore me objekt: 1- "Blerje instrument matës" në Qershor 2014. 2- "Kompletimi I laboratoreve të volumeve" në Qershor te 2014. 3- "Blerje regj forcës së tërheqjes" Shtator 2014. 4- "Transferim, montim dhe kalibrim pajisje mase" në Gusht të 2014. 5- "Blerje Kontalibri" në Prill të 2015. 6- "Blerje lazer skaner" në Shkurt të 2015. 7- Blerje instrument matës PH&konduktiviteti", në shkurt të 2015. 8-"Blerje instrument matës ultrasonic" në Korrik të 2015. 9- "Blerje pajisje elektrike për laboratorin e madhësive elektrike" në Korrik të 2015. 10- "Blerje Etalone masë" në Korrik të 2015. 11- "Blerje stabilizator tensioni për makinën etalon 200 KN" në Nëntor 2015. Është realizuar tenderi për ngritjen e laboratorit të Kohë-frekuencës është shpallur fituesi por nuk u paraqit për nënshkrimin e kontratës, në vitin 2016, pas 3 procedurave të zhvilluar nuk ka pasur asnjë operatore.
29.6	Realizimi i 1 620 kalibrimeve në fushat përkatëse	DPM/MEF	Deri ne v.2015	Për vitin 2014 janë realizuar 1973 kalibrime dhe në vitin 2015 janë realizuar 1860 kalibrime.
30	Njohja ndërkombetare e shërbimeve të metrologjisë në fushën e volumeve, termometrisë, lageshtësisë, rrjedhjeve, matjeve elektrike			
30.1	Akreditimi i laboratoreve sipas fushave përkatëse nga trupa akreditues nënshkrues të MLA me EA	DPM/MEF	2016-2020	Është në proces aplikimi nga trupa akredituese maqedonase nënshkruesa e MLA, laboratorin e volumeve.
30.2	Njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë nga EURAMET dhe në dy laboratorin e volumeve dhe termometrisë.	DPM/MEF	2016-2020	Është në proces njohja e sistemit të menaxhimit të cilësisë në laboratorin e volumeve dhe termometrisë (është realizuar pjesmarrja në ndërkrahime laboratorike për laboratorin e volumeve dhe është në proces pjesmarrja e ndërkrahimeve për laboratorin e termometrisë).
30.3	Deklarimi në data base të BIPM të 10 fushave	DPM/MEF	2016-2020	Ka deklaruar në fushën e masës, në proces fusha e presionit dhe volumeve.

30.4	Zgjerimi i bazës etalonuese të laboratorit të masës, elektrikut, rrjedhjeve, optikës, përdredhjeve, gjatësisë dhe presionit, si dhe DML-së dhe DIM me instrumenta dhe autolaboratore verifikimi. 7 fushave matjeje	DPM/MEF	2016-2020	Janë realizuar tenderime me fondet buxhetore me objekt: 1- "Blerje Autolaboratore për parapaketimet" në Nëntor të 2016. 2- "Blerje pajisje për laboratorin e masës & elektrikut" në Nëntor të 2016.3- "Blerje kalibratore për kalibrimin e aparatit matës të forcës DMP 40" në gusht të 2017.
30.5	10750 kalibrime në fushën e masës, forcës, volumit, gjatësisë, presionit, temperaturës, matjeve elektrike, lagështirës, kohë frekuence, densitetit.	DPM/MEF	2016-2020	Për vitin 2016 janë realizuar 1880 kalibrime dhe për periudhën Janar - Korrik 2017 janë realizuar 790 kalibrime
31	Rritja e shkallës së mbrojtjes së konsumatorëve nga matjet e pasakta nëpërmjet rritjes me 2 % për çdo vit të numrit të verifikimeve dhe inspektimeve të instrumenteve matës në treg dhe në përdorim;			
31.1	Kryerja e verifikimeve periodike e instrumenteve matës në përdorim në masën 10 % më shumë se viti paraardhës	DPM/MEF	2017	Janar - Korrik 2017 janë kryer verifikime periodike për 26 495 instrumenta matës në përdorim.
31.2	Përfshirja në skemën e kontrollit metrologjik ligjor të dy instrumentave matës në fushën e mjeksisë.	DPM/MEF	2017	Nuk është realizuar përfshirja në skemën e kontrollit metrologjik ligjor të dy instrumentave matës në fushën e mjeksisë.
31.3	Rritja e numrit të inspektimeve të instrumentave matës në masën 10% dhe ulja e jo konformiteteve të parapaketimeve në masën 8% në krahasim me vitin paraardhës	ISHMT	2017	Inspektimi Metrologjik nuk është pjesë e strukturës së DPM-së që prej datës 16.05.2016, miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 85.
32	Realizimi i gjurmueshmërisë së matjeve në nivelin më të lartë ndërkombëtar			
32.1	Etalone të rikalibruara 7 Laboratoreve në një institucion homolog të EURAMET	DPM/MEF	Deri në v.2015	Janë kalibruar etalonet në Institutin Grek të Metrologjisë (EIM) me objekt "Kalibrim etalone të DPM" në muajin mars 2015.
32.2	Ri-kalibrimi i i etaloneve reference për 10 fusha matje (masë, forcë, presion, volum, elektrik, temperaturë, gjatësi, lagështirë, rrjedhje, kohë frekuence) të laboratoreve të DPM	DPM/MEF	2016-2020	Nuk është realizuar rikalibrimi I etaloneve, është bërë tenderimi në vitin 2016 dhe ka dështuar për mosparaqitje të operatorëve ekonomik. Në vitin 2017 është zhvilluar prokurimi me objekt "Kalibrimi I etaloneve të DPM-se" por ka dështuar pasi operatori ekonomik është skualifikuar për mungesë dokumentacioni.
33	Forcimi i mbrojtjes së konsumatorit në aspektin metrologjik			
33.1	Kryerja e verifikimeve të instrumenteve matës në përdorim (numër verifikimesh - 84 mijë, për vitin 2014-2015	DPM/MEF	Deri në v.2015	Për vitin 2014 -2015 janë kryer verifikime për 91 345 instrumenta matës në përdorim, në masën 108.7% të realizimit

33.2	Kryerja e 11000 mijë inspektimeve për subjektet që përdorin instrumenta matës dhe prodhues, shpërndarës dhe shitje me pakicë e produkteve të parapaketuara	DPM/MEF	Deri në v.2015	Në vitin 2014 janë realizuar 6911, në vitin 2015 janë realizuar 4112 inspektime.
33.3	Zgjerimi i kapaciteteve teknike me autolaboratorë për verifikimin e instrumenteve matës të hidrokarbureve, gazin e lëngshëm dhe produktet e parapaketuar Blerje e autolaboratoreve dhe instrumenta matës.	DPM/MEF	Deri në v.2015	Janë zgjeruar kapacitete teknike me objekt: 1- Blerje autolaboratore LPG për Inspektimin Metrologjik në Qershor të vitit 2014 dhe 2- Blerje Autolaboratore "sistem kontrolli distributori" për Metrologjinë Ligjore në Gusht të vitit 2014.
33.4	Realizimi i 4 fushatave ndërgjegjesuese per biznesin	DPM/MEF	Deri ne v.2015	1- Ne daten 29.10.2014 Drejtorja e Pergjithshme e Metrologjise ne bashkepunim me shoqaten "Konsumatori ne fokus" kane ndermarre nje fushate per ndërgjegjesimin dhe sensibilizimin e konsumatorit mbi Metrologjine. 2.Ne vitin 2014 DPM-ja ne bashkepunim me Shoqaten e Taksive ka ndermarre fushata ndërgjegjesuese ne fushen e hidrokarbureve. 3. Aktivitet ndërgjegjesues me Institutin e Ndertimit ne lidhje me sherbimet qe ofron DPM dhe implementimin e sistemit te menaxhimit te cilesise ne laboratore, ne vitin 2014. 4. Ne daten 18.05.2015, ne ambjentet e laboratoreve te DPM-se eshte realizuar vizit informuese mbi sherbimet e ofruara nga DPM me nxenesit e shkolles se mesme "Hoteleri Turizem". 5. Ne daten 03.11.2016 eshte kryer fushat ndërgjegjesuese me biznesin mbi vendosjen e shenjes se konformitetit "e".
34	Rritja e monitorimit të sistemeve të kontrollit të produkteve të para-paketuara tek prodhuesi/paketuesi dhe në treg, me qëllim uljen e produkteve jo-konformë çdo vit mesatarisht me 2 %			
34.1	Ulja e produkteve të parapaketuara jo konforme në masën 8% në raport me vitin paraardhës	DPM/MEF	2016-2020	Ulja e produkteve të parapaketuara jo konforme I përket Inspektoriatit të Mbikqyrjes së Tregut pasi me Urdhër të Kryeministrit nr. 85, datë 16.05.2016 Inspektimi Metrologjik është shkëputur nga struktura e DPM-së. DPM kryen miratimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve. Në datë 3.8.2016 ka dal Udhëzimi i Ministrit të MZHETTS me nr. 1897/3, për miratimin e rregullores "Për kërkesat dhe procedurat e Miratimit, regjistrimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve me shenje konformiteti". Në Nëntor të 2016 DPM ka realizuar një seminar me disa perfaqësues të prodhuesve të parapaketimeve mbi njohjen e këtij Udhëzimi dhe ndërgjegjësimi për vendosjen e shenjws shqiptare të konformitetit "c" në parapaketimet e tyre. Deri më tani asnjë sistem nuk është miratuar nga DPM.
35	Plotësimi i legjislacionit në mbrojtje të interesave të konsumatorëve dhe zgjidhjeve të ankesave jashtë gjyqesorit			
35.1	Hartimi i VKM "Për kontratat e produkteve të udhëtimeve afatgjata";	MEF	Deri në v.2015	Miratuar me nr. 652, datë 8.10.2014 VKM "Për përcaktimin e rregullave për kontratat e përdorimit me afat, të produktit të pushimit afatgjatë, rishitjes apo shkëmbimit"

35.2	Hartimi i VKM "Për plotësimin e kriterëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit	MEF	Deri në v.2015	Direktiva 2013/11/BE "Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve", e parashikuar për tu transpozuar nëpërmjet VKM "Për kriteret që duhet të përmbushë struktura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësorit", aktualisht është në proces transpozimi nëpërmjet amendimeve të ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve. Është përgatitur projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", Projektligji është dërguar në KM për miratim, në prill 2017.
35.3	Hartimi I VKM për etiketimin e llampave të ndricimit	MEF	Deri në v.2015	U miratua ViKM nr. 942, datë 28.12.2016 Për miratimin e rregullit teknik "Për etiketimin e energjisë së llampave dhe të ndriçuesve elektrikë".
35.4	Hartimi I VKM për etiketimin e kondicionerëve	MEF	Deri në v.2015	U miratua VKM nr. 865, datë 21.10.2015 Për miratimin e rregullit teknik "Për etiketimin e energjisë për kondicionerët e ajrit"
36	Përditësim i legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve duke ndjekur zhvillimet në nivel evropian.			
36.1	Amendimi i ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, duke transpozuar direktivën evropiane mbi të drejtat e konsumatorëve (2011/83), mbi urdhrat e ekzekutimit (2009/22), direktiva e re e paketave të udhëtimit, etj.	MEF	2017	U miratua ligji nr. 71/2018, datë 18.10.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar". Ndryshimet e propozuara synojnë në një funksionim më mirë të tregut të brendshëm, nëpërmjet: Harmonizimit me legjislacionin evropian të fushës së mbrojtjes së konsumatorëve: Projektligji është plotësisht i përputhshëm me Direktivën 2011/83/BE "Për të drejtat e konsumatorit, si dhe pjesërisht i përputhshëm me Direktivën 2013/11/BE "Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve". * Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr. 48, datë 01.07.2015 miratoi rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare". Kjo rregullore shfuqizon rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individual" (miratuar me vendimin nr. 5, datë 11.02.2009). Rregullorja e re ka për qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare, duke përmirësuar kuadrin rregullator në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit, rritjen e konkurrencës në sektorin bankar dhe rritjen e transparencës së produkteve të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare. Kjo rregullore e re harmonizon më tej kuadrin rregullator shqiptar në kuadër të BE-së për mbrojtjen e konsumatorit në sektorin bankar, veçanërisht për dispozitat e Direktivës 2008/48/EC "Për marrëveshjet e kredisë konsumatore" dhe Direktives 2014/17/ EU "Për marrëveshjet e kredisë për konsumatorët kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme rezidenciale"..
36.2	Hartimi i VKM së re në lidhje me paketat e udhëtimit, në zbatim të amendimeve të ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe direktivës përkatëse	MEF	2018	U miratua VKM nr. 65, datë 21.01.2009 "Për kontratat e paketave të udhëtimit". VKM transponon plotësisht Direktivën 90/314/EEC ²⁹ ;
36.3	Amendimet e 2 VKM-vë (kontratat në largësi dhe shitja jashtë qendrave të tregtimit), në zbatim të amendimeve të ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve;	MEF	2019	U miratuan: 1. VKM nr. 63, datë 21.01.2009 "Për kontratat jashtë qendrave të tregtimit". VKM transponon plotësisht Direktivën 85/577/EEC; 2. VKM nr. 64, datë 21.01.2009 "Për kontratat në largësi". VKM transponon plotësisht Direktivën 97/7/EC;

²⁹ Duhet përmendur se ky VKM ka transpozuar direktivën e vjetër në këtë fushë, por për efekt raportimi është raportuar si aktivitet i realizuar

36.4	Hartimi dhe miratimi I Vendimeve te KM lidhur me Etiketimin e energjisë për grupe produktesh me ndikim në konsumin e energjisë, duke ndjekur zhvillimet në nivel europian.	MEF	2016-2020	U miratuan³⁰: 1. VKM nr. 865, datë 21.10.2015 Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë për kondicionerët e ajrit” 2. VKM nr. 942, datë 28.12.2016 Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e energjisë së llambave dhe të ndriçuesve elektrikë”. 3. VKM nr. 928, datë 19.12.2012 Për miratimin e rregullit teknik “Për etiketimin e makinave larëse për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”. 4. VKM nr. 296, datë 3.4.2013 Për miratimin e rregullit teknik “Për informacionin e tharëseve për përdorim shtëpiak në lidhje me konsumin e energjisë”.
36.5	Hartimi i VKM “Për bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve”, duke transpozuar Rregulloren Evropiane së Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Konsumatorëve 2006/2004.	MEF	2019	
36.6	Plotësimi i legjislacionit që ndikon në uljen e leshimit të CO2 në mjedis nëpërmjet transpozimit të tre Direktivave	MTI	2016-2020	
37	Fuqizim i efektivitetit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK), nëpërmjet analizimit 100% të ankesave dhe shqyrtimit me iniciativën e tij kontratave standarde;			

³⁰ Jane VKM, që me hyrjen në fuqi të projektligjit të ri, që në fakt u miratua dje, këto shfuqizohen. Dhe nuk do këtë nevojë për VKM të reja, pasi fusha e tyre është plotësisht brenda dispozitave të ligjit të ri. Nuk mund të parashikohej kjo gjë, që në kohën e hartimit të Strategjisë.

37.1	Trajtimi dhe shqyrtimi 100% i ankesave të konsumatorëve	MEF	Deri në v.2015	<p>Komisioni Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK), pas një riorganizimi në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 169, datë 27.5.2014 “Për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve” rifilloi funksionimin e tij në maj 2014. Ky Komision gjatë periudhës maj e në vijim ka zhvilluar 6 mbledhje, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, ku janë trajtuar çështjet të tilla si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i disa ankesave të konsumatorëve në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, në lidhje me mungesën e transparencës për informimin e konsumatorëve në Zyre të Këmbimit Valutor, etj. Komisioni mori Vendimin nr. 34 date 26 dhjetor 2014, adresuar ZVK, nëpërmjet te cilit urdhëron marrjen e të gjitha masave për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në ligjin e mbrojtjes së konsumatorëve për dhënien e informacionit dhe treguesin e çmimit. Se fundmi, operatori njoftoi marrjen e masave për zbatimin e vendimit. 2. Vazhdimi i shqyrtimit të ankesës së Kompanisë Vodafone Albania ndaj Kompanisë Eagle mobile, për ushtrim të praktikave të padrejta tregtare në publicitetin “Eagle, rrjeti i vetem 3.5 G”. Komisioni për një vlerësim të plotë të kësaj çështje i ka kërkuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare informacion të detajuar për çështjen në fjalë dhe në mbledhjen e ardhshme do të vijoje me shqyrtimin e çështjes 3. Ankesa nga disa grupe studentësh kundrejt Universitetit "Vitrina", për mënyrën e çregjistrimit dhe praktika të padrejta. KMK ka marrë disa vendime ndaj këtij universiteti dhe ka vendosur sanksione. 4. Ankesa në lidhje me biletat e blera nga kompania ajrore “Belair” 5. Ankesa drejtuar nga konsumatorë në lidhje me mbifaturime nga UKT dhe OSHEE (kmk ka dërguar shkresa me ankesat bashkëlidhur këtyre operatoreve nëpërmjet te cilave ka kërkuar infomacion ose për kompetence. 6. Vlerësimi i praktikës tregtare të Ndërmarrjes së Furnizimit me Ujit dhe Kanalizimeve, Tirana sh.a. mbi një praktikë të padrejtë tregtare në lidhje me kryerjen e verifikimit të pajisjes matëse të ujit. Komisioni në bazë të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit e ka konsideruar këtë praktikë të padrejtë dhe mori Vendimin nr. 37, datë 2015/06/25. Nëpërmjet këtij vendimi, Komisioni urdhëroi të pushimin e shkeljes, dhe urdhëroi operatorin për të marrë të gjitha masat për korrigjimin e saj kryesisht: nëpërmjet njoftimit individual dhe publik të konsumatorëve me informacion të vërtetë dhe të qartë, dhe mos përsëritjen e praktikave të tilla. Operatori njoftoi KMK për zbatimin e këtij vendimi .
37.2	Shqyrtimi i kontratave standarde të operatorëve në fushën e energjisë, ujit;	MEF	Deri në v.2015	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në lidhje me shqyrtimin e kontratës standarde të furnizimit me energji elektrike me synim gjetjen e kushteve të padrejta në këtë kontratë, komisioni mori Vendimin Nr. 33, datë 17.10.2014. 2. Në lidhje me shqyrtimin e kontratës standarde të furnizimit me ujë për konsumatorët, me synim gjetjen e kushteve të padrejta në këtë kontratë, komisioni mori Vendimin Nr. 35, datë 18.02.2015 - Kete vendim operatori e ka vene ne zbatim

37.3	Shqyrtimi i kontratave te katër operatoreve kryesore në fushën e telefonisë fikse dhe celulare si dhe ne fushën e shërbimit të internetit.	MEF	Deri në v.2015	Ne lidhje me shqyrtimin e kontratave standarde të operatorëve në fushën e telekomunikacionit, me synim eliminimin e kushteve te padrejta, komisioni ka marre 4 vendime, ku perkatesisht, cdo operator elektronik, i ka vene ne zbatim: 1. Vendim Nr. 40, datë 7.10.2016 “Shqyrtimi dhe miratimi i raportit “Vlerësim paraprak i kushteve të përgjithshme të "Kontratës së Pajtitimit: Kushtet dhe Termat e Përgjithshme" të shoqërisë "Albanian Satellite Communications" sh.p.k [Tring]”; 2. Vendimi Nr. 41, datë 7.10.2016 “Shqyrtimi dhe miratimi i raportit “Vlerësim paraprak i kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Pajtitimit për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe televizionit dixhital kabllor”, të operatorit Albanian Broadband Communication sh.p.k (ABCom sh.p.k); 3. Vendimi Nr. 42, datë 7.10.2016 “Shqyrtimi dhe miratimi i raportit “Vlerësim i kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Shërbimit”, të operatorit "Abissnet"; 4. Vendimi Nr. 43, datë 7.10.2016 “Shqyrtimi dhe miratimi i raportit Vlerësim i kushteve të përgjithshme të kontratës së pajtitimit për kategorinë familjar, të Operatorit të Shërbimit te Telefonisë Publike Fikse dhe Aksesit ne Internet Albtelecom sh.a”.
37.4	Trajtimi dhe shqyrtimi 100% i ankesave të konsumatorëve	MEF	2016-2020	Gjatë vitit 2016 - 2017, Komisionit i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka trajtuar rreth 30 ankesa të konsumatorëve. Ka zhvilluar 6 mbledhje dhe ka marrë 8 vendime. Perkatesisht: Vendim nr. 38, datë 12.07.2016 “Shqyrtim i ankesës së paraqitur nga Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me praktikën e ndjekur nga Albtelecom, sh.a. në ofrimin e “Paketës 690” Vendim nr. 39, datë 28.07.2016 “Shqyrtimin e çështjes me objekt: “Ankese e paraqitur nga kompania ROFIX ndaj Shoqërisë Alba Road sh.a për praktikën tregtare të padrejtë në publicitetin “Izolimi termik i fasadave – sistemi mantel – izoterm” Vendim nr. 40, datë 07.10.2016 “Shqyrtim i raportit “Vlerësim paraprak i kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Pajtitimit: Kushtet dhe Termat e Përgjithshme” të shoqërisë “Albanian Satellite Communications” sh.p.k [Tring].” Vendim nr. 41, datë 07.10.2016 “Shqyrtim i raportit “Vlerësim paraprak i kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Pajtitimit për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe televizionit dixhital kabllor”, të operatorit Albanian Broadband Communication sh.p.k (ABCom sh.p.k)” Vendim nr. 42, datë 07.10.2016 “Shqyrtim i raportit “Vlerësim i kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Shërbimit”, të operatorit “Abissnet” sh.a.” Vendim nr. 43, datë 07.10.2016 “Shqyrtim i raportit “Vlerësim i kushteve të përgjithshme të KONTRATËS SË PAJTIMIT për kategorinë familjar, të Operatorit të Shërbimit te Telefonisë Publike Fikse dhe Aksesit ne Internet Albtelecom sh.a” Vendim nr.44, date 11.04.2017 “Shqyrtim i praktikave tregtare të operatorëve ekonomik në lidhje me vendosjen në treg të marrësve numerikë si dhe informimin e ndërgjegjësimitin e konsumatorëve” Vendim nr. 45, date 16.05.2017 “Shqyrtimin i ankesës në lidhje me shërbimin e instalimit të pajisjes së filtrimit të ujit të pijshëm në banesë nga kompania Blue Filters AL”
37.5	Shqyrtimi i kontratave standarde në fushën e arsimit të lartë privat me synim shfuqizimin e kushteve të padrejta në këto kontratat tip;	MEF	2017	KMK me iniciativën e tij e në kuadër të zbatimit të objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale "Për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut, 2020", ka shqyrtuar e vlerësuar 22 kontrata standard të arsimit të lartë privat me studentet/konsumatorët dhe ka marrë: - 18 Vendime Nr. 49-66, datë 17.11.2017, në lidhje me fushën e arsimit privat (universitetet jo publike). Përmes këtyre vendimeve, KMK evidentoi kushtet të padrejta kontraktuale duke urdhëruar njëkohësisht shfuqizimin e tyre dhe marrjen e masave për përmirësimin e kontratave standarde me studentet.
37.6	Shqyrtimi i kontratave standard në fushën e shërbimeve financiare	MEF	2016-2020	Shqyrtimi i disa ankesave të konsumatorëve në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, në lidhje me mungesën e transparencës për informimin e konsumatorëve në Zyre të Këmbimit Valutor, etj.

37.7	Shqyrtimi i kontratave në largësi, jashtë qendrave të tregimit,	MEF	2017-2020	
38	Organizimi i sondazheve tek operatorët, për vlerësimin e praktikave tregtare në fillim dhe pas masave nga KMK			
38.1	Organizimi i sondazheve tek operatorët në fushën e kredisë konsumatore.	MEF	2016-2020	<p>Objekt i sondazheve kanë qenë 16 bankat e nivelit të dytë, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre financiare dhe bankare në qytetin e Tiranës. Mbledhja e të dhënave për realizimin e tij u krye nga një grup intervistuesish nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të posaçëm dhe takimeve me punonjës të bankave, në qendër dhe në degë të zgjedhura në mënyrë rastësore. Pyetësorët u hartuan në përputhje me veçoritë e kërkesave ligjore të fazës së publicitetit dhe fazës parakontraktore.</p> <p>Nga analiza e informacionit të përpunuar dolën në pah disa mangësi në zbatimin e legjislacionit nga ana e bankave, të cilat ndikojnë në ushtrimin e disa të drejtave dhe garancive me rëndësi për konsumatorin. Duke qenë se kërkesat ligjore janë të ndryshme për secilën fazë të marrjes së kredisë konsumatore, edhe mangësitë në respektimin e tyre janë trajtuar në mënyrë të vecantë, dhe paraqiten në formë të përmbledhur si më poshtë:</p> <p>I. MANGËSITË GJATË FAZËS SË PUBLICITETIT Përdorim i gabuar dhe në kundërshtim me konceptin ligjor të termit “kredi konsumatore” 1. Mangësi në dhënien e informacionit standard mbi elementë të tillë si: a) Norma e huas b) Norma Efektive e Interesit – NEI c) Shuma totale e pagesës për konsumatorin d) Shumat e pagesave për këstet 2. Mungesa e shembullit përfaqësues</p> <p>II. MANGËSITË GJATË FAZËS PARAKONTRAKTORE Problematikat e hasura për këtë fazë, në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë: 1) Përdorimi i gabuar i termit kredi konsumatore 2) Mungesa e dhënies me shkrim të informacionit parakontraktor 3) Mangësitë në lidhje me përmbajtjen e informacionit parakontraktor sipas grupeve: a) Grupi 1 - Përshkrimi i karakteristikave të produktit të kredisë b) Grupi 2 - Kostot e kredisë c) Grupi 3 - Aspekte të tjera ligjore.</p> <p>III. Mungesa e analizës së bërë nga nëpunësit mbi vlerësimin e përshtatshmërisë së kredisë së marrë me gjendjen financiare të konsumatorit IV. Ndryshime në politikat e bankës qendër – degë, në lidhje me mënyrën e dhënies së informacionit, sasisë së tij dhe normës së interesit Me qëllim përmirësimin e shkallës së mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator shqiptar, janë dhënë një sërë rekomandimesh me karakter teknik në këndvështrim të përafritimit të mëtejshëm të tij me legjislacionin e BE-së në këtë fushë dhe mbrojtjes më të mirë të konsumatorit.</p>

38.2	Organizimi i sondazheve tek operatorët në fushën e paketave të udhëtimit.	MEF	2016-2020	<p>Në zbatim të legjisllacionit për mbrojtjen e konsumatorit, është kryer një vlerësim i praktikave tregtare në fushën e paketave të udhëtimit, nëpërmjet: organizimit të sondazheve për 45 operatorë (agjencitë e udhëtimit) në Tiranë; dhe hartimit të një raporti vlerësues për gjendjen në fushën e paketave të udhëtimit, në përputhje me gjetjet e sondazheve. Pjesë e raportit është dhe propozimi i një draft kontrate standarde. Bazuar në gjetjet e raportit u dërguan zyrtarisht rekomandimet specifike mbi masat që operatorët duhet të ndërmarrin, duke ju caktuar dhe një periudhë prej 3 muajsh në mënyrë që të zbatoheshin rekomandimet dhe për të përmirësuar situatën..</p> <p>SMK ka monitoruar më tej faqet e internetit të 182 operatorëve të paketave të udhëtimit, nëse këto janë korrigjuar. Ky monitorim u përqendrua kryesisht në informacionin para kontraktual dhe informacionin për kontratën standarde të dhënë për konsumatorët. SMK ka përfunduar procesin e monitorimit dhe rezultatet përkatëse janë paraqitur në KMK. Komisioni në lidhje me mangësitë e konstatuara ka rekomanduar ndjekjen e mëtejshme të detyrimeve përkatëse të operatorëve të paketave të udhëtimit në bashkëpunim me inspektoratin për mbikëqyrjen e tregut, i ngarkuar dhe me çështjet e turizmit.</p>
38.3	Ulja me 20% e praktikave të padrejta tregtare me mospërputhje ligjore, në fushat e udhëtimit ajrore, tregtisë online, etj për vlerësimin e praktikave tregtare në fillim dhe pas masave të KMK.	MEF	2016-2020	<p>Me qëllim mbrojtjen e interesit publik të konsumatorëve, të drejtën e mbrojtjes së interesave të tyre ekonomik: Komisioni ka marrë në shqyrtim praktikën tregtare të operatorëve ekonomik në lidhje me vendosjen në treg të marrësve numerikë, që shoqërojnë procesin e kalimit të transmetimeve në sistemin numerik. Komisioni mori Vendimin nr. 44, datë 11.04.2016, ndërmjet të cilit urdhëron operatorët ekonomik që duhet t'u sigurojnë të gjithë konsumatorëve informacion të saktë, të plotë, të kuptueshëm, mbi specifikimet teknike, karakteristikat e produktit, në mënyrë të tillë që çdo konsumator të jetë i mirinformuar përpara se të marrë një vendimin për blerje.</p> <p>MZHETTS në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ndërmorrën nismën për hartimin e një kodi sjelljeje mes operatoreve të fushës së komunikimit të telefonisë. Në zbatim të ligjit nr. 9902/2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar, në zbatim të Vendimit nr. 36, datë 18.02.2015 të KMK. Kodi i sjelljes u nënshkrua, në muajin tetor 2016, nga katër operatorët: Albtelecom,sh.a, Plus Communication, Telecom Albania, Vodafone Albania. Nëpërmjet këtij kodi, operatorët marrin përsipër të zbatojnë rregullat e përcaktuara në marrëdhëniet me konsumatorët, por edhe midis tyre për përmirësimin e praktikave tregtare në fushën e komunikimeve elektronike.</p> <p>Është kryer monitorimi i 40 faqeve të internetit (proçes i quajtur 'sweeps'), në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2017, që shesin produkte apo ofrojnë shërbime për konsumatorë – nëpërmjet kontratave jashtë qendrave të tregtimit dhe në largësi, përfshirë dhe blerjet online. Jane shqyrtuar faqet e internetit me qëllim për të identifikuar zbatimin e ligjit të konsumatorit nga ana e bizneseve. Ky proçes shoqërohet me analizimin e rezultateve dhe mangësive të identifikuar, në baze të të cilave u përgatiten rekomandimet për bizneset, në mënyrë që të sigurohet respektimi i të drejtave të konsumatorëve.</p>

39	Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe operatorëve në lidhje me: me kuadrin e ri rregullator të sigurisë së produkteve dhe të mbrojtjes së konsumatorëve, përfshirë fushën e të drejtave të udhetareve dhe fushën e produkteve kozmetike.			
39.1	Organizimi i 4 tryezave informuese	MEF	Deri në v.2015	<p>1. Takim me ekspertet e projektit GIZ në lidhje me procesin e realizimit të RIA për ADR</p> <p>2. Takim me bizneset, sektorin e telekomunikacionit me qëllim marrjen e mendimeve mbi rezultatet e anketimit të konsumatorëve, skemat ADR të mundshme, kostot dhe benefitet.</p> <p>3. Takim me bizneset, sektori i shërbimeve dhe mallrave joushqimore për përdorim nga konsumatorët me qëllim marrjen e mendimeve mbi rezultatet e konsumatorëve, skemat ADR të mundshme, kostot dhe benefitet.</p> <p>4. Takimin me entet shtetore rregullatore dhe Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me procesin e realizimit të RIA për ADR</p>
39.2	Përgatitja e materialeve informuese (broshura & fletëpalosje)	MEF	Deri në v.2015	<p>SMK/MZHETTS ka organizuar dy fushata ndërgjegjësuëse me konsumatorët, përkatësisht: 1. Fushata e parë, në nëntor-dhjetor 2015, pati për qëllim të inkurajojë konsumatorët sidomos nxënësit e shkollave të mesme, për të mësuar më shumë për të drejtat e tyre dhe për të ushtruar ato. Aktivitetet konsistuan në:- Përgatitja e 7000 cope fletëve ndërgjegjësimi për konsumatorët, në bazë të modelit të publikuar në faqen e Komisionit Evropian. Përbajtja konsiston në dhënien e informacionit në lidhje me të drejtat e tyre, të tilla si: e drejta për t'u tërhequr brenda 14 ditëve, nga kredia konsumatore, kontratat në largësi apo nga shitja jashtë qendrave të tregtimit. Këto fletëpalosje janë shpërndarë në aktivitete të ndryshme të konsumatorëve, si dhe në qendrat e biznesit, dhe vende të tjera të arritshme nga ana e tyre nëpërmjet Postës Shqiptare.- Një proces anketimi me 800 nxënës të klasave të larta të nëntë shkollave të mesme në Tiranë është kryer në bashkëpunim me Agjencinë për Mbrojtjen e Konsumatorit në Bashkinë e Tiranës. Qëllimi i këtij studimi ishte për të vlerësuar njohuritë që nxënësit kishin fituar për të drejtat e konsumatorit dhe zbatimin e tyre në treg. Gjatë këtij procesi janë shpërndarë fletëpalosje me informacion për të drejtat e konsumatorit. Në fund të këtij procesi u përgatit një raport përmbledhës si dhe u hartuar disa rekomandime me qëllim të përmirësimit të njohurive për të drejtat e konsumatorëve.- Mbatja e një tryezë të rrumbullakët në Hotel Tirana International më 10.12.2015. Në aktivitetin kishte pjesëmarrje nga të gjitha palët e interesuara : shoqatat e konsumatorëve, ministrinë, Bashkia e Tiranës, studentë, etj. Kjo veprimtari përmbylli fushatën ndërgjegjësimi dhe në të u paraqiten rezultatet e studimit të kryer në shkollat e mesme.</p>
39.3	Përgatitja e materialeve informuese në websitin e KMK dhe të MZHETS-së dhe përditesimi i faqes së KMK.	MEF	Deri në v.2015	<p>* Në dispozicion të konsumatorit është dhe faqja e internetit e KMK (http://kmk.ekonomia.gov.al), që nga shtatori 2015. Kjo faqe ka për qëllim të ofrojë informacion më të mirë për konsumatorët, si dhe për paraqitjen online të ankesat të tyre. Vazhdon puna për plotësimin dhe përditësimin e rubrikave përkatëse me të dhëna të reja: miratimi i strategjisë, zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuëse, vendosja e rezultateve të anketimeve, disponueshmërinë e anketimit në mënyrë që të plotësohet online nga ana e konsumatorëve, botimin e fletëpalosjeve dhe broshurave të tjera, etj. Krijimi i faqes u mbështet nga projekti GIZ “<i>Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis e BE-së</i>”.</p> <p>* Që nga muaji prill 2014 është krijuar faqja sociale (FB) për të kontribuar në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e informimit dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre.</p>

40	Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve me 5% çdo vit.			
40.1	Organizimi i të paktën 3 sondazheve me konsumatorë lidhur me perceptimin e tyre për produktet dhe shërbimet e ofruara në treg, legjislacionin, perceptimin për nivelin e mbështetjes dhe shërbimit nga strukturat e administratës shtetërore, etj	MEF	2016-2020	Gjate periudhës maj-korrik 2017, SMK në bashkëpunim me ekspertet e projektit të Binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe sekretariatit teknik”, në kuadër të Programit IPA 2014, ka zhvilluar 2 sondazhe, një për konsumatorë dhe një për biznesin. Këto sondazhe do të shërbejnë për vlerësimin e ndikimit të politikave ekzistuese, identifikimin e mangësive si dhe të marrje e masave për përmirësimin e politikave të konsumatorit.
40.2	Organizimi i 10 tryezave informuese;	MEF	2016-2020	<p>1. Mars 2016 - Organizimin e një tryeze të përbashkët me pjesëmarrje nga të gjithë aktoret për mbrojtjen e konsumatorëve: ministri të linjës; shoqatat e konsumatorëve dhe organizata të biznesit. Në takim mori pjesë dhe Ministri e MZHTTS, znj. Milva Ekonomi, ku dhe mbajti një fjalim të rëndësishëm. Diskutimet e pjesëmarrjeve u përqendruan situatën aktuale dhe për hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren për të përmirësuar zbatimin e të drejtave të konsumatorëve dhe për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe operatorëve.</p> <p>2. Maj / Korrik 2016 – Zhvillimi i 4 takimeve rajonale me përfaqësues të 61 bashkive në Shkodër, Korçë, Sarandë dhe Elbasan. Këto takime kishin për qëllim njohjen e punonjësve të bashkisë me legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve, procedurat që duhet të ndiqen për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, dhënie e informacionit të nevojshëm për konsumatorët, si dhe mënyrat e sigurimit të një bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe efikas midis MZHTTS dhe bashkive</p> <p>3. Nëntor 2016, DTB / MZHTTS me mbështetjen e projektit GIZ, zhvilloi tryezën për konsultim publik me temë “Prezantimi dhe diskutimi i ndryshimeve në legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve”. Në këtë tryezë u paraqit drafti i ndryshimeve në funksion të harmonizimit të këtij ligji me Direktivën 2011/83/BE mbi të drejtat e konsumatorëve dhe Direktivën 2013/11/BE mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe tregtarëve</p> <p>4. Dhjetor 2016, në kuadër të zhvillimit të fushatës ndërgjegjëse për konsumatorët “Konsumator, bli me zgjuars!” , janë printuar rreth 7000 (shtatë mijë) fletëpalosje dhe janë dërguar në 61 bashki të vendit, ku personat e kontaktit përgjegjës për çështjet e konsumatorëve në këto bashki, kanë marrë masat për ekspozimin e tyre pranë zyrës së informacionit, si dhe sigurimin e shpërndarjes së tyre.</p> <p>5. Mars 2017, nënshkrimi i një memorandumit bashkëpunimi me tre bashki të përzgjedhura si pilot (Elbasan, Lushnjë, Tepelenë) me MZHTTS.</p>
40.3	Përgatitja e materialeve informuese si: fletëpalosje, broshura, spote publicitare, media, përditësimi i përmbajtjes së faqeve të internetit, etj	MEF	2016-2020	<p>Ne 15 mars 2016, me rastin e Ditës së Konsumatorëve, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorëve (MZHTTS), organizoi një sërë aktivitetesh me moton: Konsumatorë, përdorni të drejtat tuaja! Këto aktivitete konsistuan në ngritjen e tendave promocionale në 4 pika kyçe të kryeqytetit. Tendat u vizituan nga rreth 1200 konsumatorë dhe në to u shpërndanë më shumë se 2500 materialesh informuese: fletëpalosje dhe broshura, me informacion në lidhje me kontratat e shitjes së mallrave, paketat turistike dhe praktikën e padrejta tregtare, si dhe materiale publicitare, si çanta, bluza, etj. Gjithashtu, në këto qendra konsumatorët paraqiten ankesa të ndryshme dhe morën këshillimin përkatës.</p> <p>Gjatë muajve maj-korrik 2016, në kuadër të reformës dhe procesit të riorganizimit të bashkive, MZHTTS me mbështetjen edhe të Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT), ka vendosur bazat e bashkëpunimit me 61 bashkitë e vendit. Aktualisht, çdo bashki ka punonjës dhe ngarkuar me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve. Këta punonjës janë pjesë e punës së përbashkët, për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve. Në kuadër të ndërmarrjes së</p>

				<p>iniciativës nga SMK/MZHETTS “Përfshirja e pushtetit vendor në përmirësimin e zbatimit të legjislacionit dhe rritjen e nivelit të mbrojtjes së konsumatorëve”. Janë organizuar në qytetet: Shkodër, Korçë, Sarandë dhe Elbasan, 4 takime rajonale me përfaqësuesit e 61 bashkive, në lidhje me njohjen e punonjësve të bashkisë me legjislacionin e mbrojtjes së konsumatorëve, procedurat që duhet të ndiqen për trajtimin e ankesave të konsumatorëve, dhënien e informacionit të nevojshëm për konsumatorët, si dhe mënyrat e sigurimit të një bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe efikas midis MZHETTS dhe bashkive.</p> <p>Në muajin dhjetor 2016, në kuadër të zhvillimit të fushatës ndërgjegjësuere për konsumatorët “Konsumator, bli me zgjuarsi!”, janë printuar rreth 7000 (shtatë mijë) fletëpalosje dhe janë dërguar në 61 zyra e m te vendit.</p> <p>Me 15 mars 2017, Dita Ndërkombëtare e Konsumatorëve u zhvillua një fushatë ndërgjegjësuere, në lidhje me përfshirjen e pushtetit vendor në çështjet të mbrojtjes së konsumatorëve, për zbatimin e ligjit të mbrojtjes së konsumatorëve edhe nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Slogani i këtij viti ishte: “Konsumator: informohu, këshillohu, ankohu”. Këto aktivitete janë të dokumentuara me pershkrime dhe fotografi në faqen e internetit të KMK dhe rrjetet sociale.</p>
41	Përmirësimi i nivelit të këshillimit të konsumatorëve nëpërmjet funksionimit të qendrave të këshillimit.			
41.1	Mbeshtetje për ngritjen e 2 qendrave të këshillimit të konsumatorëve	MEF	Deri në v.2015	Jane krijuar edhe dy shoqata të reja për mbrojtjen e konsumatorëve: Qendra “Peshëmatje-Çmime” dhe qendra “Konsumatori shqiptar”. Me këto dy shoqatat e reja janë organizuan takime të veçanta. Gjithashtu është organizuar dhe një takim i përbashkët me të gjitha shoqatat aktive në mbrojtje të të drejtave të konsumatorëve, ku u shkëmbyen opinionet mbi përmirësimin e bashkëpunimit midis strukturës shtetërore dhe shoqatave të konsumatorëve. Aktualisht numri i shoqatave në mbrojtje të konsumatorëve ka arritur në 5.
41.2	Krijimi i pikës së kontaktit dhe informimit për tregtinë elektronike për konsumatorët;	MEF + AKEP	Deri në v.2015	<p>1. Për përmirësimin e shërbimeve publike të ofruara qytetarit është duke implementuar reformen në ofrimin e shërbimeve publike në kuadër të së cilës :</p> <p>- me VKM nr. 93, datë 22.10.2014 “Për krijimin e qendrës së shërbimeve publike të integruara” është krijuar ADISA</p> <p>- është miratuar ligji nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Per mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në RSH”</p> <p>2. Në sektorin postar është miratuar ligji nr. 46/2015 “Per shërbimet postare në RSH”</p> <p>- Miratuar urdhezimi i ministrit nr. 4038 date 04.09.2015 “Per përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”.</p>
41.3	Ngritja e 4 qendrave të tjera të këshillimit, që plotësojnë plotësisht kriteret dhe njihen nga MZHETS.	MEF	2016-2020	2017- Me rastin e 15 marsit, Ditës së Konsumatorëve, u zhvilluan aktivitete në Elbasan dhe në Lushnjë, ku u inaugurua dhe hapja e dy Zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve. Këto zyra do të shërbejnë edhe si qendra këshillimi.
42	Përmirësimi i edukimit të konsumatorëve në fushën e arsimit nëpërmjet			
	Rishikimit të kurrikulave me qëllim pajisjen e nxënësve me informacion mbi legjislacionin për konsumatorin dhe për të drejtat e konsumatorit duke e pasuruar me tema	MAS	Deri në v.2015	Nuk ka informacion
43	Rritja e nivelit të edukimit konsumator, nëpërmjet përfshirjes së çështjeve të mbrojtjes së konsumatorëve, në programet mësimore edhe në sistemin parashkollor dhe atë të ciklit të ulët.			

43.1	Prodhimi i materialeve te reja shkollore dhe udhëzimeve të reja metodologjike, si dhe përpunimi i materialeve mësimore ekzistuese.	MAS	2020	Nuk ka informacion
43.2	Trajnimi i mësuesve me qëllim kualifikimin e tyre, per ceshtjet e mbrojtjes se konsumatoreve.	MAS	2020	Nuk ka informacion
43.3	Ndërveprimi ndërmjet shkollave për të mbështetur shkëmbimin e praktikave më të mira në integrimin e edukimit të konsumatorëve në sektorin e edukimit shkollore ne te gjitha ciklet mesimore.	MAS	2020	Nuk ka informacion
44	Funksionimi i strukturave qe sigurojnë zgjidhjet jashtëgjyqësorit të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve.			
	Rritja me 20% çdo vit e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve te konsumatorëve	MEF	2017-2020	
45	Ndërtimi i infrastrukturës për rrjetin e bashkëpunimit te strukturave shtetërore me përgjegjësi institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve, për të qenë pjesë e CPCN (Rrjetit Evropian të Bashkëpunimit për Mbrojtjen e Konsumatorëve), me hyrjen e Shqipërisë në BE;			
45.1	Zbatimi i aktit nenligjor për të siguruar koordinimin midis strukturave administrative si dhe lidhjen me CPCN (Rrjetin Evropian të Bashkëpunimit për Mbrojtjen e Konsumatorëve).	MEF	2020	Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 107, datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP) për Integrimin Evropian”, MZHETTS organizoi më 2 korrik 2015 një workshop me përfaqësuesit e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) të kapitullit 28 "Mbrojtja e konsumatorëve dhe shëndetit". Aktiviteti ishte i fokusuar në mekanizmin për ndarjen e acquis përkatëse të BE-së; përmirësimin e ndarjes e përgjegjësi ndërmjet ministrive të ndryshme/institucioneve, si dhe mekanizmave koordinues në mes të anëtarëve të GPN. Gjithashtu, takimi u përqendruar edhe ne forcimin e kapacitetit institucional të Drejtorisë së Tregut të brendshëm/MZHETTS , në rolin e koordinatorit të këtij kapitulli. Ky aktivitet u mbështet nga projekti GIZ " Harmonizimi i legjislacionit ekonomik dhe tregtar me acquis e BE-së ".
45.2	Zhvillimi i infrastrukturës, krijimi i një baze të dhënash dhe një sistem komunikimi;	MEF	2020	
45.3	Aktivitete trajnuese për specialistët e strukturave zbatues dhe palë të tjera të interesuara.	MEF	2020	Janë zhvilluar, gjatë muajit prill 2016, tre trajnime të organizuara nga ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) dhe projekti GIZ. Trajnimi synonte forcimin e kapaciteteve institucionale të stafit të disa drejtorive të MZHETTS, përfshirë dhe stafin e SMK, ne lidhje me çështje te tilla si: hartim legjislacioni, përafrimi i legjislacionit me EU acquis, si dhe vleresimi i impaktit rregullator (RIA) gjatë hartimit te legjislacionit.